

Josh McDowell dhe Don Stewart
me titull:

"Answers to Tough Questions Skeptics Ask About The Christian Faith"
"Reasons Skeptics Should Consider Christianity."

Botuar së pari respektivisht:
1980 by Campus Crusade for Christ, Inc.
1981 by Campus Crusade for Christ.

© 1999 for the Albanian edition by Josh McDowell Ministries.
All rights reserved.

PARATHENIE ■

Nuk ka kënaqësi më të madhe sesa ajo që ndiej duke u rekomanduar kërkuesve të së vërtetës, të krishterë si dhe jo të krishterë, “Përgjigje dhe argumente” të Josh McDowellit dhe të Don Stewartit.

Librat në mbrojtje të krishterimit përgjithësisht janë të një lloji krejt pedant, bazuar në traditën e filozofive Thomist-Aristotelian (në rastin më të mirë) ose në degëzimet e Presupozicionalizmit mendjengushtë (në rastin më të këq). Vëpra të tilla shpesh nuk i marrin seriozisht pyetjet e jo-besimtarëve, ose, edhe nëse i marrin, përgjigjet që u japin janë si ato të predikuesit të famshëm, i cili mbeti i padukshëm në të gjashtë ditët e javës dhe i pakuptueshëm në të shtatën.

Krejt ndryshe me librin e pranishëm; ai merret katërcipërisht me çështje të mprehta në kufirin ndërmjet besimit e mosbesimit dhe është i vendosur të japë dëshmi faktike ndaj provës së çiltër të zotimit. Porse nga ana tjetër, “dëshmia kërkon gjykim” dhe lexuesit do ta gjejnë veten e tyre në mënyrë krejt të pashmangshme në pozitën që i bën ata të japin gjykimin për Jezu Krishtin.

JOHN WARWICK MONTGOMERY, Doktor në Filozofi (Chicago), Doktor në Teologji (Strasbourg, Francë), anëtar i Shoqatës së Avokatëve në Kaliforni e Virxhinia, Dekan i Drejtësisë në “The Simon Greenfield School”.

■ HYRJE

Menjëherë pasi kishim përfunduar librin e pare “*Answers*”, ne u gjendëm të befashuar prej një morie të madhe pyetjesh, për të cilat edhe që kishim lënë vend për t’iu përgjigjur. Shumica e pyetjeve përqëndrohej rreth asaj se përse ne besojmë se Dhiata e Vjetër dhe e Re janë Fjala e vërtetë e Zotit, shfaqja verbale e shpallur prej vetë Perëndisë.

Janë të shumtë lexuesit që kanë shprehur interesim ndaj përkthimeve dhe parafrazimeve të ndryshme të Biblës.

Përse kaq shumë përkthime? Cili nga ato është më i miri? Çfarë mund të thuhet për *Textus Receptus*?¹ Këto janë vetëm disa nga pyetjet e bëra.

Besueshmëria dhe saktësia historike e Biblës kanë qenë trajtuar në dy librat tona të mëparshëm si “Dëshmi që kërkon gjykim” dhe “Ca më shumë dëshmi që kërkon gjykim”

“Arsyet se përse skeptikët duhet të marrin parasysht krishterimin” është shkruar për të dhënë argumenta se përse në besojmë në frymëzimin e Biblës si një mesazh që Zoti i dërgon njeriut.

1. *Textus Receptus*, lat. Text i pranuar, mbi të cilën u bazua Bibla angleze e mbretit Xhejms në 1611 (Shën. i përkth.)

Hyrje

Që prej shumë kohësh miliona njerëz e kanë konsideruar Biblën si librin më të madh të botuar ndonjëherë. Deri tani Bibla është “best seller”-i numër një në tërë rrjedhën e historisë.

Patrick Henry deklaronte: “Bibla vlen më shumë se të gjithë librat e tjerë të botuar deri tani. ”

Charles Dickensit i shkroi: “Dhiata e Re është libri më i mirë që i është shfaqur apo dhe që do t’i shfaqet ndonjëherë kësaj bote. ”

Sir Isaak Newton-i arriti në përfundimin, “Gjenden më shumë dëshmi për qenie autentike në Bibël sesa në historinë laike. ”

Abraham Lincoln-i besonte se “Bibla është dhurata më e mirë që Zoti i ka dhënë ndonjëherë njeriut. Gjithë mirësia e Shpëtimtarit të botës na është përcjellë nëpërmjet këtij libri. ”

Daniel Webster-i tha: “Nëse ka diçka në mendimet apo stilin tim për t’u lavdëruar, nderi u takon prindërve të mi, të cilët më kanë mëkuar dashurinë e hershme për Shkrimet. Po qe se i zbatojmë parimet e mësuara në Bibël, vendi ynë do të ecë drejt përparimit dhe lulëzimit; por nëse ne dhe pasardhësit tanë lënë pas dore udhëzimet dhe autoritetin e saj, asnjë njeri nuk mund të kuptojë sesa shpejt shkatërrimi do të mundë të na gëlltitë e të na varrosë tërë lavdinë tonë në errësirën e thellë. ”

George Washington-i arriti në përfundimin “është e pamundur të qeverisësh botën drejt pa Perëndinë dhe Biblën. ”

Megjithatë Bibla pretendon të jetë më shumë sesa thjeshtë libri më i madh i shkruar ndonjëherë. Ajo pretendon të jetë pikërisht Fjala e Perëndisë, — një zbulësë e Zotit për njeriun.

Çfarë e bën Biblën kaq të veçantë?

Krishterimi beson dhe mëson se vetë Bibla është zbulësia e Fjalës së Zotit. Edhe pse u shkrua nga njerëzit, autori kryesor ishte Zoti i plotfuqishëm. Ky pretendim nuk u zbulua prej kishës, por është pretendim që Bibla ka për vetveten.

“Fjala e Zotit mbetet për jetë. ” (1 Pjetër 1:25) ¹ “I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia. ” (2 Timoteut 3:16), “Sepse asnjë profeci që nuk ka ardhur nga vullneti i njeriut, por njerëzit e shenjtë të Perëndisë kanë folur, të shtyrë nga Fryma e Shenjtë. ” (2 Pjetër 1:21). Mbi dy mijë herë vetëm në Dhiatën e Vjeter gjenden pjesë të tilla si: “Dhe Zoti i foli Moisiut. ” “Dhe Fjala e Zotit iu drejtua Jonas. ” dhe “Zoti tha”. Për më tepër, Bibla pretendon të jetë regjistrimi i fjalëve dhe veprave të Zotit,

kështu që ajo e konsideron veten Fjalë të Zotit.

Vetë fakti që Bibla pretendon të jetë Fjala e Zotit nuk provon që është, sepse ka libra të tjerë me pretendime të ngjashme. Ndryshimi është që Shkrimet përmbajnë prova të bindshme që është Fjala e Zotit. Një arsye që Bibla është e pashoqe mes librave të tjerë është uniteti i saj. Edhe pse u shkrua nga njerëzit, Bibla u shkrua në një periudhë kohe prej afër 1500 vjetësh, nga më shumë se dyzet autore të ndryshëm njerëzorë. Këta autorë vinin nga mjedise e rangje të ndryshme duke përfshirë këtu Jozueun (gjeneral ushtarak), Danielin (kryeministër), Pjetrin (peshkatar) dhe Nehemiasin (kupëmbajtësin e mbretit).

Autorët e librave të ndryshëm shkruan në vende të ndryshme, si në shkretëtirë (Moisiu), në burg (Pali), në mërgim në ishullin Patmos (Gjoni). Shkrimet biblike u krijuan në tri kontinente (Afrikë, Azi dhe Europë) si dhe tri gjuhë (hebraike, aramaike dhe greqishte).

Përmbajtja e Biblës merret me subjekte të debatueshme. Megjithatë, Bibla mbetet e tërë. Që nga fillimi e deri në fund zhvillohet një histori e planit të Zotit për shpëtimin e njerëzimit. Ky shpëtim vjen nëpërmjet personit të Jezu Krishtit. (Gjoni 14:6) Vetë Jezusi vërtetoi se Ai ishte tema e gjithë Biblës.

“Ju hetoni Shkrimet, sepse mendoni të keni nëpërmjet tyre jetë të përjetshme, por ato janë këto që dëshmojnë për mua... Sepse, në qoftë se ju do t’i kishit besuar Moisiut, do të më besonit edhe mua, sepse ai ka shkruar për mua. Por, në qoftë se ju nuk u besoni Shkrimeve të tij, si do t’u besoni fjalëve të mia?” (Gjoni 5:39, 46, 47.) Diku tjetër Jezusi tha: “Dhe duke zënë fill nga Moisiu dhe nga gjithë profetët, ai u shpjegoi atyre në të gjitha Shkrimet gjërat që i takonin atij.” (Luka 24:27, shih, gjithashtu, Luka 24:44).

Dhiata e Vjetër është përgatitja (Isaia 40:3). Ungjijtë janë shfaqja (Gjoni 1:29), Libri i veprave është përhapja (Veprat 1:8). Letrat janë shpjegimi (Kolosianëve 1:27). Libri i Zbulesës është plotësimi (Zbulesa 1:7). Bibla është tërësisht për Jezusin.

Gjithë Bibla është një tërësi, ku çdo pjesë është nevojtare ndaj tjetrës për t’u plotësuar. Dr. F. A. Albrajt e shpjegon kështu këtë: “Për shkrimtarët e Dhiatës së Re, Bibla hebreg ishte Shkrimi i Shenjtë dhe ata ishin trashëgimtarët e drejtpërdrejtë të profetëve të saj. Kështu është krejt e pamundur ta kuptosh Dhiatën e Re, pa ditur se qëllimi i tij ishte plotësimi dhe shpjegimi i Biblës hebreg”.

“Çdo përpjekje për t’u kthyer te burimi i krishterimit pa pranuar Biblën në tërësi si udhërrëfyesën tonë, është e dënuar të dështojë”. (cituar nga Roger T. Forster dhe V. Paul Marston *“That’s a Good Question.* f. 67)

1. Të gjitha citimet biblike në këtë libër bëhen sipas Biblës, përkthim Diodati i Ri, Tiranë 1994. (Shën. i përkth.)

Që dikush të mos mendojë se një gjë e tillë nuk është ndonjë mrekulli, po ju japim një provë. Gjeneratë njerëz nga vendi ku ju jetoni që të kenë të njëjtën histori prejardhjeje, të flasin të njëjtën gjuhë dhe të kenë që të gjithë në themel të njëjtën kulturë. Pastaj ndajini dhe u kërkoni të shkruajnë mendimin e tyre për një temë të debatueshme si, fjala vjen, Kuptimi i Jetës.

Kur të kenë përfunduar, krahasojini përfundimet e këtyre dhjetë shkruesve. A janë ata të një mendjeje me njëri-tjetrin? Patjetër që jo. Mirëpo Bibla nuk ka të bëjë thjeshtë me dhjetë autorë, por me dyzet. Ajo nuk u shkrua brenda një breznie, por gjatë 1500 vjetësh, jo prej autorësh të të njëjtit arsimim, kulturash shumë të ndryshme e më në fund, duke mos trajtuar pikërisht vetëm një temë, por qindra.

Dhe, megjithatë, Bibla është tërësisht harmonike. Në të ka një harmoni të plotë, që nuk mund të shpjgohet prej rastësisë apo ndonjë makinacioni. Uniteti i Biblës është një argument i fortë që shkon në të mirë të frymëzimit të saj hyjnor.

Uniteti i Shkrimit është vetëm një arsye midis shumë të tjerave që mbështet pretendimin e Biblës për të qenë Fjala hyjnore e Zotit. Të tjerat të cilat do të mundnim t'i shpjgonim në hollësi, janë dëshmia e kishës së hershme, prova e historisë dhe e arkeologjisë, prova e ndryshimit të jetëve përmes shekujve, për të përmendur këtu vetëm disa syresh.

Këto fakte e çuan arkeologun e madh W. F. Albrajt në përfundimin "Bibla lartësohet në përmbajtje mbi gjithë lëtersinë e hershme fetare; ajo lartësohet pikërisht aq mbresë lë nëse mbi gjithë letërsinë e mëpastajme, me thjeshtësinë e drejtpërdrejtë të mesazhit të vet dhe të universalitetit të thirrjes së saj drejtuar njerëzve të të gjitha vendeve dhe kohërave. (*The Christian Century*, nëntor 1958)

Bibla është e veçantë. Ajo është e pashoqe. Asnjë libër tjetër nuk ka të tilla kredenciale. As edhe një libër tjetër madje nuk mund t'i afrohet asaj. "Anglia ka dy libra, Biblën dhe Shekspirin: Anglia bëri Shekspirin, por Bibla bëri Anglinë" (Viktor Hygo).

A nuk ka ndryshuar Dhiata e re përderisa është kopjuar e rikopjuar nëpër histori?

Një keqkuptim i rëndomtë është ai që thotë se teksti i Biblës nuk na ka ardhur në formën e saj fillestare të të shkruarit. Akuzat u shtuan për murgj të zellshëm të cilët gjoja ndryshuan tekstin gjatë tërë historisë kishtarë. Ky problem është i një rëndësie të madhe, sepse një tekst i ndryshuar do të dëmtonte rëndë besueshmërinë e veprës.

Sikurse edhe F. F. Bruce thotë: "Njëherë e përgjithmonë historia e krishterimit, që e shquan atë prej sistemeve të tjera fetare e filozofike, të cilat lidhen në mënyrë të veçantë me ndonjë kohë të përcaktuar, e bën

besueshmërinë e Shkrimeve, që pretendojnë se regjistrojnë këtë zbulësë, çështje të një rëndësie të dorës së parë. (*The New Testament Documents — are they reliable?* f. 8)

Fatmirësisht, problemi nuk është i llojit të mungesës së provës. Egzistojnë tre lloje dëshmish që duhen përdorur për të vlerësuar tekstin e Dhiatës së Re. Këto janë dorëshkrimet greqisht, versionet e ndryshme, në të cilat Dhiata e Re është përkthyer si dhe shkrimet e etërve të kishës.

Dhiata e Re fillimisht u shkrua në greqisht. Para shpikjes së shtypshkronjës librat kopjoheshin me dorë. Një shkrim i realizuar në këtë mënyrë quhet dorëshkrim. Gjenden afro 5500 kopje dorëshkrimore në ruajtje, të cilat përbëjnë tërësisht ose pjesërisht Dhiatën e Re. Sido që ne nuk i zotërojmë origjinalet, kopjet ekzistojnë në kohë shumë të hershme.

Dhiata e Re u shkrua nga viti 50 deri në vitin 90 (era jonë). Fragmenti më i herët datohet rreth vitit 120 me rreth 50 fragmente të tjerë të datuar brenda 150–200 vjetëve që nga koha e krijimit. Dy dorëshkrime madhore, *Codex Vaticanus* (v. 325 era jonë) dhe *Codex Sinaiticus* (v. 330 era jonë), datohen brenda 250 vjetëve që nga koha e krijimit. Duket sikur kemi të bëjmë me një periudhë të gjatë kohe, por në fakt është shumë e shkurtër, po ta krahasojmë me shumicën e veprave të kohës së lashtë. Për shembull: Cezari shkroi për luftrat Galike. Më e hershmja kopje e atij libri datohet rreth 1000 vjet që nga koha kur u shkrua origjinali, ndersa kopja e plotë e Odisë së Homerit daton 2200 vjet pasi ishte shkruar. .

Kur largësia kohore ndërmjet shkrimit të Dhiatës së Re dhe kopjeve të saj të hershme krahasohet me veprat e tjera të lashtësisë, Dhiata e Re del shumë më afër kohës së origjinalit.

Të 5500 kopjet janë pa diskutim më të shumtat që ne kemi të ndonjë veprë të lashtësisë. Shumë shkrime antike janë përcjellë vetëm prej një grushti dorëshkrimesh. (Katuli, tri kopje; kopja më e hershme është 1600 vjet pasi ai shkroi origjinalin. Herodoti: tetë kopje me një periudhë kohe prej 1300 vjetësh).

Dorëshkrimet e Dhiatës së Re, jo vetëm që kanë më shumë dëshmi dorëshkrimore dhe interval të shkurtër kohor me origjinalet, por ato u përkthyen, gjithashtu, po aq herët, në shumë gjuhë të tjera. Përkthimi i një dokumenti nga një gjuhë në një tjetër, është një fenomen i rrallë në botën antike, kështu që ky fakt është një plus për Dhiatën e Re. Numri i kopjeve të versioneve është mbi 18. 000 dhe, ndoshta mbi 25. 000. Kjo është një e dhënë shtesë, e cila na ndihmon të përcaktojmë tekstin e Dhiatës së Re.

Edhe po të mos zotëronim të 5500 dorëshkrimet greke apo dhe të 18 000 kopjet e versioneve, Teksti i Dhiatës së Re do të mund të riprodhohej brenda 250 vjetëve që nga krijimi. Po në ç' mënyrë? Njëpërmjet shkrimeve të krishtera të hershme. Në komentet, letrat etj. këta shkrimtarë të lashtë

citojnë tekstin biblik, duke na dhënë kështu një tjetër dëshmi të tekstit të Dhiatës së Re. John Burgon ka kataloguar më shumë se 86. 000 citate të Dhiatës së Re në shkrimet e etërve të hershëm të kishës, të cilët jetuan para vitit 325 (era jonë). Kështu, ne vëmë në dukje këtu se ka më tepër dëshmi për besueshmërinë e Dhiatës së Re sesa për shkrimet e tjera të krahasueshme të botës së vjetër.

F. F. Bruce vëren: “Dëshmia për shkrimet e Dhiatës së Re është ca më e madhe sesa dëshmia për shumë shkrime të autorëve klasikë, mirëfillsinë e së cilës askush nuk ëndërron ta vërë në pikëpyetje. ” Më tej ai shton: “Edhe sikur Dhiata e Re të ishte një përmbledhje shkrimesh shekullare, mirëfillësia e tyre do të vlerësohej pa as më të voglin dyshim. ” (*The New Testament Documents — are they reliable?*” f. 15)

Sir Frederik Kenyon, ish-drejtor dhe krye-bibliotekar në Museum in Britanik ishte njëri prej ekspertëve më në zë për dorëshkrimet antike dhe për autenticitetin e tyre. Pak para vdekjes së tij, ai shkroi këto rrjeshta për Dhiatën e Re: Koha ndërmjet datave të krijimit fillestar (të Dhiatës së Re) dhe të dëshmisë së saktë e më të hershme bëhet kaq e vogël, sa të konsiderohet e papërfillshme dhe mbështetja e fundit për çdo lloj dyshimi që Shkrimet të mos na jenë transmetuar pak a shumë siç u shkruan, tani u largua. Që të dyja, autenticiteti dhe sinqeriteti i librave të Dhiatës së Re mund të konsiderohen plotësisht të provuara. ” (*The Bible and Archeology*, f. 288–289)

Si mundet dikush ta besojë Dhiatën e re si një tregim për jetën e Jezusit duke parë se ajo është shkruar pas vdekjes së tij?

Duket se ekzistojnë ca lloje mendimesh të përgjithshme midis shumë njerëzve, se dokumentet e Dhiatës së Re ishin shkruar shumë vjet pas ngjarjeve që u zhvilluan dhe që nga ajo kohë nuk mbajnë informacion të besuar. Megjithatë, është fakt se jeta e Jezusit ishte shkruar prej dëshmitarëve apo njerëzve të cilët regjistruan dëshmi të drejtpërdrejta. Shkrimtarët që të gjithë jetonin në të njëjtën kohë kur ndodhën këto ngjarje dhe patën kontakte personale me ato ngjarje e me njerëzit që dëshmuuan ngjarjet.

Ekziston një dëshmi e fortë e brendshme se Ungjijtë ishin shkruar në kohë të herët. Libri i Veprave regjistron veprimtarinë misionare të kishës së parë dhe u shkrua si vazhdim prej të njëjtit person që shkroi ungjillin sipas Lukës. Libri i veprave mbyllet me Apostullin Pal që jetonte në Romë, me vdekjen e tij të paregjistruar.

Kjo do të na çonte të besonim se ai ishte shkruar para se ai të vdiste, derisa në jetën e tij ishin shënuar ngjarje të tjera madhore. Në kemi disa arsye të besojmë se Pali ishte dënuar me vdekje gjatë periudhës përndjekse neronase të vitit 64 (era e re), çka tregon se Libri i Veprave u shkrua para

kësaj kohe. Në qoftë se Libri i Veprave ishte shkruar para kësaj kohe (viti 64 era jonë), atëherë Ungjilli i Lukës, për të cilin Libri i Veprave ishte vazhdim, duhej të ishte përpiluar kohë më parë, ndoshta në fund të të pesëdhjetave ose në të hyrë të gjashtëdhjetave të shekullit të parë. Vdekja e Krishtit ngjau aty rreth vitit 30 (era jonë), dhe kjo do ta bënte krijimin e Lukës në fund të fundit brenda tridhjetë vjetëve të ngjarjeve. Kisha e parë përgjithësisht, mësonte se Ungjilli i parë që u shkrua ishte ai i Mateut, i cili edhe na afron ca më tepër më kohën e Krishtit. Kjo dëshmi na shtyn të besojmë se të tre Ungjijtë e parë ishin shkruar brenda tridhjetë vjetëve nga koha e rrjedhës së këtyre ngjarjeve, kohë kur dëshmitarë jo miqësorë që ende jetonin, do të binin në kundërshtim më dëshminë e tyre, nëse do të ishte e saktë.

Kjo lloj dëshmie e ka çuar një studiues liberal, John A. T. Robinson, t'i ridatojë dokumentet e Dhiatës së Re më herët nga ç' duan dijetarët liberalë modernë që të besojnë. Robinson ka argumentuar të "*Redating The New Testament*" se e gjithë Dhiata e Re mund të ketë përfunduar para vitit 70 (era jonë), dhe kjo është gjënë mirë brenda periudhës së dëshmisë okulare.

Faktet e kësaj çështjeje e çuan W. W. Albrajt, arkeologu i përmendur biblik, të komentonte: "Tashmë mund të themi qartë se nuk ekziston as edhe një argument i fortë që të mund të datojë Dhiatën e Re përtej vitit 80 (era jonë) dy brezni të plota para datës ndërmjet 130 dhe 150 të dhëna prej kritikëve të sotëm më radikalë të Dhiatës së Re." (William F. Albrajt, *Recent Discoveries In Bible Lands* f. 136). Datimi i vitit 80 (ëra jonë) sipas Albrajtit mund të ngjallë dyshim, kur i drejtohem Ungjillit sipas Gjonit. Ekziston një mundësi e fortë të besojmë se syrgjynosja e Apostullit Gjon në ishullin Patmos nga Domiciani të ketë ndodhur po aq vonë sa vitet 95–96 (era jonë) të Zbulesa 1. Ka një traditë të fortë që thotë se Gjoni e shkroi Zbulesën në atë ishull pikërisht në atë kohë. Kjo e dhënë është vërtetuar nga Klementi i Aleksandrisë, Eusebi dhe Ireneu. (Krahaso "*New Testament Survey*", f. 391, prej Robert Gramocki).

Provat theksojnë se,¹ dokumentet nuk u shkruan shumë kohë larg ngjarjeve, por afër tyre dhe² u shkruan gjatë asaj kohe kur shumë njerëz që ishin njohur me ngjarjet ose ishin dëshmitarë okularë ishin akoma të gjallë. Konkluzioni i pashmangshëm është se tabloja që Dhiata e Re përshkruan për Krishtin mund të besohet.

Ka kaq shumë interpretime të ndryshme të Biblës. Përse duhet t'i besoj tuajit?

Një nga ankesat që ne dëgjojmë shpesh është që kushdo ka një interpretim të ndryshëm për Biblën. Ngaqë shumë njerëz arrijnë në përfundime të ndryshme kur lexojnë Biblën, mendohet se nuk ekziston asnjë mënyre marrëveshjeje.

Njerëzit tregojnë shumëllojshmërinë e emërtimeve kishtare si një shembull se nuk mund të ekzistojë asnjë njëzëshmëri pajtimi ndërmjet besimtarëve të Biblës. Kjo ide lë pas dore marrjen parasysh të fakteve. Shumica dërrmuese e lexuesve të Biblës nuk kanë asnjë problem lidhur me pajtueshmërinë ndaj mësimave qëndrore të Biblës. Madje edhe ato që nuk besojnë që Bibla të jetë e vërtetë, nuk kanë fare vështirësi për të kuptuar se cili është mesazhi kryesor. Brenda gjithë degëve të krishterimit, ne gjejmë të njëjtin kuptim themelor për çfarë na mëson Bibla. Ato zakonisht pranojnë të njëjtat pohime që mbrojnë të vërtetat themelore sikurse ajo që thotë se Zoti bëri njeriun sipas shëmbëlltyrës së Tij, me lirinë e zgjedhjes dhe që njeriu vendosi të kundërshtojë Zotin, duke futur kështu mëkatën nëpër botë.

Zoti, për shkak të dashurisë së tij të përjetshme, u bë njeri në personin e Jezu Krishtit që vdiq në vendin tonë, duke paguar dënimin për mëkatën. Njerëzimi mund të ketë marrëdhënie të përtërirë me Zotin duke e vënë besimin e tij te Jezu Krishti.

Mesazhi i Biblës është i qartë për ata që do ta lexojnë dhe do të kërkojnë të zbulojnë kuptimin e saj. Problemi shfaqet kur njerëzit sjellin nocionet e tyre paragjyquese ndaj Biblës dhe orvaten ta bëjnë Fjalën të përshtatet me idetë e tyre paragjyquese. Ky nuk është faji i Biblës, por i njerëzve që e detyrojnë Biblën të thotë atë që ata duan të thonë.

Sa i takon çështjes së emërtimeve të ndryshme të Kishës, duhet theksuar se ato nuk janë formuar për shkak ndarjeje rreth mësimave qëndrore të krishterimit. Ndryshimet janë rezultat i faktorëve të ndryshëm, duke përfshirë atë kulturor, etnik e shoqëror. Kur janë të krahasuar ngushtësisht me njëri-tjetrin, dallimet doktrinare nuk janë gjithmonë aq kritike.

Disa e përdorin këtë argument si një shfaqësirë se përse nuk besojnë të Jezusi, mirëpo ashtu siç ngjet edhe me të tjera argumente, edhe ky nuk del i vlefshëm. Jezusi e bëri krejt të qartë thelbin, kur tha: "Kush beson në Birin, ka jetë të përjetshme, kurse kush nuk i bindet Birit, nuk do të shohë jetë, por zëmërimi i Perëndisë qëndron mbi të." (Gjoni 3:36)

Shpesh mosmarrveshja nuk qëndron aq shumë te interpretimi i Shkrimit, por te zbatimi i tij.

Si mund të besoni një Bibël që ka plot mospërputhje?

Është vërtetë për t' u cuditur sesa shpesh bëhet kjo pyetje. Në të gjendet supozimi se Bibla është mbushur plot me mospërputhje të qarta të cilat, në qofshin të vërteta, ta bënin të pamundur të besonin që Bibla është me prejardhje hyjnore. Është një ide e përhapur dhe e zakonite të mbahesh te ideja që thotë se Bibla bie në kundërshtim me vetveten, duke hedhur, kështu, dyshim të konsiderueshëm mbi besueshmërinë e saj. Nëse Bibla në fakt do të paraqiste gabime të pakundërshtueshme, do të tregonte se,

të paktën ato pasazhe nuk do të kishin ardhur nga një Zot i përsosur që di gjithçka. Ne nuk kemi përse të grindemi me këtë përfundim, por ne nuk biem kurrë në një mendje me premisën se Shkrimet na qenkan plot me gabime. Është shumë e lehtë ta akuzosh Biblën për pasaktësitë e tij, por është çështje krejt tjetër t'i provosh ato. Paragrafe të caktuara, në vështrim të parë, na duken sikur janë kundërthënës, mirëpo shqyrtimi i afërt i tyre më pas do të na bindte se ky pretendim nuk mund të qëndrojë.

Një nga gjërat për të cilat ne bëjmë apelim kur është fjala për shqyrtime të kundërthënieve të pretenduara, është paanshmëria. Ne nuk duhet ta zvogëlojmë apo ta zmadhojmë problemin dhe gjithmonë t'i japim autorit dobinë e dyshimit. Ky është një rregull që zbatohet përgjithësisht në letërsi dhe ne duam që ky rregull të zbatohet edhe këtu. Ne konstatojmë se njerëzit kanë prirje të zbatojnë rregulla të ndryshme kur kanë të bëjnë me shqyrtimin e Biblës dhe këtë e kundërshtojnë menjëherë. Çfare e përcakton një kontradiktë? Ligji i moskontradiktës i cili është baza e gjithë të menduarit logjik, thotë se një send nuk mund të jetë njëherësh "a" dhe "jo-a". Më fjalë të tjera, nuk mund njëherësh të bjerë shi dhe në të njëjtën kohë të mos bjerë shi.

Në qoftë se dikush mund të paraqesë një dhunim të këtij rregulli të Shkrimit, atëherë dhe vetëm atëherë ai mund të vërtetojë një kontradiktë. Për shembull, po qe se Bibla tha (çfarë dhe nuk e thotë), — se Jezusi vdiq me kryqëzim njëherësh në Jeruzalem dhe në Nazaret, ky do të ishte një gabim i vërtetuar.

Kur ndeshim kundërshtime të mundshme, është e një rëndësie të madhe të kuptojmë se dy deklaratat mund të ndryshojnë nga njëra-tjetra pa qenë kontradiktore. Disa dështojnë në të qartësuarit e një kontradiksioni dhe ndryshimi.

Për shembull, rasti i të verbërve në Jeriko. Mateu rrëfen se si dy burra të verbër takuan Jezusin, kurse që të dy Marku dhe Luka përmendin vetëm një. Si do që të jetë, asnjëra prej këtyre thënieve nuk mohon tjetrën, por, ato janë plotësim i njëra-tjetrës.

Le të mendojmë se po bisedonit me prefektin e qytetit tuaj dhe me kryetarin e policisë në bashki. Më pas ju shihni mikun tuaj Xhim dhe i thoni se sot ju biseduat me prefektin. Një ore më pas, ju shihni mikun tuaj Xhon, dhe i thoni se biseduat me prefektin dhe kryetarin e policisë.

Kur miqtë tuaj krahasojnë thëniet, kjo në dukje merret si kontradiksion. Por nuk ka asnjë kontradiksion. Nëse i treguat Xhimit se biseduat vetëm me prefektin, ju do të kishit kontradiktuar atë deklaratë që i thatë Xhonit.

Deklaratat që në të vërtetë ju i bëtë Xhimit dhe Xhonit janë të ndryshme, por jo kontradiktore. Gjithashtu shumë deklaratat biblike rastisin në këtë kategori. Shumë mendojnë se gjejnë gabime në paragrafe që nuk i kanë lexuar saktësisht.

Te libri i Gjyqtarëve kemi shkakun e vdekjes së Siseras. Te Gjyqtarët 5:25–27 Jaela gjoja do ta ketë vrarë me çekiçin dhe kunjin e saj ndërsa po pinte qumësht. Gjyqtarët 4:21 thotë se ajo e bëri vrasjen ndërkohë që ai flinte. Megjithatë, një lexim më i kujdesshëm i Gjyqtarëve 5:25–27 do të zbulojë se nuk është thënë se ai po pinte qumësht në çastin e goditjes. Kështu që mospërputhja zhduket.

Nganjëherë dy paragrafe duken si kundërthënës, sepse përkthimi nuk është i kujdesshëm, ashtu sikundër edhe duhej të ishte. Një njohje e gjuhës origjinale e Biblës mund t'i zgjidhë menjëherë këto vështirësi, sepse që të dyja si greqishtja ashtu edhe hebraishtja-si të gjitha gjuhët — kanë tiparet e tyre që i bëjnë të vështira për t'i përkthyer në shqip apo në ndonjë gjuhë tjetër.

Shembulli tipik ka të bëjë me tregimet e shndërrimit të Palit sikurse përshkruhet në Librin e Veprave. Te Veprat 9:7 thuhet: "Dhe njerëzit që udhëtonin me të ndaluan të habitur, sepse dëgjonin tingullin e zërit, por nuk shikonin njëri". Te Veprat 22:9 lexojmë: "Edhe ata që ishin me mua e panë dritën dhe u trembën, por nuk dëgjuan zërin e atij që fliste".

Këto deklaratime duken kundërthënëse, kur njëri thotë që shokët e Palit dëgjuan një zë, ndërkohë që dëshmia tjetër thotë se asnjë zë nuk u dëgjua. Megjithatë njohja e greqishtes e zgjidh këtë vështirësi. Sikurse shkencëtari i greqishtes, W. F. Arndt shpjegon:

"Ndërtimi i foljes dëgjo" (*akouo*) nuk është i njëjtë në të dy raportet. Te Veprat 9:7 ajo përdoret me gjinoren, kurse te Veprat 22:9 me kallëzorën. Ndërtimi me gjinoren shpreh thjesht se diçka po dëgjohej ose se tinguj të vërtetë arrijnë te veshi; asgjë nuk tregohet nëse ndokush kupton se çfare dëgjon ose jo.

Ndërtimi me kallëzoren, megjithatë, përshkruan një dëgjim që përfshin kuptim mendor të mesazhit të folur. Prej kësaj bëhet e qartë se të dy paragrafët nuk janë kundërthënës.

Te Veprat 22:9 nuk mohohet se shoqëruesit e Palit dëgjuan disa tinguj, aty thuhet thjesht se ata nuk dëgjuan në një mënyrë të atillë sa të kuptonin se çfarë po thuhej. Në një rast si ky idioma jonë angleze nuk është aq shprehëse, si ajo greke (*Does the Bible Contradict Itself?* f. 13–14).

Duhet theksuar, gjithashtu, se kur jepet një shpjegim i mundshëm ndaj një vështirësie në Bibël, është e paarsyeshme të deklarosh se pasazhi përmban një gabim të provuar. Disa vështirësi të Shkrimit vijnë nga dija jonë e pamjaftueshme për rrethanat dhe kësaj nuk përbejnë domosdoshmërisht një gabim. Këto provojnë vetëm atë që ne jemi të paditur sa i takon sferës se historisë.

Sikurse rrjedh nga studimet historike dhe arkeologjike, dritë e re po hidhet mbi pjesët e vështira të Shkrimit dhe shumë "gabime" janë

zhdukur nga kuptimi i ri. Qëndrimi ynë duhet të jetë: të presim e të shohim mbi disa probleme.

Ndërkohë të gjitha vështirësitë dhe mospërputhjet e Biblës ende nuk janë qartësuar. Bindja jonë e plotë është se sa më shumë dije të fitohet nga e shkuara e Biblës, aq më shpejt këto probleme do të shuhen. Koncepti biblik për Zotin është ai i një qenieje të gjithëdijshme të gjithëfuqishme, që nuk e kundërshton vetveten; rrjedhimisht ne ndjejmë se Fjala e Tij, kur kuptohet siç duhet, nuk do ta kundërshtojë veten.

E vërteton dëshmia arkeologjike Biblën? Si lidhen zbulimet arkeologjike me ngjarjet të Shkrimit të shenjtë?

Arkeologjia është studimi i gërmadhave të paprishura, mbeturinat që njeriu ka lënë pas vetes e që kanë mbijetuar përmes rrënimeve të kohës. Motivi fillestar për gërmimin e qytetërimeve të lashta ishte dëshira për thesaret e varrosura.

Sot, sidoqoftë, metodat më moderne shkencore janë përdorur për të mëkëmbur dhe studiuar mbetjet e së kaluarës me qëllim që të arrihet një kuptim më i plotë i popujve të lashtë si dhe i zakoneve të tyre. Lindja e Mesme, veçanërisht zona e Palestinës, është objekt i shumë gërmimeve arkeologjike për shkak të vazhdimësisë së saj historike.

Është e rëndësishme të shënojmë se arkeologjia pa historinë është e pakuptimtë. Gjithçka që arkeologjia mund të na tregojë është vazhdimësia e zhvillimit kulturor, jo një kronologji e saktë. Historia na jep kronologjinë, ngjarjet, njerëzit, vendet.

Çfarë arkeologjia ka bërë këto 100 vjetët e shkuara është të verifikojë diçka nga historia e ndodhur në Bibël. Për shembull, dy nga qytetet e përmendura në Bibël Sodoma dhe Gomorra, për shumë vite diheshin si mitologjike. Por megjithatë, gërmimet e fundit në Tell Mardikh¹, e njohur tashmë si vendi i Eblës, zbuluan afro 15.000 pllaka guri me mbishkrime. Disa prej tyre ishin përkthyer dhe bëhet fjalë për Sodomën dhe Gomorrën.

Vërtetimet e tjera arkeologjike përmbledhin provën se jetonte një sundimtar i quajtur Belteshacar; se hitasit, jo vetëm që ekzistonin, por edhe se kishin një përandori të gjerë; se mbreti Sargon sundoi dhe se çështjet që shtjellojnë historinë në Librin e Veprave, janë provuar si të sakta. Deri tani, gjetjet e arkeologjisë kanë vërtetuar dhe në asnjë rast nuk kanë kundërshtuar pikat historike të dokumentuara në Bibël.

Ndërkohë që arkeologjia mund të vërtetojë historinë dhe të hedhë dritë mbi paragrafë të ndryshëm të Biblës, është përtej fushës së arkeologjisë të provojë se Bibla është Fjala e Zotit. Në kohën tonë arkeologjia është një

1. Tell (arab), Tel (hebraisht), përgjithësisht përfshihet në një qytet të lashtë mbushur plot mbeturina profesionale që mbulojnë periudha të ndryshme historike dhe arkeologjike të ndërtesave e rrugëve. (shën. i përkthyesit).

shkencë në përmirësim, më të dhëna të kufizuara, por edhe pse me disa kufizime, ajo shpjegon se shumë pasazhe biblike janë historikisht të sakta. Njeriu nuk mund të theksojë fuqishëm rëndësinë e Biblës në dhënien e tablos së përpiktë historike. Krishterimi është një fe historike që pretendon se Zoti ka hyrë në histori me shumë vepra të fuqishme.

Edhe pse mrekullitë e regjistruara te Shkrimi nuk mund të provohen shkencërisht ose të përsëriten për shkak të natyrës së tyre, personat, vendet, dhe ngjarjet mund të hetohen historikisht. Në qoftë se shkrimtarët biblikë do të ishin të pasaktë në tablonë e tyre historike, atëherë dyshimi serioz do të binte mbi besueshmërinë e tyre në fushat, të cilat nuk do të mund të vërtetoheshin.

Duke e thënë ndryshe, nëse autorët e Shkrimit janë të saktë në të paraqiturit e gjërave që ndodhen, atëherë kjo do të thotë se atyre nuk mund t'u kthehet një vesh i shurdhër vetëm sepse tregonin gjëra të jashtëzakonshme.

Çfarë janë pergamenat e detit të vdekur?

Në botimin e librit të tij të shkëlqyer *"Our Bible and Ancient Manuscripts"* në vitin 1948, z. Frederik Kenyon, studiues tekstesh, shruante: "Sigurisht nuk ekziston as edhe një mundësi që ne të gjejmë dorëshkrime të tekstit hebraik që do të na çonin te periudha para formimit të tekstit, të cilin ne e njohim si masoretik¹. Ne mund të arrijmë një ide për të, vetëm nëpërmjet studimit të përkthimeve të hershme të bëra prej tij. (cituar Charls Pfajfër, *"The Dead Sea Scrolls and the Bible"*)

Ndërkohë që libri i Kenyon-it ishte në procesin e botimit, zbulimet e nisura në vitin 1947 bënë përsëritjen e interpretimeve të tij të pamundur. Deri atëherë studiuesit zotëronin vetëm pllaka argjili të Babilonit dhe papiruse egjiptiane që i ndihmonin të kuptonin informacionin historik të Biblës, ndërkohë që nuk dihej nëse ndonjë nga dorëshkrimet e Dhiatës së Vjetër të kishte arritur të mbijetonte.

Mirëpo e gjithë kjo ndryshoi kur u zbuluan disa pergamene shpëllat përgjatë anës veriPerëndimore të Detit të Vdekur. Këto pergamena i sollën botës dorëshkrime të librave të Dhiatës së Vjetër 1000 vjet më të vjetra sesa ndonjë dorëshkrim tjetër i gjetur më parë. Zbulimi u shoqërua me ngazëllim të menjëhershëm. Dr. William F. Albrajt, një nga arkeologët më të dëgjuar në mbare botën, në një letër dërguar John Treverit, i cili kishte meritë të madhe në këtë zbulim, i thoshte: "Urimet e mia më të përzemërta për zbulimin më të madh dorëshkrimor në kohët tona

1. Masoretik, nga "masora" botim i Dhiatës së Vjetër bërë nga shkrimtarë hebrenj ndërmjet shek. 2-10 (era jonë) për ta ruajtur Dhiatën e Vjetër nga shprishja dhe keqinterpretimi. Mbiemri "masoretik" vjen nga emri "masorët" (hebraisht masoret) dhe nënkupton njërin prej shkrimtarëve hebrenj që plotësoi Masorën. (Shënim i përkth.)

moderne. Nuk kam asnjë dyshim se shkrimi është me i vjetër sesa ai i papiruseve Nash (një pjesë shumë e vogël e Dhiatës së Vjetër datuar midis shekullit të dytë para Krishtit dhe vitit të parë të erës sonë). Unë do të preferoja një datë aty rreth vitit 100 para Krishtit... Eh, çfarë zbulim i pabesueshëm! Për fat të mirë, nuk mund të ekzistojë as edhe dyshimi më i vogël për vërtetësinë e këtij dorëshkrimi.”

Para zbulimit të këtyre papiruseve, kopja më e vjetër e Dhiatës së Vjetër të plotë në hebraisht ishte *Codex Babylonius Petropolitanus* datuar aty nga v. 1008 (era jonë), d. m. th. 1400 vjet pasi ishte plotësuar Dhiata e Vjetër. Fragmentet prej papiruseve të Detit të Vdekur tashmë mbyllën të çarën me njëmijë vjet dhe e lanë botën në pritje nëse teksti ishte trans-metuar saktësisht. Përgjigjja ishte një “Po” plot jehonë.

Pergamenet e Detit të Vdekur vërtetuan pa dyshim faktin se izraelitët ishin besnikë ndaj transkriptimit të dorëshkrimeve biblike. Ky nderim për Shkrimet ishte përmbledhur shumë kohë më parë prej historianit izraelit të shekullit të parë, Flavi Josef¹):

“Ne kemi provuar praktikisht nderimin ndaj Shkrimeve tona, sepse edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë, askush nuk ka guxuar as të shtojë e as të heqë apo të ndryshojë një rrokje; është në instinktin e çdo izraeliti që nga dita e lindjes së tij t’i nderojë ato si urdhra të Perëndisë; të qëndrojnë i palëkundur ndaj tyre dhe, po të jetë nevoja, të vdesë me gëzim për to. Herë pas here, dëshmohet tabloja e të burgosurve që më mirë durojnë torturën dhe vdekjen në çdo formë në amfiteatër sesa të shqiptojnë qoftë edhe një fjalë të vetme kundër ligjeve dhe dokumentave të tjerë të afërt”. (“*Flavi Josef kundër Apionit*” në “*Josef, Veprat e mbledhura*” përkthyer nga William Whinston, Grand Rapids, Kregel Pub, 1960 f. 174, 180).

Qëndrimi që Josef-i përshkroi, vërtetohet nga krahasimi i tekstit masoretik, i cili është baza e Biblave tona hebreje, dhe i pergamenave të Detit të Vdekur. Midis fragmenteve të zbuluara gjenden kopje të plota ose pjesë të çdo libri të Dhiatës së Vjetër, me përjashtim të librit të Esterës, ndryshimet në tekst pas një mijë viteve të kopjimit, janë shumë të vogla. Kështu që çdo apelim ndaj papiruseve të Detit të Vdekur që të hidhte dyshim mbi besueshmërinë e Biblës, është i pavlerë. Charls Pfajfër thoshte këtë: “Duhet shënuar se, ndërsa pikëpamjet negative të kritikës së lartë biblike nuk mund të përgënjeshtrohen nga një studim i pergamenave të Kumranit (Kumrani është trualli kryesor në zonën e Detit të Vdekur, ku ishin gjetur papiruset), nuk ekziston as edhe një dëshmi prej Kumranit që të vërtetojë një rivlerësim të madh të pikëpamjeve tradicionale të origjinës të Shkrimeve biblike.

“Librat e Dhiatës së Vjetër të Kumranit janë ato që ne i gjejmë në Biblën

1. Flavi Josef jetoi nga 37–95 (e. s) Shën. i përkth.

tonë. Variantet më të vogla tekstuale ndeshën prej dore sikurse vërehen edhe në çdo dokument i cili varet mbi kopjet për shumëfishim por teksti biblik, mund të konsiderohet si thellësisht i besueshëm". (Pfafjër, *The Dead Sea Scrolls and The Bible*, f. 114).

Rrjedhimisht, zbulimi i pergamenave të Detit të Vdekur mbështet vetëm afrimin kritik konservator të Dhiatës së Vjetër, sikundër miratojnë edhe studiuesit e kësaj pikëpamjeje mbi studimin e besueshmërisë së librave të Dhiatës së Vjetër.

Përse ekzistenca e popullit izraelit është dëshmi objektive se Bibla është e vërtetë?

Nëse dikush dëshiron të dijë nëse ekziston ose jo Zoti i Biblës, një nga arsytet më të forta që ai mund të shqyrtojë është populli izraelit. Një kërkim i ndershëm në këtë çështje do të na japë një përgjigje më se të mjaftueshme për të vërtetën e besimit të krishterë.

Rreth 4000 vjet më parë, Zoti thirri një njeri të quajtur Abraham prej vendit ku jetonte dhe i dha këto premtime: "Unë prej teje do të bëj një komb të madh, do të të bekoj dhe do ta bëj të madh emrin tënd dhe ti do të jesh një bekim, dhe unë do të bekoj të gjithë ata që do të të bekojnë dhe do të mallkoj ata që do të të mallkojnë; tek ti do të jenë të bekuar të gjitha familjet e tokës" (Zanafilla 12:2, 3).

"Dhe Zoti i tha Abrahamit... çdo tani sytë e tu dhe shiko nga vendi ku je drejt veriut dhe jugut; drejt lindjes dhe perëndimit. Tërë vendin që sheh, unë do të ta jap ty dhe pasardhësve të tu përgjithnjë" (Zanafilla 13:14, 15).

Me fjalë të tjera, Zoti i premtoi Abrahamit (1) një komb të madh; (2) një emër të madh; (3) të qenit bekim për të gjitha kombet, dhe (4) një tokë e cila do t'i përkiste pasardhësve të tij përgjithmonë.

Disa qindra vjet pasi Zoti i bëri këto premtime Abrahamit, sigurisht që kombi i madh ishte shfaqur i përbërë nga miliona njerëz. Ata ishin gati në të hyrë të tokës së premtuar kur Zoti, nëpërmjet udhëheqësit të tyre, Moisiut, u dha disa paralajmërime sikurse përmenden te Ligji i Përtërire 28:33.

Zoti i paralajmëroi ata kundër mosbindjes dhe u premtoi se Ai do të sillte kombe të tjera për t'i shpërngulur ata prej asaj toke, po qe se ata do të tregoheshin të pabesë ndaj Tij. Ai paratha se ata do të shpërndaheshin përfundimisht nëpër botë si të huaj në vende të panjohura dhe se nuk do të gjenin prehje nga bredhjet e tyre. Megjithatë, Zoti, me besnikërinë e Tij, u premtoi t'i kthente në tokën e tyre.

Po cili ka qenë gjykimi i historisë? Bijtë e Izraelit, edhe pse ishin paralajmëruar, ranë në idhujtari dhe u përzunë prej dheut të tyre. Në v. 606 para erës sonë, mbreti Nabukadnecar e shpuri popullin e kapur në

Babiloni, u kthye në v. 586–588 para erës sonë dhe, pas një rrethimi të gjatë, dogji edhe tempullin bashkë me qytetin. Megjithatë, ashtu siç Zoti u pati premtuar, Ai i lejoi ata që dëshironin të ktheheshin në tokën e tyre në v. 537–536 para erës sonë, apo edhe pas shtatëdhjetë vjetësh (Ezra, kap. 1)

Shpërngulja e dytë prej atdheut të tyre ngjau në v. 70 (era jonë), kur gjenerali romak Tit shkatërroi qytetin e Jeruzalemit dhe shpërndau popullin. Për afro 1900 vjet izraelitët endeshin nëpër botë, të huaj e të përndjekur nga të gjitha drejtimet. Kjo periudhë arriti kulmin me shfarosjen masive që iu bë gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur gjashtë milionë çifutë u vranë në kampet e përqëndrimit.

E megjithatë, kundër gjithë gjasave, shteti i Izraelit rilindi më 14 maj 1948 dhe izraelitët zunë të riktheheshin në atdheun e tij nga të gjitha anët. Kjo ishte hera e dytë në historinë e tyre, kur u shpallën komb dhe u kthyen në vendin e tyre. Që nga v. 1948 ata ia dolën përsëri të mbijetojnë nëpërmjet përlëshjeve të tmerrshme, përfshi këtu Luftën Gjashtëditshë në v. 1967 dhe Luftën e Jom Kipurit në 1973.

Gjatë tërë kësaj kohë kombi as u shprish e as e humbi identitetin e vet. Historia ka treguar që një popull që mërgohet nga atdheu i tyre do të humbë identitetin e tyre pas rreth 5 brezave, duke u tretur në kulturën e re, por çifutët kanë mbetur një njësi e veçantë. Jo vetëm që mbijetuan, por kombet që i përndoqën Moabi, Amoni, Edoni, Filistia dhe shumë të tjerë, ose u shkatërruan krejt ose humbën plotësisht identitetin e tyre.

A keni dëgjuar ndonjëherë për një moabas suedez, për një filistin, për një edomas apo për një amonas? Jo! Ata kanë qenë krejtësisht të tretur prej zakoneve, kulturave dhe racave të tjera. Por, a keni degjuar ndonjëherë për një çifut suedez, çifut rus, çifut gjerman ose për një çifut amerikan? Po! Ashtu edhe sikurse ishte parathënë, ata nuk e kanë humbur identitetin e tyre.

Njëri nga ne po ndiqte njëherë një debat për personin e Jezu Krishtit, në të cilin merrte pjesë edhe një rabin. Në fazën e pyetjeve, dikush e pyeti rabinin se përse nuk besonte në ringjalljen e Jezusit. “Po unë nuk besoj më mrekullitë e Dhiatës së Re” u përgjigj rabinin. Një student mendjehollë e pyeti rabinin se përse ai hidhte poshtë mrekullitë e Dhiatës së Re dhe pranonte ato të Dhiatës së Vjetër. Pa lëvizur fare qepallat e syve rabinin u përgjigj: “Kush tha? Unë nuk besoj as te mrekullitë e Dhiatës së Vjetër. Unë mendoj se ato janë të gjitha të miat. “Vështirë të besohet që ai të jepte një përgjigje të tillë, duke marrë parasysh faktin se vetë mbijëtesa e tij si çifut, është një prej mrekullive më të mëdha në gjithë vazhden e historisë.

Kur ne të dy ndodheshim në Izrael më 1976, duke realizuar filmin “Më shumë se zdrukthtar” u ftuam të takonim një zyrtar të lartë të

qeverisë së Izraelit. Një prej pyetjeve që ne i bëmë atij kishte të bënte me të mbijetesën e kombit të tij. Si ia dolën ata të mbijetonin duke qenë dy herë të shpërngulur nga atdheu i tyre, herën e dytë gjatë thujasë 1900 vjetësh; mbijetuan holokaustin ku një në tre çifutë ishte dërguar në vdekje dhe parandaluan sulmet e më shumë se 100 milionë anëtarëve të botës arabe në 1967 dhe 1973? A ishte kjo rrjedhojë e mendjemprehtësisë së kombit të tyre apo e ndonjë dore hyjnore që mbronte popullin e vet? Ai na vështroi të dyve dhe tha: "Edhe pse shumica e njerëzve në atdheun tim do të pohonin se janë ateistë, mos e besoni këtë. Unë mendoj se ne të gjithë e dimë mirë se një forcë më e madhe se e jona e ka mbrojtur këtë komb". Ai shtoi se pas marrjes së fundit të Jeruzalemit nga çifutët, atje gjendeshin afërsisht një milion njerëz ose në murin e vajtimit ose në rrugë e sipër drejt tij, për t'i dhënë falenderime Zotit.

Zoti i Biblës është besnik. Ai ka provuar si ekzistencën ashtu edhe besnikërinë e vet, duke e trajtuar kombin izraelit si shenjë objektive për botën, prove të ekzistencës së vet dhe të vërtetësisë së premtimeve të Veta.

Përse të krishterët i drejtohen përmbushjes së profecisë për të provuar që Bibla është Fjala e Zotit?

Besimtarëve të Jezu Krishtit vazhdimisht u kërkohet të shpjegojnë përse besojnë që Bibla është e frymëzuar dhe një përgjigje e zakonte është për shkak të profecisë së plotësuar. Argumenti për profecinë e plotësuar është një nga më të fortat që mund të merren me mend.

Apostulli Pjetër, pasi provoi se e kishte parë Jezu Krishtin me gjithë lavdinë e Tij, tha: "Ne e kemi të vërtetuar fjalën profetike, së cilës bëni mirë t'i kushtoni kujdes si një kandil që ndriçon në një vend të errët, derisa të zbardhë dita dhe ylli i dritës të lindë në zemrat tuaja". (2 Pjetër 1:19) Pjetri këtu i drejtohet profecisë së plotësuar si dëshmi ndaj së vërtetës së Shkrimeve.

Bibla vetë jep qëllimin e profecisë. "Kujtoni gjërat e kaluara të kohëve shumë të vjetra, sepse unë jam Perëndia dhe nuk ka asnjë tjetër, jam Perëndia dhe askush nuk më ngjet Mua që shpall fundin që në fillim dhe shumë kohë më parë gjërat që ende nuk janë bërë..." (Isaia 46:9, 10)

"Unë shpalla gjërat e kaluara që në fillim kishin dalë nga goja ime dhe kisha bërë që t'i dëgjonin, pastaj veprova papritmas dhe ato ndodhën. Pastaj unë jua shpalla ato juve para se të ndodhnin, që të mos kishe për të thënë: "I ka bërë idhulli im, i ka bërë shëmbëlltyra ime e gdhendur dhe shëmbëlltyra ime e shkrirë" (Isaia, 48:3, 5).

Diata e Re foli për ardhjen e Jezu Krishtit "siç i kishte premtuar ai më anë të profetëve të tij në Shkrimet e Shenjta" (Romakëve, 1:1-4)

Prova e Shkrimeve thotë që synimi i profecive është të na lënë të mësojmë që Zoti ekziston dhe se Ai ka një plan për këtë botë. Nëpërmjet parathënies së personave, vendeve dhe ngjarjeve qindra vjet para ardhjes dhe ngjarjes së tyre, Bibla tregon diturinë për të ardhmen, e cila është shumë e veçantë për t'u emërtuar si hamendje e mirë. Duke dhënë shembuj të profecive të plotësuara, Shkrimet japin dëshmi të fortë për frymëzimin e tyre. Shembull për këtë do të jetë profecia për perandorin persian Kir (Isaia 44:28; 45:1). Profeti Isaia, i cili shkroi aty rreth vitit 700 para Krishtit, e parathotë Kirin me emër si perandorin që do të thotë për Jeruzalemin se do të rindërtohet dhe se themeli i tempullit do të rishtrohej.

Në kohën e Shkrimit të Isaisë, qyteti i Jeruzalemit ishte i ndërtuar dhe tempulli ishte lartësuar i tërë. Jo më shumë se 100 vjet më vonë qyteti dhe tempulli do të shembeshin nga perandori Nabukadnecar, në vitin 586 para Krishtit.

Pasi Jeruzalemi u mor nga babilonasit, ai u pushtua nga persianët aty rreth vitit 539 (para Krishtit). Menjëherë pas këtij pushtimi një perandor persian i quajtur Kir dha vendimin për të rindërtuar tempullin në Jeruzalem. Kjo ndodhi rreth 160 vjet pas profecisë së Isaisë. Kështu, pra, Isaia tha se një njeri i quajtur Kir, që nuk do të lindte për afro 100 vjet, do të jepte urdhrin për të rindërtuar tempullin i cili ekzistonte në kohën e Isaisë dhe që nuk do të shkatërrohej për më shumë se 100 vjet. Kjo profeci është vërtet e habitshme, por jo e vetmja. Në të vërtetë gjenden me qindra profeci që parathënë ngjarjet e ardhshme. Ideja se përmbushja e profecive është fryti i rastësisë është absurde, parë në dritën e dëshmisë.

Zoti ka dhënë prova të mjaftueshme të ekzistencës së tij, si dhe të frymëzimit hyjnor të Shkrimeve, nëpërmjet profecisë së plotësuar.

Çfarë është apokrifa? Përse këto libra nuk gjenden në Biblat protestante?

Sot fjala apokrifë është sinonime në të katërmbëdhjetë apo pesëmbëdhjetë librat e mirëfilltësisë dhe të origjinalitetit të dyshimtë. Këto shkrime nuk gjenden në Dhiatën e Vjetër hebraike, nuk përfshihen në disa dorëshkrime të Septuagintit, (përkthimi greqisht i Dhiatës së Vjetër, që u plotësua rreth v. 250 para Krishtit, në Aleksandri të Egjiptit).

Të gjithë këto libra ishin shpallur Shkrime të Shenjta prej Kishës Katolike Romake në Këshillin e Trentit (1545–1563), sido që Kisha protestante hedh poshtë prejardhjen hyjnore që u ishte veshur atyre. Ata, që u vëshin autoritet hyjnor këtyre librave dhe i mbrojnë si Shkrime të Shenjta, argumentojnë se shkrimtarët e Dhiatës së Re citojnë më shumë Septuagintin, që përmban Apokrifa. Ata, gjithashtu, citojnë fakte që etërit e kishës, veçanërisht Ireneu, Tertuliani dhe Klementi i Aleksandrisë e përdorin Apokrifën në lutjet publike dhe i pranin si shkrime të shënja sikurse

bëri Kisha Siriane në shekullin e katërt.

Shën Augustini, i cili kryesonte këshillat në Hipo dhe Kartagë, ishte i një mendjeje me vendimin e tyre se librat e Apokrifës ishin të frymëzuara. Kisha Greke ushtroi ndikimin e vet mbi këtë çështje. Midis fragmenteve të Kumranit gjenden kopjet e disa nga librat apokrifë të shkruara në hebraisht, të cilat u zbuluan midis librave të tjera të Dhiatës së Vjetër.

Problemi i përfshirjes së Apokrifës si Shkrim i Shënjtë bie menjëherë poshtë me t'u shqyrtuar. Sigurisht që shkrimtarët e Dhiatës së Re mund ta citojnë Apokrifën, por kurrë nuk ngjet që ata ta citojnë si Shkrim të Shënjtë apo dhe të aludojnë për frymëzimin e saj. Nëse Septuaginti, në shekullin e parë, i përmbante këto libra, dhe kjo nuk është fakt i provuar, atëherë na rezulton se Jezusi dhe dishepujt e tij e injoruan krejt atë. T'u drejtohesh etërve të rëndomtë të kishës, të cilët i citonin këto shkrime, si provë se ato qenkan të frymëzuara, është argument i dobët, kur disa nga ata etër të kishës së hershme si, veçanërisht Origeni, Hieronimi e të tjerë, mohuan në mënyrë të plotë pretendimin se ato libra qenkeshin të frymëzuar.

Kisha siriane priti deri në shekullin e katërt (era jonë) që t'i pranonte këto libra si kanonikë. Është me interes të thuhet se Peshita, Bibla siriane e shekullit të dytë (era jonë) nuk i përmbante ato. Augustini, qoftë dhe pjesërisht, e pranoi në fillim Apokrifën, por në shkrimet e tij të mëvonshme pasqyrohet qartë heqja dorë prej atyre librave si jashtëkanonikë dhe të dorës së dytë ndaj shkrimeve hebreje. Komuniteti hebraik, gjithashtu, tregon haptas mohim ndaj këtyre shkrimeve. Në këshillin izraelit të Jamnisë (v. 90 era jonë) nëntë nga librat e Dhiatës së Vjetër ishin bërë objekt diskutimi nëse duhej apo nuk duhej të përfshiheshin. Përfundimisht ata vendosën se vetëm librat e Dhiatës së Vjetër hebre të sotme meritonin të ishin kanonikë. Pranimi i ekzistencës së Apokrifës midis fragmenteve të Dhiatës së Vjetër provon shumë pak rreth frymëzimit të tyre, duke qënë se shumë nga fragmentet e zbuluara nuk janë biblike.

Nuk mund të mos vëmë në dukje se vetë Kisha Katolike Romake deri në vitin 1545–1563 nuk i shpalli zyrtarisht këto libra si Shkrime të shënjta d. m. th. derisa u mblodh Këshilli i Trentit.

Pranimi i këtyre librave në Apokrifë si kanonikë prej Kishës Katolike Romake në një masë të madhe ishte reagim ndaj Reformacionit protestant. Duke ligjëruar këto libra, ata legalizonin referimet e tyre në çështjet e tyre doktrinare.

Argumentet që mbrojnë autoritetin biblik të Apokrifës lënë shumë për të dëshiruar. Ka disa arsye shumë kuptimplotë se përse Apokrifat është hedhur poshtë nga Kisha Protestante. Njëra prej tyre merret me mësimin jobiblik të këtyre librave të dyshimtë, sikurse është lutja për të vdekurit.

Lutja për të ndjerët, mbrojtur në 2 Makabenj 12:45–46 është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Lukën 16:25, 26 dhe Hebrenjve 9:27; Midis të tjerash Apokrifia përmban edhe episodin në të cilin paraqitet Zoti duke ndihmuar Juditën në gënjeshtëri (Judit 9:10, 13).

Apokrifia përmban gjithashtu gabime të provuara. Në mënyrë të supozuara Tobiti ishte gjallë kur Jeroboami kreu revoltën e tij më 931 (para Krishtit) dhe vazhdonte të jetonte në kohën e robërisë asiriane (722 para Krishtit), edhe pse libri i Tobisë thotë se ai jetoi vetëm 158 vjet (Tobit 1:3–5, 14:15)

Së fundi, nuk ka asnjë pretendim nga asnjëri prej këtyre librave apokrifë për t'u konsideruar me frymëzim hyjnor. Secili duhet t'i lexojë këta libra krahas Biblës për të parë ndryshimin e madh.

Çfarë kuptimi ka të themi që Bibla është e frymëzuar?

Frymëzimi i Biblës është problemi vendimtar në botën e sotme. Shumë njerëz flasin rreth frymëzimit të saj, mirëpo, kur kërkohet të përcaktojnë se çfarë kuptojnë me frymëzim, na japin një mori përkufizimesh. Disa kënaqen të thonë se Bibla është njëllor e frymëzuar sikurse gjithë letërsia e madhe. “Ajo nxit zemrën njerëzore të arrijë lartësi të reja.” pohojnë ata.

Megjithatë, ky pohim nuk e bën Biblën unike e të pashoqe. Shume vepra, përfshirë këtu ato të Shekspirit e të Homerit apo dhe të Dickens-it, kanë dhënë përfundime të njejta. Shkurt, ata e vlerësojnë Biblën si kryevepër letrare njerëzore dhe jo me prejardhje hyjnore.

Të tjerë e konsiderojnë të frymëzuar, sepse përmban fjalën e Zotit bashkë me mitet, gabimet dhe legjendat. Ata thonë se është gabim ta njejtësojmë Biblën me fjalën e Zotit. E thënë më qartë për ta, Bibla është dëshmi e bisedës së Zotit me njerëzimin. Rrjedhimisht Fjala e Zotit mund të gjendet në Bibël, porse Fjala e Zotit nuk mund të jetë sinonimike me Biblën. Dy rreshta i tregojnë thelbin e problemit: 2 Timoteu 3:16 dhe 2 Pjetrit 1:21. Së pari thotë: “I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim e drejtësi. Fjala “i frymëzuar” është përkthyer nga greqishtja “*theopneustos*”, që do të thotë “i fryrë nga Perëndia”. Kështu që prejardhja e Shkrimit është Perëndia, jo njeriu; frymëzimi është “Frymëdhënie Perëndie”. Rreshti i dytë, 2 Pjetrit 1:21 thotë: “Sepse asnjë profeci nuk ka ardhur nga vullneti i njeriut, por njerëzit e shenjtë të Perëndisë kanë folur, të shtyre nga Fryma e Shenjtë. “Kjo thënie, gjithashtu, vërteton se shkrimtarët ishin nxitur nga Zoti për të regjistruar atë që vetë Zoti dëshironte të thoshte. Diktimi mekanik nuk u përdor siç pretendojnë disa. Përkundrazi Zoti përdori secilin shkrimtar në veçanti duke ruajtur personalitetin e çdonjërit për të realizuar e përmbushur kështu një vepër të pushtetshme dhe hyjnore.

Procesi i frymëzimit u shtri në çdo fjalë, në tërë Shkrimin, duke

përgënjeshtuar idenë e mitit e të gabimit. Derisa Perëndia qëndron prapa Shkrimeve dhe është i përsosur, rezultati duhet të jetë i saktë. Po të ishte i gabuar, ne do të mbeteshim me një gabim të frymëzuar nga Perëndia! — Kjo ide duhet kuptuar qartë, sepse gjithë besimi i krishterë është i bazuar mbi premisën që thotë: “Zoti është, dhe Ai nuk është i heshtur”, sikundër e thoshte edhe teologu i ndjerë Francis Schaeffer.

Nganjëherë është më lehtë të kuptosh konceptin e frymëzimit, kur ai krahasohet me zbuluesin. Zbuluesi merret me prejardhjen dhe jep fakte të së vërtetës (1 Korintasve 2:10). Frymëzimi, nga ana tjetër, ka të bëjë me marrjen dhe regjistrimin faktik të së vërtetës.

Frymëzim do të thotë: “Perëndia, Shpirti i Shenjtë, punoi në mënyrë unike e të mbinatyrshme, kështu që fjalët e shkruara të shkrimtarëve të shkrimit, ishin, gjithashtu, fjalët e Perëndisë.”

Autorët njerëzorë të Shkrimit shkruan në mënyrë të vetëdijshme duke vënë në punë mendjet dhe përvojat e tyre, edhe pse fjalët e tyre nuk ishin thjesht fjalët e njerëzve, por faktikisht të Perëndisë. Kontrolli i Perëndisë ishte gjithmonë bashkë me ta në të shkruar, duke dhënë si rezultat Biblën-Fjalën e Perëndisë nëpërmjet fjalëve të njerëzve.

Deri në ç’masë është e frymëzuar Bibla?

Nëse dikush pranon se Bibla është Fjala e frymëzuar e Perëndisë, ai shpesh edhe do të pyesë për shkallën e frymëzimit të saj. Përbën frymëzim çdo libër e çdo fjalë? A shtrihet ai në çështje historike? Çfarë mund të themi për deklaratimet shkencore në të? A përfshin ai çështje dorëshkrimore dhe përkthime?

Një deklaratë klasike që ka të bëjë më shtrirjen e frymëzimit jepet nga B. B. Warfield-i, një teolog i reformuar:

Kisha i është përmbajtur që në fillim mendimit se Bibla është Fjala e Perëndisë me kuptimin që fjalët e saj, edhe pse mbajnë mbi vete në mënyrë të pashlyeshme të vulosura shenjat e prejardhjes së tyre njerëzore, janë shkruar nën një ndikim të tillë të Shpirtit të Shenjtë, sa të konsiderohen fjalët e Zotit, shprehje e saktë e mendjes dhe e vullnetit të Tij. Kisha, gjithmonë, e ka pranuar se ky koncept i bashkëautorësisë nënkupton që mbikqyrja e Shpirtit shtrihet deri te zgjedhja e fjalëve prej autorëve njerëzorë (frymëzim verbal, por jo diktim mekanik!) dhe ruan frytin e vet prej çdo gjëje që kundërshton një autorësi hyjnore, duke siguruar, midis sendeve të tjera, besnikërinë e plotë e cila presupozohet dhe pohohet kudo nga shkrimtarët e Biblës (fragment i cituar nga libri “Pagabueshmëri”).

Doktrina e frymëzimit të plotë thotë se dokumentat origjinale u shkruan nga njerëz të cilët, edhe pse të lejuar të ushtronin personalitetin dhe talentin e tyre letrar, përsëri shkruan nën kontrollin dhe udhëheqjen e Shpirtit të Zotit,

rezultat i së cilës është çdo fjalë e Shkrimeve origjinale, një regjistrim i përsosur dhe pa gabime e mesazhit të përpiktë që vetë Zoti dëshiroi t'ia jepte njeriut." (*The Inspiration and Authority of the Bible* f. 173) "

Dy fjalë përcaktojnë shtrirjen e frymëzimit të Biblës: fjalësor dhe i plotë. I plotë do të thotë tërësor, i pakufizuar në të gjitha anët. Apostull Pali thotë te 2 Timoteut 3:16 "Gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia." Dhe Pali u drejtohet selanikasve: "Prandaj edhe falendërojmë pa pushim Perëndinë, se kur keni marrë nga ne fjalët e Perëndisë, i pritët ato jo si fjalë njerëzish, por sikurse është në të vërtetë, si fjalë Perëndie." (1 Selanikasve 2:13).

Bibla mbyllet me këtë paralajmërim: "Unë i deklaroj kujtdo që dëgjon fjalët e profecisë së këtij libri se, nëse ndokush do t'u shtojë këtyre fjalëve, Perëndia do të dërgojë mbi të plagët e përshkruara në këtë libër. Dhe, nëse ndokush heq nga fjalët e kësaj profecie, Perëndia do t'i heqë pjesën e tij nga libri i jetës, nga qyteti i shenjtë dhe nga gjërat që janë përshkruar në këtë libër." (Zbulesa 22:18, 19).

Gjithë Bibla është e frymëzuar, jo vetëm pjesët e përcaktuara. Frymëzimi shtrihet jo vetëm në të gjitha pjesët e Biblës, por edhe të fjalët. "Për këto edhe flasim, por jo me fjalët e mësuara nga dituria njerëzore, por të mësuara nga Fryma e Shënjtë, duke ndërthurur gjërat frymore më fjalët frymore." (1 Korintasve 2:13).

Nganjëherë shkrimtarët biblike i bazojnë argumentet e tyre mbi një shprehje të veçantë ose dhe fjalë të vetme. Për shembull te Galatasve 3:16 Apostull Pali citon Zanafilën 13:15 dhe 17:18, ku Zoti i thotë Abrahamit: "Tërë vendin që sheh do të ta jap ty dhe farës (pasardhësit) sate." — jo pasardhësve të tu në shumës. Argumenti i plotë i Palit është bazuar mbi emrin e dhënë në njëjës më tepër sesa në shumës. René Pache në *The Inspiration and Authority of Scripture* f. 77, jep një përmbledhje të drejt-përdrejt të kësaj ideje. Fare mirë ne mund të jemi në një mendje me të kur thotë: "Shumë shpesh kuptimi i një paragrafi të tërë qëndron tërësisht mbi një fjalë, qoftë ajo në numrin njëjës apo shumës, kohët e një foljeje, hollësitat e profecisë, saktësisë e premtimit dhe heshtjes së tekstit ndaj një çështjeje të veçantë."

Është e një rëndësie shumë të madhe të shënohet shtrirja e frymëzimit duke përfshirë çdo libër të Shkrimit, çdo pjesë të secilit libër si dhe çdo fjalë në secilin libër, sikurse na jepet në origjinal. Kjo shtrirje nuk përfshin kopjet dorëshkrimore dhe përkthimet që janë thjesht një riprodhim.

Asnjë dorëshkrim apo përkthim nuk është i frymëzuar përveç origjinalit. Megjithatë, për nga qëllimet dhe synimet, ato janë njëmendësisht të frymëzuara, derisa me numrin e madh të dorëshkrimeve të vëna në dispozicion për shqyrtim të hollësishëm, shkenca e kritikës tekstuale

mund të na japë një përfaqësim të saktë.

Rrjedhimisht në mund të sigurohemi se, kur të lexojmë Biblën, do të jemi duke lexuar fjalën e Perëndisë.

Charles Wesley, një nga themeluesit e Metodizmit, shkroi:

“Bibla duhet të jetë shpikje ose e njerëzve të mirë dhe engjëjvë; ose e njerëzve të këqij dhe dajve, ose e Perëndisë.”

Së këtejmi:

1. Ajo nuk mund të jetë shpikja e njerëzve të mirë ose e engjëjve, sepse nuk do të donin e nuk do të mund të bënin një libër e të thonin gënjeshtër gjatë kohës së të shkruarit të tij, duke përsëritur “Kështu thotë Zoti” derisa ajo ishte shpikja e tyre.
2. Ajo nuk do të mund të jetë shpikja e njerëzve të këqij apo e dajve, sepse ata nuk do të donin të bënin një libër që urdhëron të gjitha detyrat, ndalon të gjitha mëkatet dhe dënon shpirtrat e tyre në ferr në përjetësi.
3. Si rrjedhim, unë nxjerr përfundimin se Bibla duhet të jetë dhënë nëpërmjet frymëzimit hyjnor. (Robert W. Burtner dhe Robert E. Chiles në “*A Compilation of Wesley’s Theology*”, f. 20).

Provat se vetë fjalët e Biblës janë të dhëna nga Perëndia mund të përmbliken shkurtimisht si vijon:

- Ajo është pohimi i tekstit klasik (2 Timoteut 3:16)
- Ajo është dëshmia e fortë e Palit që ai fliste “Fjalë... të mësuara nga Fryma e Shënjtë” (1 Korintasve 2:13).
- Është e qartë prej formulës së përsëritur, “Është e shkruar”.
- Jezusi e tha se çfarë ishte shkruar në Dhiatën e Vjetër ishte thënë edhe rreth Tij. (Luka 24:27, Gjoni 5:39, Hebrenjve 10:7).
- Dhiata e Re vazhdimisht barazon Fjalën e Zotit me Shkrimin. (Shkrimet e Dhiatës së Vjetër, krahaso: Mateu 21:42, Romakëve 15:4, 2 Pjetrit 3:16).
- Jezusi thotë se as pjesa më e vogël e fjalës dhe e shkronjes hebraike “nuk do të kalojë para se të plotësohet gjithçka.” (Mateu 5:18). Dhiata e Re i drejtohet regjistrimit të shkruar si “Orakujve të Perëndisë” (Romakëve 3:2, Hebrenjve 5:12).

Herë-herë shkrimtarëve u ishte thënë: “Mos lini as edhe një fjalë” (Jeremia 26:2).

Madje dhe vetë Gjoni shqiptoi një mallkim për të gjithë ata që shtonin

a hiqnin nga “fjalët e profecisë së këtij libri.” (Zbulesa 22:18, 19).

Po si arritën njerëzit e gabueshëm të krijonin një libër të pagabueshem?

Një nga argumentet më të shpeshtë që drejtohet kundër pagabueshmerisë së Biblës bazohet mbi faktin se ajo u shkrua nga autorë njerëzorë. Krijesat njerëzore janë të gabueshme dhe, derisa Bibla u shkrua prej këtyre krijesave, vetë ajo forcon argumentin se është patjetër e gabueshme. Kësisoj, me këtë arsyetim, argumenti përputhet. Siç thoshtë një teolog katolik roman “Që letërsia njerëzore të mos përmbajë asnjë gabim, natyrisht se është një vetëkundërshtim, sepse asgjë nuk është më njerëzore sesa të gabosh.” (*Biblical Inspiration*, 1972).

Edhe pse ne e dëgjojmë shpesh këtë akuzë, ajo nuk është e sakte. Ne pranojmë se krijesat njerëzore bëjnë shumë gabime, madje shpesh. Mirëpo ato nuk bëjnë domosdoshmërisht gabime në të gjitha rastet, dhe jo domosdoshmërisht duhet të bëjnë gabime.

Disa vjet më parë, njëri nga ne po mësonte një klasë nxënësish lidhur më besueshmerinë e Biblës. Për zhvillimin e këtij leksioni ai kishte daktilografuar një faqe të tërë. Rezultati ishte krejt i saktë; daktilografimi nuk përmbante as edhe një gabim gjatë kopjimit të materialit origjinal. Edhe pse autori i kopjimit ishte krijesë njerëzore krejt i prirur të bëjë gabime, ai megjithatë, në këtë rast mbeti i pagabueshëm. Çështja shtrohet kështu: nuk është aspak e pamundur që një krijesë njerëzore të bëjë një veprim krejt të çliruar nga gabimi, gjithashtu, nuk është aspak e pamundur, për njeriun e gabueshëm të regjistrojë saktësisht si thëniët ashtu edhe ngjarjet. Kështu që të përjashtosh mundësinë e një Bible të pagabueshme, duke iu drejtuar gabueshmërisë së njerëzve, nuk qëndron. John Warwick Montgomery, jurist dhe teolog e ilustron kështu këtë të vërtetë:

“Udhëzimet për vënien në punë të lavatriçes sime, për shëmbull, janë pikë për pikë të pagabueshme dhe nëse unë bëj çfarë më thonë ato, makina do të më përgjigjet.

Gjeometria e Euklidit është libër i qëndrueshmërisë logjike të përsosur; prano aksionet dhe provat vijnë pashmangshmërisht. Nga këta shembuj ne përfundojmë se krijesat njerëzore, edhe pse shpesh gabojnë, mund edhe të mos gabojnë në të gjitha rastet. Sigurisht prodhimi i gjashtëdhjetë e gjashtë librave të pagabueshëm përmes shekujve është vazhdimësi vërtet e pabesueshme dhe ne i drejtohem plot ngazëllim Shpirtit të Zotit, për arritjen e tij, sepse në thelb të tij nuk gjendet asgjë metafizikë jonjerëzore apo në kundërshtim me natyrën njerëzore. Po të gjendej, a i kemi konsideruar pasojat për Kristologjinë? Atëherë, edhe Krishtit të mishëruar, si njeri i vërtetë do t'i duhej të bënte gabime, kemi parë që gabimet në mësimet e Tij do të na çonin

në mohimin e plotë të vlerës zbuluese të mishërimit duke e lënë njeriun në errësirë të plotë, përse i takon kuptimit të jetës dhe shpëtimit, sikur të mos kishte ndodhur fare mëshirimi. " (God's Inerrant Word f. 33) ".

Ne besojmë, gjithashtu, se ka dëshmi të mjaftueshme që Bibla është Fjala e pagabueshme e Perëndisë. Vetë Shkrimet dëshmojnë "I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia." (2 Timoteut 3:16). Nëse Shkrimet do të përmbanin gabime, do të quheshin gabime të frymëzuara prej Zotit. Dhe një gjë e tillë është krejt e papajtueshme me vetë natyrën e Zotit. Për shembull, te Titi 1:2 thuhet se Zoti nuk mund të gënjejë. Gjoni 17:17 thotë: "Fjala jonë është e vërteta." Shembujt do të ishin të shumtë. Dëshmia e Shkrimit është e qartë. Zoti vuri në punë njerëzit e gabueshëm të marrin e të regjistrujnë Fjalën e Tij të pagabueshme më qëllim që ajo të arrinte te ne e saktë dhe krejt pa gabime.

Mos tingëllon e vështirë kjo? Me Zotin tonë ajo nuk është e vështirë. Ja se ç'thotë Ai (Jeremia 32:27) : Ja, unë jam Zoti, Perëndia i çdo mishi; a ka vallë ndonjë gjë tepër të vështirë për mua?"

Si e dini ju që shkrimet e Apostullit Pal ishin frymëzuar?

Sauli i Tarsit, ose siç njihet ndryshe, Apostulli Pal, shkroi së paku dymbëdhjetë letra të cilat ishin përfshirë në Dhiatën e Re. Përse na duhet ta pranojmë shkrimin e këtij njeriu si Fjalë të Zotit? Pali pretendonte se ishte "Apostull jo nga njerëzit..., por nëpërmjet Jezu Krishtit dhe Perëndisë Atit". (Galatasve 1:1) Ai ishte apostull, njeri që kishte parë Krishtin e ringjallur. "A s'jam unë apostull?" — pyet ai në mënyrë retorike "Po a nuk e pashë Jezu Krishtin, Zotin tonë?" (1 Korintasve 9:1) Ai ishte, rrjedhimisht, në një pozitë autoriteti në kishën e hershme.

Apostulli mori, gjithashtu, një zbulësë të pashoqë prej Zotit, "Ungjilli që është shpallur nga unë, nuk është sipas njeriut, sepse unë nuk e kam marrë as e kam mësuar nga ndonjë njeri, por e kam marrë nëpërmjet një zbulësë nga Jezu Krishti" (Galatasve 1:11, 12). Kjo thirrje iu dha apostullit në lindje të tij. "Por kur i pëlqeu Perëndisë, që më kishte ndarë që nga barku i nënës, që të zbulojë në mua Birin e Tij" (Galatasve 1:15, 16). Ky mesazh hyjnor që mori Pali u ishte transmetuar saktësisht si kishave ashtu dhe personazheve të cilëve u shkroi.

Ai i thotë Titit: "...Perëndia, që nuk gënjen, në kohë të caktuar e shfaqti fjalën e Tij me anë të predikimit që m'u besua me urdhër të Perëndisë, shpëtimtarit tonë" (Titit 1:2, 3). Ai vazhdon të thotë: "sepse nxitja jonë nuk vjen as nga mashtrimi, as nga qëllime të pandershme, as nga dredhia, por duke qenë se u miratua nga Perëndia që të na besohet ungjilli, kështu ne flasim jo që t'u pëlqejë njerëzve, por Perëndisë, që provon zemrat tona." (1 Selanikasve 2:3, 4).

Zbulesa e dhënë Palit ishte një normë me anën e së cilës vlerësoheshin

të ashtuquajturat zbulosat e tjera. “Edhe sikur ndonjë njeri t’ju predikonte një ungjill të kundërt nga ai që keni marrë, qoftë i mallkuar.” (Galatasve 1:8) Mesazhi i tij mban vulën e pushtetit hyjnor. “Në qoftë se dikush mendon se është profet ose frymëror, lë të njohë se ato që po ju shkruaj janë urdhërime të Zotit.” (1 Korintasve 14:37).

Në letrën e parë të Palit drejtuar selanikasve, ai e bën pushtetin e tij të pastër kristal. “Prandaj edhe ne falendërojmë pa pushim Perëndinë, se kur ju keni marrë nga ne fjalën e Perëndisë, e pritët atë jo si fjalë njerëzish, por sikurse është me të vërtetë, si fjalë Perëndie, që vepron ndër ju që besoni. (1 Selanikasve 2:13) “Prandaj, ai që i përbuz këto gjëra, nuk përbuz një njeri, por Perëndinë që ju dha edhe Frymën e tij të Shenjtë”. (1 Selanikasve 4:8)

Dishepulli Simon Pjetri pohonte faktin se Shkrimet e Palit kishin pushtet hyjnor. “Dhe kini parasysh se durimi i Zotit tonë është në shërbim të shpëtimit, sikurse ju ka shkruar edhe vëllai ynë i dashur Pal, sipas ditorisë që iu dha. Ashtu bën ai në të gjitha letrat, ku flet për këto gjëra. Në to ka disa gjëra të vështira për t’u kuptuar, të cilat të paditurit dhe të paqëndrueshmit i shtrembërojnë, sikurse bëjnë në Shkrimet e tjera në dënim të vetvetes”. (2 Pjetrit 3:15–16)

Si rrjedhim ne kemi vërtetuar se Pali, i cili ishte thirrur prej vetë Zotit Jezu Krisht në rrugën për në Damask, shkruan me pushtetin e Perëndisë. Ai ishte i zgjedhur i Zotit, për të zbuluar të fshehtat e Jezu Krishtit, sepse pa shkrimet e tij, shpjegimi i vdekjes dhe i ringjalljes së Krishtit do të ishin të paplota.

Derisa Jezusi ishte njerëzor, a nuk ishte dhe Ai i gabueshëm?

Jezusi i Nazaretit ishte qenie njerëzore. Derisa qeniet njerëzore janë të kufizuara në diturinë e tyre, a nuk do të thotë kjo se edhe vetë Jezusi ishte i kufizuar? A nuk do t’i mënjanonim ne deklaratimet e Tij si të kushtëzuara nga koha e Tij? Pranohet, Ai tha gjëra të madhërisme. Por, përse duhet ta pranojmë fjalën e Tij derisa Ai ishte njerëzor?

Pyetje të tilla si këto, ne ndeshim shpesh, kur bisedojmë rreth Jezu Krishtit. Njerëzit vënë në dukje deklaratat e vetë Jezusit për të treguar se Ai ishte i paditur në disa gjëra. Kur Jezusi u pyet rreth kohës së ardhjes së Tij të dytë, Ai u përgjigj: “Sa për atë ditë dhe atë orë, askush nuk e di, as engjëjt në qiell, as Biri, por vetëm Ati”. (Marku 13:32)

Njëherë, ndërsa ishte i rrethuar nga turma, Jezusi ishte prekur nga dikush. Prandaj ai iu kthye turmës dhe e pyeti: “Kush m’i preku rrobat?” (Marku 5:30) në një mënyrë të tillë sikur të zbulonte paditurinë e tij. Me lutje, ai u bënte pyetje njerëzve: “Cili është emri yt?” (Marku 5:9), “Sa bukë keni?” (Marku 6:38).

Këto fragmente, thonë skeptikët, zbulojnë se Krishti nuk dinte disa

gjëra. E përse atëherë duhet t'u besojmë deklaratave të Tij? Dhiata e Re i përgjigjet pyetjes "Ishte Krishti i gabueshëm?" me një "jo" të fortë! Duhet mbajtur mend që Jezusi kishte dy natyra, njëra njerëzore dhe tjetra hyjnore. Si njeri, kishte gjëra për të cilat ai ishte i paditur, por si Zot, Ai zotëronte gjithë diturinë.

Jezusi nuk ishte njeri që ta niste veten drejt pozitës së të qenit Perëndi. Më saktë, ai ishte Zot i përlulur në natyre njerëzore. Te Filipianëve 2:5–11 thuhet se si Zot, Jezusi vendosi të linte mënjatë veprimtarinë e pavarur të disa tipareve që ishin me të vërtetë të tiat. Si njeri, ai i besoi Zotit, Atit, tërësisht dhe jetoi një jetë të përsosur, një jetë pa mëkate.

Edhe pse ishte Zot në Tokë, ai flaku tutje disa të drejta që zotëronte. Nuk ka asnjë aludim që deklaratat e tij — qofshin teologjike, historike, apo të një natyre tjetër — të ishin në ndonjë mënyrë të gabueshme.

Jezusi tregoi gjithmonë të vërtetën. Kur ai thoshtë se nuk dinte ndonjë gjë, ai na bënte të vetëdijshëm për të. Derisa Ai na tregoi kur nuk dinte diçka, kjo provon se kur pohoi diçka ishte sepse e dinte. Fakti që Krishti pranonte se ishte i pandërgjegjshëm për disa gjëra, na siguron ca më tepër për deklaratat që ai i bënte pa ndonjë rezervë. Kujtojmë, gjithashtu, se disa nga pyetjet e Jezusit, sikurse te Gjoni 6:5 dhe Marku 6:38 nuk u bënë që ai të mblidhte informacion për përgjigjet, por thjeshtë për të nxitur dëgjuesit të jepnin përgjigje vetë derisa të merrnin pikërisht përgjigjen e saktë nga vetë goja e tyre, për të mirë të tyre. (Krahaso Gjoni 6:5).

Një vëprim i tillë në përgjithësi ngjan me pyetjet e Zotit të Dhiatës së Vjetër (si te Zanafilla 3 "Ku je?" etj.). Këto nuk ishin thjesht pyetje për të plotësuar dijen e tij, por për të mirën e njerëzve që, në një mënyrë a tjetër, të mund të kuptonin të vërtetat, duke dhënë vetë përgjigjet e duhura. Por mund edhe të kenë qenë thjesht pyetje retorikë. Për më tepër, si krijesë njerëzore, Jezusi zotëronte njohuri dhe dije mbi normalen, ashtu sikurse e thekson Norman Gajslër në "*Christian Apologetics*" (f. 358–359): "Madje në trajtë njerëzore, Krishti zotëronte dituri mbi normalen, gati-gati mbinatyrore për shumë gjëra. Ai e pa Natanaelin nën pemën e fikut, edhe pse nuk ndodhej brenda largësisë pamore normale. (Gjoni 1:48). "Jezusi e habiti gruan nga Samaria më të dhënat që e dinte për jetën e saj personale. (Gjoni 4:18, 19)

"Jezusi e dinte që në fillim se kush ishte ai që do ta tradhtonte (Gjoni 6:64). Ai dinte për vdekjen e Lazarit, para se t'ia thonin (Gjoni 11:14) dhe për kryqëzimin e ringjalljen e Tij para se ato të ndodhnin. (Marku 8:31; 9:31) Jezusi kishte dije mbinjerëzore për vendndodhjen e peshqve. (Luka 5:4)

"Nuk ka asnjë tregues në Ungjill që të thotë se kufizimi i Jezusit frenoi misionin ose mësimin e tij. " Cilatdo të ishin kufizimet e diturisë së tij, ajo ishte përtej asaj të njerëzve të zakonshëm dhe plotësisht e mjaftueshme

për misionin dhe mësimin doktrinor të tij. ”

Bibla, gjithashtu, na bën të qartë se Krishti është autoriteti i fundit për të gjitha çështjet me të cilat ai u muar. Njerëzit do të gjykojnë për punët që bëjnë më fjalët e Tij. Ashtu sic e tha dhe vetë: “Kush më hedh poshtë dhe nuk i pranon fjalët e mia, ka kush e gjykon; fjala që kam shpallur do të jëtë ajo që do ta gjykojë ditën e fundit. ” (Gjoni 12:48)

Fjala e Tij është themel i fortë. Jeta jonë duhet ngritur mbi këtë themel. “Prandaj, ai që i dëgjon fjalët e mia dhe i vë ato në jetë, mund të krahasohet me një njeri të zgjuar që e ka ndërtuar shtëpinë e tij mbi shkëmb. ” (Mateu 7:24)

Nga këto citime të pakta bëhet krejt e qartë se ndonjë kufizim njerëzor që pësoi Jezusi, nuk u pasqyrua në thëniet dhe në mësimet e tij teologjike. Askush nuk ka të drejtë ta përdorë këtë si shfajësim, për të hedhur poshtë vërtetësinë e pohimeve të Tij. Ai na ka provuar, se ka autoritet të shpallë për vete pagabueshmerinë nëpërmjet ringjalljes në ditën e tretë. (Romakëve 1:4).

Edhe pse Jezusi me të vërtetë ishte Zot, ai ishte edhe njeri. Ju mund të thoni: Ai ishte aq shumë njeri sikur të mos kishte qenë kurrë Zot dhe ishte po aq shumë Zot, sikur të mos kishte qenë kurrë njeri. Ai ishte Njeri-Zot. Tani mbetet që secili individ të vendosë nëse do ta ndërtojë shtëpinë e vet mbi shkëmb ose mbi rërë.

Si e vlerësonte Jezusi Dhiatën e Vjetër?

Ne mund të citonim shumë argumente për të provuar që Dhiata e Vjetër është Fjala e Zotit. Por argumenti më i fortë na vjen nga vetë Zoti Jezus. Si Zot me trup njeriu Jezusi flet plot pushtet vendimtar. Dëshmia e Tij për Dhiatën e Vjetër është kumbuese dhe e qartë.

Jezusi besonte që Dhiata e Vjetër ishte e frymëzuar hyjnisht, Fjala e vërtetë e Zotit. Ai tha: “Shkrimi nuk mund të bjerë poshtë. ” (Gjoni 10:35). Ai i drejtohet Shkrimit si “Urdhër Perëndie” (Mateu 15:3) dhe si “Fjalë e Zotit” (Mateu 15:6). Ai, gjithashtu, theksoi se Shkrimi ishte i pathyeshëm. “Derisa qielli dhe toka do të kalojnë, asnjë shkronjë a pikë e Ligjit nuk do të kalojë, para se të plotësohet gjithçka. ” (Mateu 5:18). Vini re se Ai përmend, madje edhe fjalët e shkronjat.

Kur merrej me punët e njerëzve kur rrinte me dishepujt apo me udhëheqësit fetarë, Jezusi vazhdimisht i drejtohej Dhiatës së Vjetër. “A nuk e keni lexuar ç’ju ishte thënë nga Perëndia?” (Mateu 22:31) “Po, dhe a nuk keni lexuar ndonjëherë se “Nga goja e të vegjëlve dhe e foshnjave në gji, ti ke përgatitur lavdi?” (Mateu 21:16 duke cituar Psalmin 8:2) dhe “A nuk keni lexuar çfarë bëri Davidi?” (Mateu 12:3) Shembujt janë të shumtë për të vërtetuar se Jezusi e njihje Dhiatën e Vjetër. Ai citonte shumë prej saj dhe i besonte ato.

Ai vërtetoi shumë tregime nga Dhiata e Vjetër si: shkatërrimin e Sodomit dhe vdekjen e gruas së Lotit (Luka 17:29, 32), vrasjen e Abelit nga i vëllai, Kainit, (Luka 11:51), thirrjen e Moisiut (Marku 12:26), manën e dhënë në shkretëtirë (Gjoni 6:31–51), gjyqin për Tir dhe Sidon (Mateu 11:32) dhe shumë e shumë raste të tjera.

Jezusi, jo vetëm që vërtetoi historinë e këtyre dëshmimeve, por shpalli të mirëfillta edhe disa prej personazheve më të diskutuara sot.

Shumë dijetarë modernë nuk besojnë që Moisiu shkroi pesë librat e parë të Dhiatës së Vjetër, por Jezusi e besonte (shih Mateu 19:8, 9;6;7:19; Marku 12:29–31)

Disa dijetarë moderne besojnë si të vërtetë se kanë jetuar më shumë se një Isaia, kurse Jezusi besonte vetëm në një. Te Luka 4:17–21 ai citon Isainë 61:1, 2 (të ashtuquajturin Isaia i dytë ose Deutero-Isaia), ndërsa te Mateu 15:7, 8 ai i referohet pjesës së parë të veprës së Isaisë (Is 6:9) për më shumë se një autor. Tregimi i Danielit si një e dhënë e vërtetë nga vetë pena e tij, është hedhur poshtë sot prej shumëkujt, kurse Zoti Jezus e beson atë si profet. (Mateu 24:15). Tregimi për Adamin dhe Evën shpesh vihet në lojë sot si legjendë, por Jezusi e besonte atë si histori të vërtetë. (Mateu 19:1–6)

Në të njëjtën mënyrë, tregimi i Noahut dhe përmbytja e madhe jo vetëm që është e mirëfilltë për Jezusin (Mateu 24:37), por dhe është shembull i ardhjes së Tij të dytë. Së fundi, — edhe më e pabesueshmja për të gjithë, tregimi për Jonën dhe peshkun e madh, — është përdorur prej Jezusit si shenjë e ringjalljes së Tij. (Mateu 12:39).

Të duket sikur Jezusi pothuajse kishte parashikuar kritikën biblike të shekullit të njëzetë, duke i konsideruar të mirëfillta të gjitha këto tregime. Përfundimi është i thjeshtë. Nëse Jezu Krishti besohet tërësisht prej një njeriu, ai njëri duhet të besojë tërësisht edhe Dhiatën e Vjetër, duke i konsideruar tregimet e tij krejt të sakta. Shumë duan ta pranojnë Jezusin, por duan edhe të flakin një pjesë të Dhiatës së Vjetër. Kjo zgjedhje nuk është e mundur: ose Jezusi nuk dinte çfarë thoshtë, ose e dinte shumë mirë atë. Është e qartë se Jezusi e shihte Dhiatën e Vjetër si Fjalën e Zotit, qëndrimi i Jezusit ndaj tij nuk ishte veçse besimi i plotë në të.

A i përshtati Jezusi mësimet e tij me pikëpamjet e kohës ku jetoi?

Një nga teoritë më të përhapura rreth jetës së Krishtit është ajo e ashtuquajtura përshtatje me gabimin. Kjo ide e lejon këdo të kërkojë të pamundurën, sepse ajo thotë se Jezusi përshtati mësimet e tij me traditat izraelite, tradita të cilat ishin të përhapura në kohën e tij. Këto tradita kanë të bëjnë më pikëpamjet për autorësinë, frymëzimin,

saktësinë historike si dhe më vërtetësinë themelore të Dhiatës së Vjetër.

Për shembull, kjo teori mbështet mendimin se Jezusi në të vërtetë nuk besonte se Zoti shkatërroi Sodomën dhe Gomorrën (Mateu 11:23, 24), ose që njerëzit e brezit të Noahut vdiqën nga një përmytyje e madhe (Mateu 24:37, 39), që Jona ishte më të vërtetë në barkun e një peshku të madh (Mateu 12:39–41). Ata pretendojnë se qëllimi i Jezusit nuk ishte t'u mësonte njerëzve të vërtetën historike. Ai donte vetëm t'u mësonte njerëzve të vërtetën shpirtërore. Pra, përmendja e disa figurave dhe ngjarjeve historike, nuk do të thotë aspak se Jezusi i besonte ato si të vërteta.

Kjo teori, edhe pse mjaft e përhapur, ka probleme që e bëjnë atë të pamundur për t'u ndjekur. Për diçka të vogël, ajo prish të vërtetën e plotë të Biblës pikërisht atë se Zoti veprroi në rrethana historike për t'i sjellë njerëzimit mesazhin e tij shpëtimtar. Bibla thotë se njeriu është vetë përgjegjës të besojë mesazhin biblik, sepse ngjarjet dhe çuditë ndodhin në të vërtetë.

Jezusi tha: “Mjerë ti, Korazin! Mjerë ti, Betsaida! Sepse nëse në Tir dhe në Sidon do të ishin kryer veprat e fuqishme që u bënë ndër ju, prej kohësh do të ishin penduar me thes dhe hi. Prandaj po ju them se, ditën e gjyqit, Tiri dhe Sidoni do ta kenë më lehtë se ti.” (Mateu 11:21–22).

Pra, po të mos kishte ndonjë vendim gjyqi për Tirin dhe Sidonin, paralajmërimi i Jezusit drejtuar Korazinit dhe Betsaidës do të ishte pa kuptim. Sigurisht që kjo vlen edhe për tregimet e tjera në Dhiatën e Vjetër, të cilave Jezusi iu referua kur bëri krahasime. (Jona dhe ringjallja, Noahu dhe ardhja e dytë etj). Nëse këto tregime nuk do të kishin as edhe një bazë faktike, atëherë kuptimi objektiv i krahasimeve biblike zhduket krejt dhe dera e agnosticizmit dhe e ateizmit do të hapet krejtësisht në të dy kanatat.

Po si do të mund të dinim ne se ekziston ndonjë bazë besim i për pohimet shpirtërore dhe teologjike që bëri Jezusi, nëse nuk do të mund t'u besonim pohimeve të tij historike? Si do të mundej dikush të dinte se cilat pohime t'i besonte dhe cilat pohime i përshtati Jezusi para dëgjuesve të tij? Për më tepër, nëse lejojmë që disa nga pohimet historike të jenë përshtatje, përse të mos lejojmë që disa nga pohimet etike të jenë thjesht përshtatje të pikëpamjes primitive izraelite?

Është e lehtë të kuptohet se kushdo do të ecte drejt agnosticizmit nëse do ta ndjekë këtë teori me fundin e logjikës së vet; kushdo do të ishte i shtrënguar të sugjeronte një masë për të vendosur se çfarë është besimi i mirëfilltë i Jezusit dhe çfarë përshtatje është bërë prej tij për njerëzit e kohës në të cilën ai jetoi. Rrjedhimisht ne kurrë nuk do të ndiheshim të sigurtë se çfarë besoi Jezusi.

Veç kësaj, ideja e përshtatjes kundërshton gjithçka që ne dimë për

karakterin e Jezusit. Kur ballafaqohet me gabimin, Jezusi ishte gjithmonë i shpejtë për ta qortuar ashpër atë, sikur ishte ide e gënjeshtërt për Zotin ashtu dhe për një koncept të gabuar për ato që na mëson Bibla. (Mateu 15; Marku 7)

Qortimi më i fortë në tërë Shkrimin është gjetur te Mateu 23, kur Jezusi qorton ashpër udhëheqësit e gënjeshtërt fetarë të kohës së tij dhe praktikata e tyre jobiblike. Ky qortim ishte tërësisht në kundërshtim me mendimin e përhapur në kohën që rronte Krishti. Udhëheqësit fetarë besonin se Zoti do të ndihej i kënaqur me theksimet e tyre ligjore në mbështetje të shkronjës së Ligjit, por Jezusi theksonte se Zoti dëshironte që ata të mbështetnin shpirtin e Ligjit. Rrjedhimisht, Ai i etiketoi këta hipokritë, gjarpërinj dhe fëmijë të ferrit. Kjo, vështirë të jetë e pajtueshme me ndonjë teori të përshtatjes.

Së fundi, teoria e përshtatjes jep një pamje shumë të ulët të Krishtit. Jezusi thoshte: “Unë jam e vërteta. ” (Gjoni, 14:6). Teoria na thotë se jeta dhe shërbesa e Jezusit ishin në të treguarit vetëm të gjysmës së të vërtetës dhe se ai mbante për vetë atë që ai e konsideronte të pasaktë. Kjo do të thotë se Jezusi lejonte qëllimin t’i justifikonte mjetet, dhe këtë as jeta dhe as shërbësa e Tij nuk mund t’ia lejonin. Nëse Jezusi nuk tha të vërtetën e plotë, kjo do të thotë se ai nuk tha asgjë të vërtetë.

Si përfundim, ne u besojmë fjalëve të Jezusit të afta për të përmbledhur thelbin: “Në qoftë se ju fola për gjërat tokësore dhe ju nuk besoni, si do të më besoni nëse flas për gjërat qiellore?” (Gjoni 3:12)

Shumë e interpretojnë Biblën në mënyrë alegorike. Përse ju e interpretoni fjalë për fjalë?

Edhe pse disa e vlerësojnë Biblën si alegori, ne besojmë se një interpretim fjalë për fjalë është i vetmi interpretim që vë drejtësi në faktet. Ka shumë arsye për të pranuar Biblën në mënyrë literale. Bibla pretendon të jetë Fjala e Zotit. Herë pas here në gjejmë fraza të tilla si “Zoti i foli akoma Moisiut”, “Zoti foli”, “Kështu thotë Zoti”.

Kur Zoti foli, foli në situata të jetës reale, jo për gjëra të paqëna. Bibla e konsideron veten si libër faktik. Kur shkrimtarët citojnë persona ose ngjarje të tjera në Shkrim, i citojnë ato si të vërteta, jo si imagjinare ose alegorikë.

Për shembull, Jezusi i drejtohet Jonës (Mateu 12:39) si një shenjë e ringjalljes së Tij. Shkrimtari i Hebrenjve citon shumë burra dhe gra besimtarë. Asgjëkundi nuk gjendet historia e Adamit apo e Samsonit për t’u shqyrtuar veçse si ngjarje faktike. Kështu që Bibla vetë na jep një dëshmi që duhet ta pranosh literalisht. Shkrimi e interpreton Shkrimin fjalë për fjalë.

Natyrë e Zotit, sikurse na shfaqet në Bibël, na e bën të qartë se ai ka

aftësinë të komunikojë me njerëzit. Qëkurse Zoti krijoi njerëzimin me synimin e të vendosurit të një marrëdhënieje me të, pasoja e natyrshme është që ai të përdorë një metodë të kuptueshme. Rrjedhimisht, ne nuk kemi nevojë të kërkojmë ndonjë kuptim të fshehtë e të cuditshëm për atë që na thotë Shkrimi, sepse ai është shumë i qartë.

Një shembull për këtë do të jetë gjykimi i Zotit mbi mashtruesit, fundin e të cilëve Zoti e ka bërë të qartë: “Kur Zoti Jezu Krisht të shfaqet nga qielli me engjëjt e pushtetit të tij në një zjarr flakërues, për t’u hakmarrë kundër atyre që nuk njohin Perëndinë dhe atyre që nuk i binden ungjillit të Zotit tonë, Jezu Krishtit. Ata do të ndëshkohen me shkatërrim të përjetshëm, larg nga fytyra e Zotit dhe nga lavdia e fuqisë së Tij” (2 Selanikasve 1:7–9).

Është gjithashtu e rëndësishme të kuptojmë se Bibla i është drejtuar njerëzimit. Popujve u ishte dhënë përgjegjësia t’i vinin veshin asaj që Zoti kishte zbuluar e se pritej që ata ta merrnin seriozisht atë që Zoti kishte thënë. “Do të shkoni pas Zotit, Perëndisë suaj, do të keni frikë nga Ai, do të respektoni urdhërimet e Tij, do t’i bindeni zërit të Tij, do t’i shërbeni dhe do të jeni të lidhur me Të” (Ligji i Përtërirë 13:4)

Çdo mesazh nga një i ashtuquajtur profet duhej vënë në provë përkundrejt asaj që kishte thënë Zoti vetë objektivisht e fjalë për fjalë. “Shumë të dashur, mos i besoni çdo fryme, por i vini në provë për të ditur nëse janë nga Perëndia, sepse shumë profetë të rrëmë kanë dalë në botë. Nga kjo mund të njihni Frymën e Perëndisë. “Çdo frymë që rrëfen se Jezu Krishti ka ardhur me mish, është nga Perëndia. ” (1 Gjoni 4:1, 2)

Nuk ka asnjë bisedë dykuptimshme apo formulim dinak te Shkrimi. Mesazhi është i qartë dhe Zoti pret që njerëzimi të veprojë me përgjegjësi mbi atë çfarë ai ka blatur. Arsyetimi që shumë njerëz përdorin se gjoja Bibla mund të kuptohet në shumë mënyra dhe se kushdo ka interpretimin e vet mbi të, nuk është i vërtetë. Përfundimi është shumë i qartë: “Ai që beson te Biri ka jetën e përjetshme, por ai që nuk i bindet Birit, nuk do të shohë jetë, por zemërimi i Perëndisë qëndron mbi të. ” (Gjoni 3:36)

A duhet pranuar fjalë për fjalë gjithçka që gjendet në Bibël?

Kur ne themi se e marrim Biblën fjalë për fjalë, nuk nënkuptojmë që gjuha e figurshme nuk ekziston në të. Sidoqoftë për ta interpretuar në mënyrë të figurshme, na duhet një arsye e fortë që të justifikojmë një veprim të tillë brenda një paragrafi.

Disa mënyra të shkruarit, për nga vetë natyra e tyre, priren ta përjashtojnë mundësinë e përdorimit të gjuhës së figurshme. Këto shkrime përfshijnë jurisprudencën, shkrimet historike dhe ato filozofike edhe pse në to, ndonjëherë, mund të ndeshim një gjuhë të tillë, po të jetë e nevojshme. Për shembull, “Martin Luteri ishte si një dem në një dyqan

farfurinash".¹ Një lloj tjetër letërsie, për shembull poezia, është e figurshme nga vetë natyra e saj.

Një rregull i dobishëm për interpretim është ky: "Nëse një interpretim i drejtpërdrejt të jep një interpretim të saktë, mos kërkon interpretim tjetër, që mund të të çojë në marrëzi. "Fjalët e një teksti të caktuar do të kërkonin mundësisht një interpretim fjalë për fjalë. Nëse nuk është e mundur, do të kalohet në gjuhën e figurshme.

Zakonisht brenda një teksti gjenden disa fjalë kyçe. Nganjëherë ndeshet edhe ndonjë përkufizim. Për shembull, kur Libri i Zbulesës flet për dragoin, (Zbulesa 12:9), dragoi i shpjegohet lexuesit. Njohja e kulturës, gjithashtu, ndihmon sepse sa më shumë që njeriu di për gjuhën dhe mënyrën e të mësuarit, aq më mirë do të dijë të përcaktojë mënyrën e përkthimit të një paragrafi të dhënë.

Janë të shumtë ata që janë përpjekur të tregojnë se sa i çmendur është besimi në interpretimin e fjalëpërfjalshëm duke pohuar, pra, se në Bibël gjithçka duhet ta marrim fjalë për fjalë p. sh. "...tërë drurët e fushavë do t'ju duartrokasim." (Isaia 55:12) Bibla përmban mënyra të përcaktuara të gjuhës së figurshme, si metafora, krahasimini, hipërbola dhe antropomorfizmi.

Një metaforë është një krahasim me thënien. Te Gjoni 15:1 Jezusi thotë: "Unë jam hardhia e vërtetë" Kjo nuk do të thotë aspak se ai është vërtet hardhi, por fare mirë Ai mund të krahasohet me të. Krahasimi përmban lidhëzën "si" ose "sikurse". Eksodi 24:17 thotë: "Dhe pamja e lavdisë së Zotit dukej në sytë e bijve të Izraelit si një zjarr që digjet në majën e malit."

Hipërbola është zmadhuar për të theksuar veprën. Te Gjoni 21:25 lexojmë: "Janë edhe shumë gjëra të tjera që i bëri Jezusi, të cilat, po shkruheshin, unë mendoj se nuk do të mjaftonte mbarë bota që t'i nxinte librat që do të mund të shkruheshin."

Antropomorfoza, e cila gjendet veçanërisht në Dhiatën e Vjetër, është dhënia e karakteristikave dhe përvojave njerëzore Zotit. Kjo mund të shihet në pohime të tilla si "Dhe Zoti u pendua që kishte krijuar njeriun" (Zanafilla 6:6) dhe "në të vërtetë Zoti me sytë e Tij shikon përpara dhe prapa tërë tokën për të treguar forcën e Tij ndaj atyre që kanë një zemër të ndershme ndaj Tij. (2 Kronikavë 16:9)

Megjithatë, shumë deklaramë të menduara më parë si të figurshme, me një njohuri më të madhe, provojnë se janë të drejtpërdrejta. Merrni për shembull gjarprin që ha pluhur. Kërkimet kanë provuar se gjarprinjtë në fakt hanë pluhur. Kjo i ndihmon ata të orientohen, — ata "shohin" nëpërmjet pluhurit që gëlltitin.

(1) "Dem në një dyqan farfurinash" — në anglisht "bull in a china shop" ka kuptimin e një njeriu të ngathët dhe kaba. (Shën. i përkth.)

Si përfundim, gjuha figurative ka vendin e vet te Shkrimi, por vetëm atëherë kur faktorë të njohur, tregojnë se paragrafi i caktuar nuk duhet interpretuar fjalë për fjalë.

Si e dini se Zoti ekziston?

Vërtet ka një Zot? Si mundet dikush të jetë i sigurt se një qenie e tillë ekziston?

Nuk do të na ndihmonte fare në gjendjen tonë si njerëz, besimi se ekzistenca e Zotit dhe pyetjet që do të rridhnin prej këtij pohimi, mund të gjejnë përgjigje logjike. Arsyeja që ne dimë se Zoti ekziston është se Ai na e ka thënë këtë dhe na e ka shfaqur veten e vet.

Zoti mund të ishte i heshtur, por fatmirësisht Ai nuk është i tillë. Zoti, jo vetëm që ekziston, por Ai vetë na e ka kumtuar këtë të vërtetë. Ai na ka thënë se kush është, se si është dhe cili është plani i Tij për planetin tonë.

Ai ua ka shfaqur njerëzve të gjitha këto nëpërmjet Biblës. Bibla ka provuar se është më shumë se një libër i thjeshtë. Bibla është Fjala e vërtetë e Zotit. Prova është me të vërtetë bindëse, nëse dikush do t'i marrë ndershmërisht pretendimet e saj. Për shkak të mburrjeve që Bibla bën për veten, shumë janë orvatur ta asgjësojnë atë, sikurse na e pohon edhe Martin Luteri¹ me thënien e tij si vijon:

Sundimtarë të fuqishëm janë tërbuar kundër këtij libri dhe kërkuar ta asgjësonin e ta çrrënjoshnin, — Aleksandri i Madh, princat e Egjiptit e të Babilonit, monarkët e Persisë, Greqisë e Romës, perandorët Jul dhe August, — por të gjithë dështuan.

Ata u zhduken të tërë vetëm libri mbeti dhe do të mbesë përgjithmonë, i përsosur e i plotë ashtu sikurse na u shfaq që fillim. E kush e ka ndihmuar atë, kush e ka mbrojtur kundër forcave të tilla të fuqishme? Sigurisht askush, veç Zotit vetë, që është zotëruesi i gjithçkaje." (Cituar prej Fritz Ridenour të "Who says?")

Madje edhe skeptiku francez Ruso² pa diçka të veçantë të Shkrimit.

"Dua ta pranoj se madhështia e Shkrimeve më habit; shenjtëria e ungjilltarëve i flet zemrës sime dhe ka karaktere kaq vërtetësisht mahnitës, kaq përsosmërisht të papërsëritshëm sa, po të kishte qenë një shpikje e njerëzve, shpikësit do të konsideroheshin më të mëdhenj sesa heronjtë më të mëdhenj." (Frank Mead, *Encyclopedia of Religious Quotations* f. 32) Rrjedhimisht Bibla na jep arsye të mjaftueshme të besojmë se ajo është

1. Martin Luther (1483–1546), teolog i mirënjohur gjerman, nismëtar dhe udheheqës i Reformës protestante (shën. i përkth.)

2. Jean-Jacques Rousseau (1712–1778) — filozof dhe shkrimtar iluminist francez, idetë e të cilit luajtën rol të rëndësishëm në zhvillimin e Revolucionit francez. (Shën. i përkth.)

Fjala e Zotit të gjallë që ekziston dhe që ia ka shfaqur botës vetveten.

Tjetër arsye se përse ne besojmë në ekzistencën e Zotit është se ai na është shfaqur me trup njerëzor. Jezu Krishti ishte Zot i Gjithëfuqishëm që u bë njeri. Bibla thotë: “Fjala u bë mish dhe jetoi ndër ne” (Gjoni 1:14), dhe bën të qartë se Jezusi erdhi në këtë botë të na tregojë se kush është Zoti dhe çfarë është jeta në lidhje me të. (Gjoni 1:18)

Nëse dikush kërkon të dijë se kush është Zoti dhe me çfarë shëmbëllen ai, atij i duhet vetëm të vështrorë Jezu Krishtin. Sikurse e tha dhe Lord Bajroni², “Nëse ndonjëherë njeriu ishte Zot ose Zoti njeri, Jezu Krishti i kishte të dyja. (Frank Mead, *Encyclopedia of Religious Quotations* fq. 81–)

Në vend që njeriu të ngjitej lart për të gjetur Zotin Zoti vetë zbriti poshtë te njeriu. Sikurse e shpjegon Casserley: “Ungjilli siguron dijen e së vërtetës themelore, të cilën njerëzit e kanë kërkuar më kot nëpërmjet filozofisë, sepse është thelbësore në vetë natyrën e Zotit, se ai nuk mund të zbulohet me anë të kërkimit dhe sondazhit të mendjeve njerëzore, se Zoti mund të njihet vetëm nëse Ai merr së pari nismën dhe na shfaq Vetveten. (*The Christian in Philosophy*. fq. 21)

Jezusi, me kthimin nga të vdekurit, themeloi veten nëse kishte aftësitë për të qenë Zot dhe pikërisht me këtë ai provoi të vërtetën e tij para botës skeptike. Sikurse thotë Macheni “Arma e madhe me të cilën dishepujt e Jezusit u nisën për të pushtuar botën nuk ishte një kuptim i thjeshtë i principeve të përrjetshme; ajo ishte një mesazh historik, raport mbi atë që kishte ndodhur, ishte mesazhi “Ai është ringjallur. ” (J. G. Machen, *Christianity and Liberalism*, fq. 28, 29)

Kështu pra, kemi Biblën dhe Jezu Krishtin si dy arsye të forta për të argumentuar ekzistencën e Zotit. Asnjë fe tjetër apo filozofi nuk na paraqet asnjë argument të ngjashëm për të provuar se Zoti ekziston.

Nga na erdhi Zoti? Çfarë bënte ai para se të krijonte gjithësinë?

Këto pyetje pranojnë si të vërtetë se çdo gjë, duke përfshirë edhe Zotin, u është nënshtruar kufizimeve të kohës dhe hapësirës sikurse është vetë njeriu se nuk ka asgjë jashtë kohës dhe hapësirës; një postulat ky që bashkësia shkencore e vuri në dyshim dhe e flaku unanimisht që me daljen e teorisë së Albert Ajnshtajnit për relativitetin.

Ajnshtajni tregoi se koha në fakt mund të ndryshohet, të ngadalësohet e të shpejtohet, kur objektet nisin të lëvizin me shpejtësi shumë të mëdha. Ky arsyetim çoi në sygjerimin se koncepti i zakonshëm se të gjitha sendet fillojnë e veprojnë brenda kontekstit të një kohe dhe hapësire të fiksuar dhe se asgjë nuk ekziston jashtë kohës e hapësirës, nuk është domosdoshmërisht i saktë.

Edhe pse jo krejtësisht e qartë faktet e bëjnë më të lehtë për të pranuar

mësimin biblik se Zoti ekziston jashtë kohës dhe hapësirës, siç i njohim ne. (Psalmi 90:4; Kolosianëve 1:17; 2 Pjetër 3:8). Të pranosh se Zoti ekziston jashtë kornizës së kohës dhe hapësirës, sikurse e njohim ne, bën që pyetjet, nga na erdhi Ai dhe çfarë bënte ai para se të krijonte atë që ne quajmë gjithësi janë krejt të pakuptimta.

Këto pyetje do të ishin krejt të përligjura nëse Zoti do të ishte subjekt në kohë e hapësirë, por kjo në fakt nuk është e vërtetë. Bibla na mëson se Zoti nuk është i lidhur me kohën dhe hapësirën dhe se ai nuk ka vendosur të na tregojë, nisur nga pikëpamja jonë, gjithë atë që ndodhi para se ai të krijonte gjithësinë.

Çfarë është Trinia? A adhurojnë të krishterët tre Zota?

Një nga idetë më të keqkuptuara në Bibël ka të bëjë me mësimin e Trinisë. Edhe pse të krishterët thonë se besojnë në një Zot, ata akuzoheshin vazhdimisht për politeizëm (adhurimin e të paktën tre zotave).

Shkrimet nuk na mësojnë se gjenden tre zota, as na mësojnë që Zoti vë tri maska të ndryshme ndërkohë që zhvillohet drama e historisë. Ajo që Bibla na mëson, është shpallur në doktrinën e Trinisë: është një Zot që na e ka shfaqur veten me tre persona, me Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë dhe këta tre persona janë Zoti i vetëm.

Edhe pse kjo është e vështirë të konceptohet, në thelb mbetet ajo që na thotë Bibla; kjo është më e sakta që mendja e kufizuar mund të arrijë në shpjegimin e misterit të pakufishëm të Zotit të pakufishëm, kur merren parasysh pohimet e Biblës lidhur me qënien e Zotit.

Bibla na mëson se gjendet një Zot dhe vetëm një Zot. “Dëgjo, Izrael, Perëndia ynë është një i vetëm!” (Ligji i përtërirë 6:4) “Një është Perëndia. (Timoteut 2:5), “Kështu thotë Zoti, mbreti i Izraelit dhe çliruesi i tij, Zoti i ushtrive: “Unë jam i pari dhe jam i fundit, dhe përveç meje nuk ka perëndi tjetër. ” (Isaia, 44:6)

Megjithatë, edhe pse Zoti është një në qenien dhe natyrën e Tij, Ai është, gjithashtu, tre persona. “Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë.” (Zanafilla 1:27).

Personaliteti i shumëllojtë i Zotit përmendet këtu tërthorazi, sepse nuk mund të fliste me engjëjt, sepse engjëjt nuk mund të ndihmonin Zotin për të krijuar. Bibla na mëson se Jezu Krishti, krijoi gjithçka dhe jo engjëjt,. (Gjoni 1:3, Kolosianëve 1:15, Hebrenjve 1:2)

Gjithashtu, Shkrimet e shenjta janë krejt të veçanta kur e përmendin Zotin në tre persona. Ka një person, të cilin Bibla e quan Atë dhe Ai është përcaktuar si Zoti Atë. (Galatasve 1:1).

Bibla flet për një person të quajtur Jezu ose Biri ose Fjala, të quajtur gjithashtu Zot. “dhe Fjala ishte Perëndi” (Gjoni 1:1). Jezusi thoshte se Perëndia ishte Ai i vet, duke e barazuar veten me Perëndinë. ” (Gjoni

5:18)

Po është edhe një person i tretë i përmendur në Shkrimet që quhet Shpirti i Shenjtë e ky person, i veçuar nga Ati e Biri, — gjithashtu, quhet Zot. “Anania, pse Satani ta mbushi zemrën që të gënjesh Frymën e Shenjtë?... Ti nuk ke gënjyer njerëzit, por Perëndinë.” (Veprat 5:3)

Faktet e mësimit biblik janë këto: ka një Zot. Ky Zot ka personalitet të shumëllojtë. Ky Zot quhet Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë, që të gjithë personalitete të shquara, të gjithë të quajtur Zot. Që këtej ne shkojmë drejt përfundimit se Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë janë një Zot, doktrina e Trinisë.

Doktor John Warwick Montgomery jep këtë ngjashmëri për të na ndihmuar që ta kuptojmë më mirë këtë doktrinë:

Doktrina e Trinisë nuk është “iracionale”; ajo që është iracionale është ta shtypësh forcërisht dëshminë biblike të Trinisë në favor të unitetit ose dëshminë për unitet në favor të Trinisë. Të dhënat tona duhet të marrin përparësi mbi modelet tona ose e thënë më mirë, modelet tona duhet, në mënyrë të ndjeshme të pasqyrojnë të gjitha të dhënat.

Një ngjasim i afërt me procedurën teologjike është puna e fizikantit teorik: realitetet subatomikë janë zbuluar gjatë ekzaminimit, për të zotëruar vetitë e valëve. (W), cilësitë e pjesëzës (P) dhe veçoritë e Kuantit (h).

Sidoqë këto veçori në shumë drejtime janë të papajtueshme (pjesëzat nuk shpërbëhen ndërkohë që valët shpërbëhen etj.), fizikantët “shpjegojnë” ose “modelojnë” një elektron PWh. Ata duhet ta bëjnë këtë me qëllim që t’u japin peshën e duhur të gjitha të dhënave përkatëse.

Njësoj, teologu që flet për Zotin si “tre në një”. As shkencëtari, as teologu nuk shpresojnë që ju të keni një “pikturë” nëpërmjet modelit të tij; qëllimi i modelit është t’ju ndihmojë të merrni parasysh të gjitha faktet, në vend të realitetit të shprishur me anën e mbivendosjes së një “qëndrueshmërie” të qartë mbi të.

Zgjedhja është e qartë; ose Trinia ose një “Zot” që është një imitim i zbehtë i Perëndisë së krishterimit biblik dhe të besuar (*How do we know there is a God?* f. 14, 15).

Përse është Jezusi e vetmja rrugë për të arritur te Zoti?

Njerëzit pyesin vazhdimisht “Ç’gjë është e veçantë me Jezusin?” Përse është ai rruga e vetme nëpërmjet së cilës dikush mund të njohë Zotin? Bashkë me problemin e atyre që kurrë nuk kanë dëgjuar për Jezusin, nuk ka asnjë pyetje tjetër që të përsëritet më shpesh se kjo. Ne akuzohemi si mendjengushtë, sepse shpallim se nuk ka rrugë tjetër për të arritur te Zoti.

Pika e parë për t’u qartësuar është se ne nuk e shpikëm pretendimin e

Jezusit si të vetmen rrugë. Ky nuk është pretendimi ynë, por i Atij. Ne vetëm se jemi duke e rrëfyer pretendimin e Tij dhe pretendimin e shkruesve të Dhiatës së Re. Jezusi tha; “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje”. (Gjoni 14:6) dhe “Po të mos besoni se unë jam Ai, ju do të vdisni në mëkatet tuaja” (Gjoni 8:24).

Apostulli Pjetër përseriti fjalët: “Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohem. ” (Veprat 4:12).

Apostulli Pal e përforcoi: “Në fakt një është Perëndia dhe një i vetëm është ndërmjetësi midis Perëndisë dhe njerëzve: Krishti Jezus njeri... ” (1 Timoteut 2:5).

Rrjedhimisht kjo është dëshmia e harmonizuar e Dhiatës së Re që thotë se askush nuk mund ta njohë Zotin Atë veçse nëpërmjet personit të Jezu Krishtit.

Për të kuptuar pse është kështu, na duhet të kthehemi te fillimi. Një Zot personal dhe i pafund krijoi qiellin dhe tokën (Zanafilla 1:1) dhe njeriun sipas shëmbëlltyrës së tij (Zanafilla 1:31).

Burri dhe gruaja u vendosën në një mjedis të përkryer, me të gjitha nevojat për të jetuar. Atyre u ishte vënë vetëm një kufizim: të mos hanin frutin e pemës së njohjes të së mirës e të së keqes që të mos vdisnin. (Zanafilla 2:17).

Fatkeqësisht ata e hëngrën frutin (Zanafilla 3) dhe përfundimi ishte rënia në katër sfera të ndryshme. Marrëdhënia ndërmjet Zotit dhe njeriut u prish, siç mund të kuptohet, nga përpjekja e Adamit dhe e Evës për t’u fshehur nga Zoti. (Zanafilla 3:8)

Lidhja ndërmjet njeriut dhe bashkënjjeriut të tij u rëndua; kështu që të dy, Adami dhe Eva, nisën të grindeshin dhe t’ia hidhnin fajin njëri-tjetrit apo dhe dikujt tjetër (Zanafilla 3:12–13).

Po dhe lidhja ndërmjet njeriut dhe natyres u prish me rritjen e gjëmbave dhe ferrave dhe sepse bota e kafshëve nuk mbeti më mirëdashëse. (Zanafilla 3:17, 18). Njeriu po ashtu u nda nga vetja me ndjenjën e boshllëkut, të cilën ai nuk e kishte përjetuar para rënies.

Megjithatë, Zoti premtoi se do t’i rregullonte të gjitha këto gjëra dhe dha fjalën e Tij se do të dërgonte një Shpëtimtar, Mesinë, i cili do ta çlironte mbarë krijimin nga skllavëria nën mëkatin. (Zanafilla 3:15). Dhiata e Vjetër përserit shpesh se një ditë ky person do të vinte në këtë botë dhe do të çlironte njerëzimin.

Fjala e Zotit natyrisht u bë realitet. Zoti u bë njeri në personin e Jezu Krishtit (Gjoni 1:14, 29). Jezusi përfundimisht vdiq në vendin tonë, me qëllim që ne të mund të gëzonim përsëri lidhjen e duhur me Zotin. Bibla thotë: “Perëndia e ka pajtuar botën me veten në Krishtin” dhe “Ai bëri të

jetë mëkat për ne ai që nuk njihete mëkat, që ne të bëhemi drejtësia e Perëndisë në të" (2 Korintasve 5:19, 21).

Jezusi shtroi udhen! Zoti ka bërë gjithçka dhe përgjegjësia jonë është ta pranojmë këtë fakt. Ne nuk mund të shtojmë asgjë në veprën e Jezusit; për ne është përmbushur gjithçka.

Nëse njerëzimi do të arrinte te Perëndia nëpërmjet një rruge tjetër, atëherë Jezusi nuk kishte përse të vdiste. Vdekja e tij provon faktin se nuk ekziston as edhe një rrugë tjetër. Rrjedhimisht, as një fe tjetër apo udhëheqës fetar nuk mund ta sjellë secilin te dituria e Zotit të vërtetë.

Mirëpo, vdekja e Jezusit nuk është fundi i historisë. Le ta themi përse ne preferojmë Jezusin mbi udhëheqësit e tjerë fetarë. Të mendojmë se një grup nga ne po marshon në një pyll shumë të dendur. E ndërsa futemi më thellë pyllit, humbasim. Duke kuptuar se marrja e një shtegu të gabuar do të thoshte rendje drejt humbjes së jetëve tona, fillojmë të friksohemi.

Por megjithatë, para nesh, në largësi, atje ku gjurma ndahet, ne vëmë re të na shfaqen dy forma njerëzore, të degëzimi i rrugës. Duke rendur drejt tyre, vëmë re se njëri mban veshur uniformën e rojtarit të pyllit dhe rri atje plot gjallëri, ndërkohë që tjetri rri me fytyrë poshtë, i vdekur. Pra, cilin nga këta të dy do ta pyesim se ç'rrugë duhet të zgjedhim? Kuptohet se atë që është i gjallë.

Kur është fjala për çështje jetësore, ne do të pyesim atë që është i gjallë për të dalë nga gjendja e humbur. Ky nuk është as Muhamedi, as Konfuci, por Jezu Krishti. Jezusi është i pashoq. Ai u kthye nga vdekja. Kjo provon se ai vetë pretendonte se ishte (Romakëve 1:4), Biri i vetëm i Zotit dhe e vetmja rrugë nëpër të cilën dikush mund të vendosë lidhje personale me Zotin e vërtetë e të gjallë.

A nuk është Zoti i Dhiatës së Vjetër një Zot i urrejtjes kurse Zoti i Dhiatës së Re një Zot i dashurisë?

Një tjetër akuzë e shpeshtë kundër Biblës është se ajo ka dy konceptime të ndryshme për Zotin. Dhiata e Vjetër gjoja paraqet vetëm një Zot zemërimi, kurse Dhiata e Re përshkruan vetëm një Zot dashurie.

Dhiata e Vjetër përmban tregime të urdhrit të Zotit për shkatërrimin e Sodomit, të asgjësimit të kënanasve si dhe shumë histori të tjera të gjyqit dhe zemërimit të Zotit. Akuzuesit pretendojnë se kjo pikturon një hyjni primitive, luftënxitëse, në kundërshtim me mësimet e përparuara të Jezusit për ta dashur njëri-tjetrin dhe për t'i kthyer faqen tjetër, sikurse thuhet në predikimin në mal.

Këto ide për Zotin duhen të ndeshen në konflikt të drejtpërdrejtë, por mendimi i pjekur na thotë të kundërtën. Jezusi vetë shpalli se Dhiata e Vjetër mund të përmbledhej në urdhërimet për të dashur Zotin dhe fqinjin (Mateu 22:37). Ai, gjithashtu, vërente se Zoti në Dhiatën e Vjetër

vazhdimisht dëshironte dashuri dhe mëshirë në vend të flijimit (Mateu 9:13, 12:7).

Ky qëndrim mund të vihet re në deklarime të tilla si: “A ndiej vallë gëzim nga vdekja e të pabesit... apo përkundrazi që ai të kthehet nga rrugët e tij dhe të jetojë?” (Ezekiel 18:23).

Zoti nuk do t’i kishte shkatërruar ato kombe, po të mos kishte qenë Zot i drejtësisë dhe e keqja e tyre do të kishte kaluar pa u gjykuar. Ai synonte dhe dëshironte t’i ndëshkonte ato si pjesë e planit të tij, në përputhje me natyrën dhe zilinë e tij të shenjtë për popullin e tij kalimtar. Atë që ai e dëshiron në përputhje me karakterin e tij të pastër, e realizon me drejtësi sikurse ndodhi me këtë rast, meqënëse ata nuk ishin penduar, për të hyrë në harmoni me natyrën e Tij (Jeremia 18).

Le të marrim rastin e amorasve. Zoti u dha atyre me qindra vjet kohë për t’u penduar por, megjithatë, ata nuk u penduan. (Zanafilla 15:16) Noahu i predikoi brezit të tij 120 vjet para përmbytjes së madhe (Zanafilla 6:3) Tabloja e vërtetë që na jep Dhiata e Vjetër është ajo e një Zoti shumë të duruar, i cili u jep këtyre njerëzve mundësi të pafund për t’u penduar e për të hyrë në harmoni me Të. Vetëm kur ata e refuzojnë një gjë të tillë në mënyrë të vazhdueshme, vetëm atëherë, pra, ai i gjykon dhe i ndëshkon për veprat e tyre të këqija.

Në kundërshtim me pikëpamjet e disa njerëzve, deklaratat më të forta të gjykimit e të zemërimit në Bibël u bënë nga vetë Zoti Jezus. Te Mateu 23, për shembull, Ai figurativisht kamzhikon udhëheqësit fetarë të kohës së Tij, duke i quajtur hipokritë dhe të gënjeshtërt, e duke i paralajmëruar se fati i tyre ishte dëbimi larg pranisë së Zotit.

Te Mateu 10:34 Jezusi thotë se synimi i mësimit të tij nuk është bashkimi, por përçarja. “Mos mendoni se unë erdha të sjell paqen mbi tokë, por shpatën. “Ai vazhdon të thotë se Fjala e Tij do të bëjë që babai të jetë kundër të birit, nëna kundër së bijës dhe nusja kundër vjehrrës. (Mateu 10:35)

Ne gjejmë po aq gjykim sa edhe dashuri të shpërndarë me bollëk në gjithë Dhiatën e Re, dhe dashuri e mëshirë po aq sa edhe gjykim në tërë Dhiatën e Vjetër. Zoti është i qëndrueshëm dhe i pandryshueshëm, por rrethana të ndryshme kërkojnë theksim të ndryshëm.

Rrjedhimisht, kur të dy Dhiatat të lexohen, për nga mënyra se si u paracaktuan, ato do të na shfaqin të njëjtin Zot, të pasur në mëshirë, por që nuk mund ta lërë mëkatin të kalojë pa u ndëshkuar.

JEZU KRISHTI

Si e dini se Jezusi ka ekzistuar?

Akoma sot ka shumë njerëz që pretendojnë se Jezusi nuk ka ekzistuar kurrë ndonjëherë dhe se ai ishte vetëm një person mitik.

Bertrand Russell¹ thotë: “Mund të them se ndokush nuk është i interesuar për problemin historik. Historikisht është krejt e dyshimtë nëse Krishti ekzistoi, por edhe nëse jetoi, ne nuk dimë asgjë për të. Prandaj unë nuk kam përse të jem i interesuar për problemin historik, i cili është dhe një problem shumë i vështirë. Unë interesohem për Krishtin ashtu siç ai na shfaqet në Ungjill (*Why I am not a Christian*, f. 11, shënimi8)

Sigurisht se ata që bëjnë të tilla akuza nuk janë historianë, por, në mënyrë krejt të habitshme, injorues të fakteve.

Dhiata e Re përmban njëzet e shtatë dokumente të veçanta që u shkruan në shekullin e parë pas Krishtit. Këto shkrime përmbajnë historinë e jetës së Jezusit dhe fillimin e Kishës së krishterë që rreth vitit 4 para Krishtit deri në dekadën e viteve nëntëdhjetë pas Krishtit.

Faktet u regjistruan nga dëshmitarët që dhanë dëshmi të drejtpërdrejta për atë që ata kishin parë e dëgjuar. “Atë që ishte nga fillimi, atë që dëgjuam, atë që pamë me sytë tanë, atë që vështruam dhe që duart tona prekën lidhur në Fjalën e jetës.” (1 Gjoni 1:1)

Për më tepër, ekzistenca e Jezusit është regjistruar nga historiani çifut Flavi Josef, që lindi në vitin 37 pas Krishtit. “Rreth asaj kohe kishte një njeri të quajtur Jezusi: ishte një burrë i mençur, nëse na lejohej ta quanim njeri, sepse ai ishte autor i veprave të çuditshme, — mësues për të tillë burra që e pranojnë të vërtetën me kënaqësi. Ai tërhoqi rreth vetes kaq shumë çifutë dhe paganë.

Mos ishte Mesia ai? Edhe kur Pilati, me këshillën e njerëzve kryesorë midis nesh, e dënoi me kryqëzim, ata që e deshën në fillim nuk e braktisën, sepse ai iu shfaq atyre i gjallë ditën e tretë, ashtu sikurse profetët hyjnorë e patën parathënë bashkë me dhjetë mijë gjëra të tjera të çuditshme për të; edhe soji i të krishterëve, të quajtur kështu prej tij, nuk u shua deri në ditën e sotme. (Antikitetet, XVIII, III).

Sidoqë ky pasazh ishte kundërshtuar për shkak të referimit të Jezusit si Krisht dhe si i ngjallur nga vdekja, fakti i ekzistencës së tij nuk vihet në dyshim.

Kornel Taciti (112 pas Krishtit) një historian romak, duke shkruar për mbretërimin e Neronit, përmend Jezu Krishtin dhe ekzistencën e të

1. Bertrand Russell (1872–1970), filozof anglez ateist, matematikan dhe shkrimtar, (shën. i përkth.)

krishterëve në Romë (Analet, XV, 44). Taciti, te *"Historitë"* e tij i referohet krishterimit, kur aludon për djegien e tempullit të Jeruzalemit në vitin 70 pas Krishtit. Kjo ishte ruajtur nga Sulpici Sever (*Kronikat* 30:6)

Por ka edhe referime të tjera për Jezusin dhe pasuesit e tij, si ato të bëra nga historiant romak Seutoni (v. 120 pas Krishtit) te *"Jeta e Klaudit"* (V. 112 pas Krishtit) në Letrat e Tij, X, 96.

Dëshmia e krishterë dhe jo të krishterë është më se e mjaftueshme për ta lënë mënjanë idenë se Jezusi nuk ekzistoi kurrë. Në dritën e dëshmimeve, është e pakuptimtë të mbrosh një ide të tillë. Ne dime më shumë për jetën e Jezusit se sa thuajse për çdo figurë tjetër të botës së lashtë. Lindja, jeta dhe vdekja e tij na janë zbuluar me shumë më tepër hollësi se shumica e figurave të vjetra, ekzistenca e të cilave pranohet pa u diskutuar nga historianët.

Pas shqyrtimit të dëshmimeve për jetën e Krishtit nga burimet bashkohore, veç Dhiatës së Re, Rodrik Dankerli arriti në përfundimin se "Në asnjë prej këtyre dëshmimeve rreth ekzistencës së Krishtit nuk gjendet as edhe më i vogli aludim apo mendim se ai nuk paskësh qenë një person i vërtetë dhe historik.

Natyrisht është arsyetuar — e unë mendoj me shumë vërtetësi — se teoritë e fillimeve mitike të krishterimit janë hipoteza spekulative moderne të motivuara nga paragjykimi i paarsyeshëm dhe mospëlqimi. Kurrë ndonjëherë dikujt nuk do t'i shkonte në mendje — thotë Merezhovskij — të pyeste nëse kishte jetuar Jezusi, nëse më parë, mendja e tij të mos ishte errësuar nga dëshira që ai të mos kishte jetuar". (Roderik Dunkerli; *"Beyond the Gospels"* f. 29–30).

Pretendonte Jezusi të ishte Zot? Nëse ishte, përse duhet ta besoj?

Midis udhëheqësve fetarë që kanë arritur të kenë shumë pasues gjatë historisë, Jezu Krishti është i pashoq në pretendimin se ai është Zot me trup njeriu. Një keqkuptim i rëndomtë është se disa, ose shumë nga udhëheqësit e besimeve, kanë të njejtat pretendim, por kjo nuk është e vërtetë.

Buda nuk pretendoi të ishte Zot; Moisiu nuk tha kurrë se ishte Jahve; Muhamedi nuk e njëjtësoi veten me Allahun dhe asgjëkundi ju nuk do të gjeni Zoroastrën të pretendojë të jetë Ahura Mazda. E megjithatë, marangozi nga Nazareti tha se kush ka parë Atë (Jezusin) ka parë Atin. (Gjoni 14:9)

Pretendimet e Krishtit janë të shumta dhe të ndryshme. Ai tha se ekzistonte para Abrahamit (Gjoni 8:58) dhe tha se ishte i barabartë me Atin (Gjoni 5:17, 18) Jezusi pretendon aftësitë për të falur mëkatet (Marku 43:25), dhe kjo, sipas mësimeve të Biblës, është diçka që vetëm Zoti mund

ta bënte (Isaia 43:25). Dhiata e Re e barazoi Jezusin me Krijuesin e gjithësisë (Gjoni 1:3) dhe se të gjitha gjërat qëndrojnë në Të (Kolosianëve 1:17). Apostull Pali thotë se Perëndia u shfaq në mish (1 Timoteut 3:16) dhe Gjon Ungjilltari thotë “Dhe fjala ishte Perëndi” (Gjoni 1:1). Dëshmia e bashkuar e Jezusit dhe e shkrimtarëve të Dhiatës së Re është se ai ishte më shumë se një njeri i thjeshtë: ai ishte Perëndia.

Jo vetëm miqtë por edhe armiqtë e tij vunë re se ai pretendonte të ishte Zot. Ekzistojnë disa dyshime midis skeptikëve, të cilët nuk pranojnë të shqyrtojnë dëshmitë, por nuk gjendej as edhe një dyshim tek autoritetet cifute.

Kur Jezusi i pyeti se përse donin ta vrisnin me gurë, ata iu përgjigjën: “Ne nuk të vrasim me gurë për asnjë vepër të mirë, por për blasfemi, sepse ti, duke qenë njeri, e bërë veten Perëndi”. (Gjoni 10:33) Ky fakt e veçon Jezusin nga figurat e tjera fetare. Në shumicën e besimeve të kësaj bote, mësimet — jo mësuesit — janë tërësisht të rëndësishme.

Konfucianizmi është një mbledhje mësimesh; Konfuci nuk është i rëndësishëm. Islami është shfaqja e Allahut, me Muhamedin profet, ndërsa budizmi thekson parimet e Budës, por jo vetë Budën. Kjo është e vërtetë veçanërisht për hinduizmin, në të cilin nuk ka asnjë themelues historik.

Megjithatë, në qendër të krishterimit gjendet Jezu Krishti. Jezusi nuk pretendonte se po i mësonte njerëzimit të vërtetën. Ai pretendonte të ishte vetë e vërteta. (Gjoni 14:6)

Ajo që Jezusi u mësoi të tjerëve nuk është aspekti i rëndësishëm i krishterimit, por e rëndësishme është se kush ishte Jezusi. A ishte ai Biri i Zotit? Është ai rruga e vetme nëpër të cilën një njeri mund të arrijë te Zoti? Ky është pretendimi që bëri ai për veten e tij. Supozoni se pikërisht sonte presidenti i ShBA shfaqet në tërë rrjetet e medias dhe shpall: “Unë jam Zoti i plotfuqishëm. Unë kam pushtetin për të falur mëkatën. Unë kam autoritetin ta ringjall veten time pas vdekjes.” Atij do t’i mbyllej menjëherë transmetimi, do të largohej dhe do të zëvendësohej menjëherë nga zëvendëspresidenti. Kushdo që do të guxonte të kishte të tilla pretendime do të ishte ose i çmendur, ose gënjeshtar, nëse nuk ishte Zot.

Pikërisht kjo është çështja me Jezusin. Ai i pretendonte qartazi këto dhe shumë gjëra të tjera. Nëse ai është Zot, sikurse pretendonte, ne duhet të besojmë në të, nëse nuk është, atëherë ne nuk kemi të bëjmë fare me të. Jezusi ose është Zot i të gjithave, ose nuk është Zot aspak.

Po, Jezusi pretendonte të ishte Zot. Po përse duhet që dikush ta besojë një gjë të tillë? Në fund të fundit, thjesht pretendimi për të qenë diçka, nuk e bën atë të vërtetë. Ku është prova që thotë se Jezusi është Zot?

Bibla jep arsye të ndryshme, duke përfshirë këtu mrekullitë dhe profecitë e plotësuara që kanë për qëllim të na bindin se Jezusi është ai

që thoshte se ishte. (Gjoni 20:30, 31) Arsyeya kryesore, apo shenja e cila, siç thoshte Jezusi vetë, do të vërtetonte se ai ishte biri i Zotit, ishte ringjallja e tij nga vdekja.

Kur iu kërkua një shenjë nga udhëheqësit fetarë, Jezusi u përgjigj: “Në fakt ashtu si Jona qëndroi tri ditë e tri net në barkun e peshkut të madh, kështu Biri i njeriut do të qëndrojë tri ditë e tri net në zemrën e tokës” (Mateu 12:40).

Në një vend tjetër, kur e pyetën për një shenjë, ai tha: “Shkatërroni këtë tempull dhe unë për tri ditë do ta ngre përsëri... Por ai fliste për tempullin e trupit të vet”. (Gjoni 2:19, 21) Aftësia për ta ringjallur jetën e vet të vdekur, është shenja që e veçon Atë jo vetëm nga gjithë udhëheqësit të tjerë fetarë, por gjithashtu edhe nga çdokush tjetër që ka jetuar në këtë botë.

Cilido që dëshiron të përgënjeshtrojë çështjen e krishterimit, duhet të japë shpjegime për historinë e ringjalljes. Rrjedhimisht, sipas Biblës, Jezusi provon se është Biri i Zotit kthyer nga vdekja (Romakëve 1:4). Provat që thonë se Jezusi u ringjall nga varri, janë të panumërta. Ky është fakti që provon se Jezusin është Zot.

A lindi Jezusi nga një virgjëreshë?

Mrekullia e lindjes së Jezusit nga një virgjëreshë ka hutuar shumë njerëz aq sa ka bërë të mos pranojnë të vërtetën e krishterimit. Po Bibla pohon se Zoti vendosi që Biri i Tij duhet të kishte një ardhje të mbinatyrshme në këtë botë. Shtatëqind vjet para lindjes së Krishtit profeti Isaia tha: “Prandaj vetë Zoti do t’ju japë një shenjë: “Ja, virgjëresha do të mbetet me barrë dhe do të lindë një fëmijë të cilin do ta quajë Imanuel. ” (Isaia 7:14) Dhiata e Re shënon përmbushjen e profecisë së Isaisë. “Në muajin e gjashtë, engjëlli Gabriel u dërgua nga Perëndia në një qytet të Galilesë, që quhej Nazaret, te një e virgjër që ishte e fejuar me një njeri që quhej Jozef, nga shtëpia e Davidit; dhe emri i virgjëreshës ishte Mari... Dhe ja, ti do të mbetesh shtatzënë dhe do të lindësh një djalë e do t’ia vësh emrin Jezus.

“Dhe Maria i tha engjëllit:”Si do të ndodhe kjo, përderisa unë nuk njoh burrë?”

Dhe engjëlli duke iu përgjigjur i tha: “Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ty dhe pushteti i Shumë të Lartit do të të mbulojë me hijen e vet; prandaj i Shenjti që do të lindë prej teje, do të quhet Bir i Perëndisë..., sepse me Perëndinë asgjë s’është e pamundur. ” (Luka 1:26, 27, 30, 31, 34, 35, 37).

Lindja e virgjër është shënuar në Bibël si fakt i vërtetë historik. Shkrimtarët që e regjistruan historinë ishin Mateu, dëshmitar i ngjarjeve të jetës së Krishtit, dhe Luka, doktori, që tregon shumë gjëra në jetën e Krishtit nga pikëpamja e nënës së Tij, Marisë.

Paragrafët nga Mateu dhe Luka, janë të mirëfilltë, (pa asnjë provë se

janë të shtuar më pas në tekst. Doktrina e lindjes së virgjër ishte pranuar nga Kisha që në fillimet e saj. Ignaci, që jetoi në fillim të shek. të dytë, u shkroi efesianëve: “Sepse Perëndia ynë, Jezu Krishti, ishte ngjizur te mitra nga Maria sipas pararendimit, nga fara e Davidit dhe, gjithashtu, nga Shpirti i Shenjtë.”

Jepen arsye të ndryshme se përse lindja e virgjër ishte domosdoshmëri. Bibla na mëson se Fjala, e cila u bë mish, ishte bashkë me Zotin që nga fillimi. (Gjoni 1:1) Dëshmia e paraekzistencës së Krishtit është vërtetuar shumë herë në Dhiatën e Re (Gjoni 8:58, Filipianëve 2:5, 11, Kolosianëve 1:15, 16)

Kur Jezusi hyri në këtë botë, ai nuk ishte njeri i krijuar sikurse jemi të gjithë ne, por Biri i përjetshëm i Zotit. Lindja në këtë botë nga Maria e virgjër, kërkonte ndërhyrje hyjnore; pikërisht këtë ndërhyrje hyjnore e regjistronjë ungjijtë.

Tjetër arsye që Jezusi duhet të lindte nga një virgjëreshë ishte natyra e tij e pamëkat. Një mësim themelor i Dhiatës së Re është që nga dita kur lindi e deri ditën që vdiq, Jezusi ishte pa mëkat. Për t’u bërë një fli i përsosur, Ai duhet të ishte vetë i përsosur, pa asnjë mëkat. Derisa gjinia njerëzore është e infektuar nga mëkati, do të kishte një ardhje krejt mbinatyrore në këtë botë, dhe kjo ndodhi nëpërmjet lindjes së virgjër.

Për më tepër, nëse Zoti do të kishte lindur nga Jozefi, ai nuk do të ishte në gjendje të pretendonte të drejtat ligjore për fronin e Davidit. Sipas profecisë së Jeremisë 22:28–30, asnjë mbret në Izrael nuk do të mund të ishte pasardhës i mbretit Jehojahin dhe Mateu te 1:12 na thotë se Jozefi ishte nga brezi i Jehojahinit. Nëse Jezusi do të kishte lindur nga Jozefi, Ai nuk do të trashëgonte dot fronin e Davidit, përderisa mund të ishte farefis i brezit të nëmur.

Lindja e virgjër e Krishtit nuk është vetëm fakt historik, por gjithashtu, është fakt historik i domosdoshëm, sikurse mund ta kuptojë kushdo që lexon gjithë informacionin.

A nuk ka argumente të arsyeshme që e bëjnë sot të pabesueshme lindjen e virgjër?

Zoti, ndoshta, mund të kishte zgjedhur edhe një rrugë tjetër për të dërguar në këtë botë Birin e tij, por është fakt se rruga që ai zgjodhi ishte lindja e virgjër.

Ungjijtë shkruajnë se Maria dhe Jozefi nuk patën lidhje seksuale intime derisa lindi Krishti dhe se “ai nuk e njohu derisa lindi djalin e saj të parë, të cilit ia vuri emrin Jezus.” (Mateu 1:25) Dhiata e Re, gjithashtu, na rrëfen, se dihej që Jozefi nuk e kishte të tijin Jezusin dhe se shumica e njerëzve mendonin se Maria kishte lidhje të jashtëligjshme me dikë.

Edhe pse lindja e virgjër është dhënë si fakt historik dhe se shumë

gjëra e bënin të domosdoshme, shumë njerëz akoma shpallin me zë të lartë vërejtje të shumta kundër kësaj ngjarjeje.

Problemi kryesor që njerëzit kanë lidhur me lindjen virgjërore është se ajo është një mrekulli. Shkrimi nuk e trajton këtë si ndodhi të thjeshtë, por si veprim mbinatyor të Zotit. Mrekullia e lindjes virgjërore nuk ka përse të paraqesë problem, nëse dikush pranon mundësinë e mrekullive. E përse, mund të pyesim ne, lindja nga një virgjëreshë është një çudi më e madhe sesa, le të themi, të ushqesh 5000 vetë, ose shëtitja e Jezusit përmbi ujë? Nëse ekziston një Zot i plotfuqishëm, lindja e virgjërt nuk do të ishte jashtë mundësive të tij.

Një kundërshtim i rëndomtë për lindjen virgjërore është se ajo mbetet pamundësi biologjike, vërejtje e pranuar prej atyre që nuk kanë dije në këto gjëra. C. S. Lewis bëri këto vërejtje lidhur me këtë:

E kështu, ju mund të dëgjoni të thonë: të krishterët e hershëm besonin se Krishti ishte biri i virgjëreshës, por ne dimë se kjo është pamundësi shkencore. Njerëz të tillë me sa duket mendojnë se besimi ndaj mrekullive u kultivua në një periudhë, kur njerëzit ishin krejt të paditur ndaj punëve të natyrës dhe për pasojë nuk konceptonin mrekullinë si një fenomen që bie në kundërshtim me natyrën.

Mirëpo mendimi ynë i përqëndruar në këtë çështje do ta konsideronte këtë pretendim një budallallëk, me tregimin e lindjes së virgjër si një shembull jashtëzakonisht bindës. Kur Jozefi zbuloi se e fejuara e tij do të lindte fëmijë, ai, natyrisht, vendosi ta mohonte atë. Pse? Sepse ai e dinte po aq mirë sa dhe gjinekologët modernë se sipas rrugës naturale, gratë nuk bëjnë fëmijë, pa fjetur me një burrë.

Pa dyshim se gjinekologu modern di gjëra të ndryshme rreth lindjes dhe shkakut të cilat Jozefi nuk i njihte. Por këto gjëra nuk i interesojnë problemit kryesor — që një lindje virgjërore është në kundërshtim me rrjedhën e natyrshme të gjërave. Jozefi e dinte mirë këtë. (*Miracles*, f. 48)

Disa janë përpjekur ta shpjegojnë lindjen e virgjërt sipas modelit të mitologjisë greke ose babilonase. Ata arsyetojnë se shkrimtarët e Ungjillit e huazuan këtë histori nga mitologjia e kohës së tyre. Por kjo pikëpamje nuk përputhet me faktet, sepse nuk ka asnjë rast në mitologjinë pagane, për të cilin të pretendohet një lindje e virgjërt dhe, për më tepër, do të ishte krejt e pakonceptueshme për një mendje çifute të ndërtonte një histori të tillë nga mitologjia.

Shumë hyjni midis grekëve, babilonasve dhe egjiptianëve ishin shpallur si të lindur në mënyrë të pazakonte, veçse shumica e tyre kurrë nuk ekzistuan në të vërtetë. Tregimet janë të mbushura me elemente mitologjike të cilat janë të papranishme në tregimet ungjillore.

Ata janë tregime për një hyjni apo hyjneshë të lindura në këtë botë nga

marrëdhënia midis një qënieje qiellore dhe një gruaje tokësore ose nga marrëdhëniet imorale midis hyjnive dhe hyjneshave.

Dr. Thomas Thorburn komenton këtë ashtu siç duhet: “Të gjitha këto histori të ngjizjeve dhe të lindjeve të mbinatyrshme që ne i ndeshim në folklorin dhe në historinë e mitologjisë, kanë këtë pikë të përbashkët — ata shërbejnë për të treguar jo aq ngjashmerinë sesa kontrastin dhe pangjashmërinë e plotë që ekziston midis historisë së krishterë të të lindurit dhe përrallave që janë të shumta në ciklet e ndryshme pagane. (Thomas James Thornburn: *A Critical Examination of the Evidences for the Doctrine of the Virgin Birth*, f. 158) Kështu që kur marrim së afërmi në shqyrtim vërejtjet lidhur me lindjen e virgjërt, bindemi gjithnjë e më shumë se ajo ndodhi me të vërtetë po ashtu siç pohon raporti historik në ungjij.

Si e dimë se Jezusi u ngjall nga vdekja?

Vërtet Jezusi u ngjall nga vdekja? Ka vërtet rëndësi të pyesësh nëse Ai u ngrit përsëri apo jo? Ronald Gregor Smith na jep një përgjigje tipike, “Sa për mirëfillësinë e tregimeve është e domosdoshme ta shpjegojmë: Ne mund të themi lirisht se kockat e Jezusit shtrihen diku në Palestinë. Feja e krishterë nuk shkatërrohet nga një pohim i tillë.

Përkundrazi vetëm tani, kur kjo është thënë, ne jemi në gjëndje të pyesim për kuptimin e ringjalljes si pjesë përbërëse e lajmit që ka lidhje me Jezusin” (Secular Christianity, f.103)

Në kundërshtim me këtë pikëpamje, ka shumë rëndësi për krishterimin nëse është apo, nuk është e vërtetë që Krishti u kthye nga vdekja, sepse krishterimi qëndron ose rrëzohet mbi ringjalljen e Jezu Krishtit. (1 Korintasve 15:12,19).

Nëse Jezusi nuk u ringjall nga vdekja atëherë feja e krishterë thërrmohet.

Fatmirësisht, një nga ngjarjet më të provuara në botën e vjetër është ringjallja nga vdekja e Jezu Krishtit. Kur Jezusi u përball me udhëheqësit fetarë të kohës së tij, ata i kërkuan t’u tregonte një shenjë se Ai ishte Mesia i premtuar.

Ai iu përgjigj: “Ky brez i mbrapshtë dhe kurorëshkelës kërkon një shenjë, por asnjë shenjë, nuk do t’i jepet përveç shenjës së profetit Jona. Në fakt ashtu si Jona e cila qëndroi tri ditë e tri net në barkun e peshkut të madh, kështu Biri i njeriut do të qëndrojë tri ditë e tri net në zemër të tokës”. (Mateu 12:39,40)

Shenja e ringjalljes ishte thënë t’i jepej Jezusit veçan nga cilido tjetër i lindur duke e përcaktuar Birin e Perëndisë.(1 Romakëve 1:4)

Tregimet për shfaqjet e Jezusit na janë dhënë nëpërmjet dëshmitarëve okularë, me të cilët Ai u shfaq i gjallë në një periudhë dyzet ditore pas

kryqëzimit të Tij publik.

Sikurse na e thotë raporti biblik: "Ai u paraqit i ngjallur me shumë prova bindëse duke u parë prej tyre për dyzet ditë dhe duke folur për gjërat e Mbretërisë së Perëndisë" (Veprat 1:3).

Duke shkruar aty rreth vitit 59 pas Krishtit apostulli Pal përmend faktin se më shumë se 500 njerëz kishin dëshmuar njëkohësisht Krishtin e ringjallur dhe se shumica syresh ende jetonin kur ai shkroi. (1 Korintasve 15:6) Kjo deklaratë është një farë sfide për ata që nuk besonin, sepse Pali thotë se ende jetojnë njerëz që fare mirë do të mund të intervistoheshin për të treguar se Krishti ishte ringjallur në të vërtetë.

Dëshmia historike është më se e mjaftueshme për të shuar kureshtjen e kërkuesit të ndershëm. Kjo mund të kuptohet jo vetëm nga mbrojtja e sigurtë që mund të bëhet për çështjen e ringjalljes, por edhe për shkak të mungesës së provës për një shpjegim tjetër. Teoritë duke u përpjekur të na japin një shpjegim tjetër për ringjalljen, kërkojnë më shumë besim sesa vetë ringjallja. Frank Morrison, i cili ishte gazetar agnostik, u mundua të shkruante një libër për të hedhur poshtë ringjalljen e Krishtit.

Pas shumë hetimesh, bindja e tij ndryshoi dhe ai u bë besimtar në Jezun Krishtin. Ja se si e përshkruan Morrisoni atë çka ngjau me të: "Ky studim në disa aspekte është kaq i pazakontë dhe provokues sa që shkrimtari e mendon të arsyeshme të deklarojë shkurt si ngjau që libri mori formën e tanishme. Në një kuptim ai nuk do të mund të merrte asnjë formë tjetër, sepse në thelb ai është një rrëfim, historia intime e një njeriu i cili fillimisht u ul të shkruajë një lloj libri dhe e pa veten të detyruar nga forca absolute e rrethanave, të shkruajë një tjetër."

"Jo se ndryshuan faktet, sepse ato janë regjistruar në mënyrë të pashlyeshme në monumentet dhe në faqet e historisë njerëzore. Por ndryshoi interpretimi i fakteve". (*Who moved the stone?*)

Morrisoni zbuloi se Krishtin e futën publikisht në varr të premtën dhe se të dielën trupi mungonte. Nëse Ai nuk u ngjall nga vdekja, dikush duhet ta ketë marrë trupin. Ka tri grupe të interesuara që siç duket mund ta kishin marrë trupin: romakët, çifutët ose dishepujt.

Romakët nuk do të kishin asnjë arsye për të vjedhur trupin, derisa donin të ruanin paqen në Palestinë. Synimi i tyre ishte që t'i mbanin provincat sa më të qeta të ish e mundur dhe grabitja e trupit të Krishtit nuk do ta përmbushte këtë qëllim.

Çifutët nuk do ta merrnin trupin sepse gjëja e fundit që ata donin ishte shpallja e ringjalljes. Sipas Mateut 27, ishin pikërisht edhe ata që kërkuan ruajtjen e trupit, .

Dishepujt e Jezusit nuk kishin asnjë arsye për ta grabitur trupin dhe nëse do ta kishin grabitur, atëherë, më pas, do të vdisnin për diçka që e dinin se ishte e pavërtetë. Për më tepër, besimi që ata shpallnin, theksonte

tregimin e së vërtetës dhe jo gënjeshtërën. Veprimet e tyre do të ishin të papajftueshme me atë që ata e dinin si të vërtetë e që urdhëronte të tjerët ta ndiqnin. Shpjegimi tjetër i arsyeshëm është se Krishti është ngritur dhe dëshmitë okulare e bëjnë të qartë këtë. Dishepujt e Jezusit mund të mos ishin kaq të sofistikuar sa njeriu i shekullit të njëzet në sferën e diturisë shkencore, por me siguri ata e dinin ndryshimin midis atij që vdiq dhe atij që nuk vdiq.

Sikurse edhe Simon Pjetri tha “Sepse nuk jua bëmë të njohur fuqinë dhe ardhjen e Z që ashtu është tonë Jezu Krisht, duke shkuar pas përrallave të sajuara me mjeshtëri, por sepse jemi dëshmitarë okularë të madhësisë së Tij”. (2 Pjetrit 1:16)

Si mund t’i shpjegoni mosperputhjet ne historine e ringjalljes?

Dhiata e Re pohon se e vërteta e krishterimit qëndron ose rrëzohet në ringjalljen e Jezusit.

Apostulli Pal deklaroi: “Por në qoftë se Krishti nuk është ringjallur, predikimi ynë është i kotë dhe i kotë është edhe besimi juaj. Atëherë edhe ne do të ishim dëshmitarë të rremë të Perëndisë, sepse dëshmuam për Perëndinë, se ai ringjalli Krishtin...por në qoftë se Krishti nuk është ringjallur, i kotë është besimi juaj, ju jeni ende në mëkatet tuaja...Në qoftë se ne shpresojmë në Krishtin vetëm në këtë jetë, ne jemi më të mjerët e të gjithë njerëzve.(1 Korintasve 15:14,15,17,19).

Një kundërshtim i rëndomtë për faktin e ringjalljes është se të katër tregimet ungjillore përmbajnë mospërputhje të pandreqshme. Nëse të katër raportet do të vendoseshin në kolona paralele, do të dalloheshin nje numër ndryshimesh të dukshme. Megjithatë, këto ndryshime të dukshme, në fund të fundit vërtetojnë vërtetësinë e këtyre dëshmimeve, jo hedhjen poshtë të tyre.

Nëse të katër Ungjijtë do të jepnin saktësisht të njëjtën histori, në të njëjtën renditje, me të njëjtat hollësi, ne do të dyshonim menjëherë. Ne mund të pyesim edhe pse të katër autorët nuk i bashkërenduan emrat e tyre si bashkautorë të së njëjtës histori.Pa dyshim, që nuk është ashtu. Asnjë nga të katër Ungjijtë nuk na jep të gjitha hollësitë për sa ndodhi.

Mateu është shkrimtari i vetëm që regjistron shfaqjen e parë ndaj grave ndërkohë, vetëm te Luka gjejmë tregimin e dy dishepujve në rrugën për në Emaus. Shfaqja e Krishtit drejtuar Marisë nga Magdala mungon si te Mateu ashtu dhe te Luka. Vetëm Gjoni shkruan për shfaqjen e Zotit tonë në dhomën e sipërme, kur Thomai mungonte, dhe për shfaqjen në Detin e Galileës. Është shumë e qartë se të gjithë Ungjijtë na e japin portretin e Jezusit në mënyra të ndryshme. Kjo është pikërisht ajo që prisnim. Katër dëshmitarë (ose raportues lajmesh) të cilët dëshmojnë një seri ngjarjesh

nuk do ta përshkruajnë pikërisht në të njëjtën mënyrë, hollësi pas hollësi. Nëse do të vepronin kështu, do të kishim të bënim me një komplot të qartë.

Nëse ndryshimet do të lidheshin me çështjet kryesore të historisë, atëherë do të justifikoheshin dyshimi, por kur çështjet historike përputhen te çdo dëshmitar, ndryshimet e parëndësishme më tepër e shtojnë sesa e ulin vlerën.

Gjithashtu, vihet re se asnjë nga hollësitë nuk është domosdoshmërisht e ndryshme nga të tjerat, por përkundrazi në mënyrë të besueshme ato lidhen së bashku për të na përfutur tablonë të plotë. Larmitë e hollësishme që shkrimtarët e ndryshëm zgjedhën për t'i futur në tregime (lidhur me ringjalljen), lidhen me gjëra të parëndësishme, të cilat në asnjë mënyrë nuk vënë në rrezik subjektin kryesor të historisë.

Një nga mospërputhjet e supozuara që shqetëson njerëzit lidhet me kohën në të cilën gratë erdhën te varri, treguar ndryshe nga Gjoni dhe Marku. Marku na i tregon gratë duke ardhur te varri në të lindur të diellit, kurse Gjoni deklaroi se Maria nga Magdala erdhi te varri kur ishte errësirë.

Kjo vështirësi zgjidhet kur dihet se grave u është dashur të kapërcenin një largësi të madhe për të arritur varrin, meqë banonin në Jeruzalem apo Bethani. Ishte errësirë, kur ato lanë vendin ku rrinin, por kur arritën te varri, dielli kishte filluar të shkëlqente. Prandaj Marku flet për arritjen ndërkohë që Gjoni përmend nisjen e tyre.

Çështja, e cila ka krijuar diskutimin më të madh, lidhet me engjëjt që ishin te varri i Jezusit. Mateu dhe Marku tregojnë se një engjëll iu drejtua grave, kurse Luka dhe Gjoni flasin për dy. Kjo duhet të jetë një kontradikt, sepse Mateu dhe Marku gjoja njohin vetëm një engjëll kurse Luka dhe Gjoni flasin për dy. Sidoqoftë, Mateu dhe Marku nuk thonë se ishte vetëm një engjëll te varri, por që një engjëll foli me gratë.

Kjo nuk kundërshton Lukën dhe Gjonin, sepse Mateu dhe Marku cilësojnë se një engjëll foli, por nuk thonë se atje ndodhej vetëm një engjëll apo se vetëm një engjëll foli. Ka shumë mundësi që vetëm njëri nga engjëjt shërbente si zëdhënës për të dy, prandaj u theksua. Nuk ka nevojë që këtë ta marrim si mospërputhje.

Edhe pse thonë disa hollësi në mënyra të ndryshme, Ungjijtë përputhen në të gjitha pikat kryesore. Të dhënat janë në harmoni mbi faktin se Jezusi vdiq e u varros; se dishepujt nuk ishin të përgatitur për vdekjen e Tij; por ishin krejt të hutuar; se varri ishte i boshatisur në mëngjesin e Pashkës; se varri bosh nuk i bindi ata se Jezusi ishte ringjallur; se Maria mendoi se trupi ishte grabitur.

Shkrimtarët Ungjillorë gjithashtu pajtohen në atë se dishepujt kishin disa përjetime të cilat besonin se ishin shfaqje të Krishtit të ringjallur. Që

judaizmi normativ i shekullit të parë nuk kishte as edhe një koncept për vdekjen dhe ringjalljen e Mesisë, është fakt historik.

Dishepujt shpallën historinë e ringjalljes në Jeruzalem në vendin ku Jezusi ishte vvarë e varrosur. Të gjitha këto fakte të marra së bashku përbëjnë një argument të fuqishëm për vërtetësinë e historisë së ringjalljes.

Dijetari i nderuar Wilbur Smith thoshte kështu përsa u përket ndryshimeve në të dhënat për ringjalljen dhe në çështjet në të cilat Ungjijtë përputhen.

Në këto të vërteta themelore nuk ka absolutisht mospërputhje. Të ashtuquajturat ndryshime tek tregimet janë vetëm hollësira që ishin gjallërisht mbresëlënëse në mendjet e njerit apo të tjetrit dëshmitar për ringjalljen e Zotit tonë, apo në mendjen e shkrimtarëve të katër Ungjijve përkatës.

“Shqyrtimi më i afërt dhe më kritik i këtyre tregimeve në shekuj kurrë nuk e ka prishur dhe nuk do ta prishë dëshminë e tyre të fortë për të vërtetën që Krishti u ringjall nga vdekja në ditën e tretë dhe që u pa nga shumë njerëz”.
(*The Supernaturalness of Christ*, p.205).

MREKULLITE ATEHERE DHE TANI ■

Si mund të ndodhin mrekullitë?

Deklaratat e mëposhtme, njëra e vjetër dhe tjetra moderne, janë tipike për reagimin që njerëzit bëjnë ndaj mrekullive.

“Sepse asgjë nuk mund të ndodhë pa shkak; asgjë nuk ndodh nëse s’është e mundur dhe kur çfarë mund të ngjaste, ngjau, ajo nuk mund të interpretohet si mrekulli.

Rrjedhimisht mrekullitë nuk ekzistojnë... Atëherë ne nxjerrim këtë përfundim: çfarë arriti të ndodhë nuk është mrekulli”. (Cicero, *De Divinationes*, 2, 28, cituar nga V. Van der Loos in *The Miracle of Jesus*, p. 7).

Për shembull, është tregimi i jetës së Jezu Krishtit në Bibël. Ai tregim përmban dëshmi për ngjarje të cilat, në dritën e fakteve e të rregullave të njohura të natyrës, nuk mund të kenë ndodhur.

Fëmijët nuk lindin nga virgjëreshat, engjëjt nuk u sjellin mesazhe njerëzve, njerëzit nuk ecin mbi ujë, njerëzit që vdesin nuk kthehen më në këtë jetë, e kështu me radhë.

Historia e Jezu Krishtit u mbush me ato që njerëzit i mësuan si pamundësi; prandaj historia nuk mund të jetë një dëshmi e drejtëpërdrejtë e ngjarjeve të vërteta.

Kur u shkrua Dhiata e Re, njerëzit mund të ishin mjaft naivë për të besuar gjërat që u thanë për Jezusin dhe mund të mos kenë parë asnjë mospërputhje midis dëshmive dhe njohurive të tyre për botën, kurse tani gjithçka është ndryshe. (*Protestantizmi*, cituar nga J. Leslie Dunstan, p. 128, 129).

Shumë njerëz qeshin me idenë e mundësisë së mrekullive. Ata argumentojnë se mrekullitë janë dhunim i ligjeve shkencore e si rrjedhim, janë të papranueshme për njeriun modern. Shkrimet, megjithatë, nga fillimi në fund, përmbajnë histori të mbinatyrshme. Ka dëshmi për të verbrit që fituan menjëherë shikimin, njerëz të vdekur që u kthyen në jetë, dhe ndodhi të jashtëzakonshme brenda natyrës, sikurse përmbajtja e përgjithshme dhe ndarja e Detit të Kuq.

Baza për të besuar te mrekullia nis që në konceptin biblik për Perëndinë. Rreshti i parë i Biblës e zgjidh problemin. “Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën” (Zanafilla 1:1) Nëse ky rresht do të pranohet siç është, domethënë se një Zot i paanë krijoi gjithësinë, atëherë ajo që mbetet nuk do të krijonte problem. Nëse Ai ka aftësinë të bëjë këtë, atëherë edhe një lindje virgjërore, ecja mbi ujë, ushqyerja e 5000 njerëzve me pak bukë e peshk dhe mrekullitë e tjera biblike, bëhen jo vetëm të mundura por dhe të pritshme.

Nëse dikush nuk beson te Zoti, nuk mund ta pranojë mbinaturën, kurse për ata që e kanë pranuar mundësinë, ajo nuk është aspak absurde. Ashtu siç i tha dikur Apostulli Pal nje mbreti mosbesues, "Përse vallë mendoni se është e pabesueshme që Perëndia t'i ringjallë të vdekurit?" (Veprat 26:8).

Kështu pra, pas kësaj pyetjeje të rëndësishme qëndron problemi i njohur nëse ekziston apo nuk ekziston Zoti. Sepse, nëse ka një Zot, atëherë me siguri mrekullitë janë të mundshme.

Në fakt, vetë natyra e pyetjes: "Po si mund të ndodhin mrekullitë?" nënkupton se ekziston një Zot sepse një mrekulli është një veprim i Zotit.

Sa i përket mendimit se mrekullitë dhunojnë ligjet natyrale dhe shkencore, ne duhet të kujtojmë se ligjet e natyrës as i diktojnë ngjarjet dhe as i shpjegojnë ato. Ato janë thjesht, përgjithësim për shkaqet dhe pasojat e vëzhguara.

Askush nuk mund të hedhë poshtë pretendimin për ndarjen e Detit të Kuq 3500 vjet më parë me vërejtjen se kjo nuk ndodh çdo ditë. Duke iu drejtuar ligjeve të natyrës për të mos pranuar mrekullitë, nuk sjell dobi, sepse Bibla na mëson se një Zot i gjithëfuqishëm ka shpërthyer me forcë rregullin e natyrës (herë pas here) me veprimet e veta të fuqishme.

Sipas përkufizimit, një mrekulli është një ngjarje që mbetet unike dhe e paprecedent. Është e pamundur që të shpjegojmë siç ne bëjmë punë të tjera. Mënyra e saktë për të përcaktuar nëse diçka ngjau, nuk është nëse ne mund ta shpjegojmë atë apo jo. Pyetja e parë që mund të bëhet nuk është: "A mund të ndodhe një gjë e tillë?", por më e drejta, "Ndodhi"?

Nëse një ngjarje mund të gjykohet si e vërtetë, megjithëse nuk shpjegohet dot, ne nuk na mbetet veçse ta pranojmë ngjarjen, të shpjeguar ose jo. Provat për mrekullitë biblike janë po aq të fuqishme historikisht sa edhe vetë ngjarjet e tjera historike (kujto p. sh. rënien e Romës apo pushtimet e Aleksandrit të madh). Fakti që mrekullitë qëndrojnë jashtë përvojës sonë normale e të përditshme, nuk do të thotë se ato nuk kanë ndodhur dhe nuk do të ndodhin.

Pra, kur e tërë dëshmia merret parasysh, ekzistojnë arsye të forta të besojmë jo vetëm në mundësinë e mrekullive por edhe në vërtetësinë e tyre.

A ishin mrekullitë biblike dredhi magjike që budallallepsen njerëzit e thjeshtë dhe primitivë?

Shpesh është debatuar mbi atë se njerëzit që jetuan kohërat biblike ishin primitivë dhe më me bestytini sesa njeriu i sotëm modern; prandaj edhe mund të mashtroheshin me historitë mbinatyrore të përfshira në Bibël.

Sot pretendohet se jetojmë në një epokë shkencore dhe se tashmë i

kemi kapërcyer këto bestytini, sepse kemi zhvilluar fuqinë mendore sa t'i konsiderojmë mrekullitë si fenomene bestytnie, jo si fenomene paranormale. Një studim më i kujdesshëm i dëshmisë, do të na tregojë se këto dëshmi nuk janë reagime bestytnie ndaj ndonjë mashtruesi të mençur e dinak. Reagimi ndaj veprimeve mrekulluese të Zotit tregon të njejtën habi e shqetësim që njeriu modern, do të shfaqte nëse ai do të vihej në të njejtën gjendje.

Njerëzit që jetonin në kohën e Jezusit, me siguri e dinin se ata që lindnin të verbër nuk e fitonin menjëherë shikimin (Gjoni 9:32), se pesë bukë e disa peshq nuk mund të ushqenin 5000 njerëz (Gjoni 6:14) dhe se njerëzit nuk mund të ecin mbi ujë. (Mateu 14:26)

Pse dyshonte Toma tha: "Po nuk i pashë në duart e tij shenjën e gozhdave dhe dorën time ta vë në brinjën e tij, unë nuk do të besoj." (Gjoni 20:25) Ai kundërshtoi të pranonte dëshminë e ngjarjes së pabesueshme të ringjalljes, por ndërroi mendje kur u ndodh ballë për ballë me Krishtin e ringjallur. Prandaj, nuk pritet që ne të besojmë qesharaken; dhe nuk pritej as nga njerëzit e kohëve biblike.

Njerëzit që jetuan në ato kohëra, ishin po aq skeptikë sa ç'jemi dhe ne sot. Ishin faktet e paevitueshme, të padevijueshme, dhe të pakundërshtueshme që i bënin ata të besonin. Rregulli natyror ndërpritej përderisa ndodhte mrekullia. Është vetëm skepticizmi i njeriut modern që e bën atë të mohojë kryerjen e mrekullive.

Çfarë i bëjnë mrekullitë biblike madhështore ndaj atyre që pretendojnë fetë e tjera?

Disa njerëz ndjejnë se mrekullitë e regjistruara në Bibël zbulojnë faktin se Shkrimet nuk duhen marrë seriozisht. Ato krahasohen me mitologjinë greke dhe përrallat e tjera të mbinatyreshme dhe të çuditshme. Në vend që të hetojnë bazën e tyre, ata i klasifikojnë ato me legjendat dhe folklorin.

Pa dyshim që gjenden shumë histori nga koha e Zotit tonë, midis grekëve e romakëve, që janë më shumë imagjinare dhe qesharake sesa të denja për konsideratë serioze. Kjo është në kontrast të plotë me mrekullitë biblike, të cilat kurrë nuk ofrojnë një paraqitje të tepruar të së mbinatyreshmes. Të thuash se meqë disa ngjarje të mbinatyreshme të pretenduara janë qesharake e të pavërteta, del se dhe ndodhitë apo mrekullitë e pretenduara të jenë të pavërteta, (shëno një arsyetim të gabuar). Është "faj për shkak të shoqërimit" të idesë ose një rast ku flaket tutje foshnja bashkë me ujin e banjës.

Ndër fjalët e përdorura në Dhiatën e Re për mrekullitë, më të rëndomtat janë ato që shprehin idenë e "forcave mbinatyrore". Këto janë fjalët e përdorura jo vetëm nga autorët e Dhiatës së Re, por edhe nga shkrimtarët grekë e romakë në tregimet dhe mitet e tyre. Megjithatë në rrëfimin biblik

përdoret një fjalë shtesë, shumë pak e përdorur nga autorët grekë dhe romakë.

Fjala e përdorur është “shenjë” e cila nënkupton mrekullinë e provuar ose dëshminë e mrekullueshme. Gjoni deklaroi në fund të Ungjillit të tij “Jezusi bëri edhe shumë shenja të tjera në praninë e dishepujve të tij, të cilat nuk janë shkruar në këtë libër. Por këto gjëra janë shkruar që ju të besoni se Jezusi është Mesia, Biri i Perëndisë dhe që, duke besuar, ta keni jetën në emër të tij”. (Gjoni 20:30–31)

Tregimet e mrekullive, sikurse shënohen në Bibël, gjithmonë kryhen për një qëllim të caktuar, dhe kurrë për t’u mburrur. Gjithmonë do të gjendet një arsye logjike për to. Për shembull gjendeshin 5000 njerëz që kishin nevojë të menjëhershme për ushqim i cili u sigurua menjëherë me mjete mrekullie. (Luka 9:12, 17)

Në një gosti dasme në Kanë vera u mbarua dhe nevoja për të bëri që Jezusi ta kthente ujin në verë. (Gjoni 2:1, 11) Mrekullitë e Jezusit u kryen në saje të dashurisë dhe dhembshurisë për ata që ndiheshin të brengosur e të vuajtur. Ato ishin, gjithashtu, prova objektive për popullin se ai ishte Mesia i premtuar, sepse një nga kredencialet e Mesisë do të ishte shenja dhe mrekullia.

Jezusi vetë e theksoi këtë fakt kur, i pyetur prej lajmësve të Gjon Pagëzorit për identitetin e tij, tha: “Shkoni dhe i tregoni Gjonit gjërat që dëgjoni e shikoni: Të verbrit po shohin, të çalët po ecin, lebrozët janë shëruar dhe të shurdhrit po dëgjojnë; të vdekurit po ngjallen dhe ungjilli po u predikohet të varfërve.” (Mateu 11:4, 5)

Kur lexon tregimet e mrekullive në Bibël, dhe veçanërisht në ungjijtë, lexuesi do të vërë re faktin se mrekullitë nuk janë mohuar prej kritikëve. Në jetën dhe veprimtarinë e Jezusit vëmë re se ai kurrë nuk u pyet nëse bënte mrekulli; ai gjithmonë pyetej se si kishte të drejtë për t’i kryer ato. Ata donin të dinin se nga i vinte pushteti dhe forca. (Mateu 21:23)

Ishte e pamundur për ta të mohanin se ai bënte vepra të mbinatyrshe; me qindra njerëz ishin shëruar prej tij; nuk kishte shpjegim tjetër: kryerja e mrekullive nga ana e Jezusit, Simon Pjetri tha para një morie njerëzish: “Jezusi Nazareas, njeriu i dëftuar nga Perëndia ndër ju me vepra të fuqishme me mrekulli dhe shenja që Perëndia bëri ndër ju me anë të tij, siç edhe vetë e dini.” (Veprat 2:22)

Këtu Pjetri, para një turme armiqësore, pohon se vetë njerëzit ishin të vetëdijshëm për mrekullitë e Jezusit.

Fakti që nuk u kundërshtua për ato që tha, vërteton më së miri se çuditë e kryera prej Jezusit ishin të miratuara dhe të pranuar.

Dëshmia e mirëfilltë për mrekullitë nuk gjendet në asnjë fe tjetër, as në mitologjinë greke as në atë romake. Dëshmia e drejtpërdrejt për punët e mbinatyrshe, që ndërhyjnë në rrjedhën e jetës së natyrshe, na janë

dhënë në Bibël prej vetë dëshmitarëve të këtyre ngjarjeve.

Të gjitha këto shqyrtime hedhin dritë mbi dallimet cilësore të mrekullive biblike. Është e rëndësishme të theksojmë se përse këto mrekulli nuk pranohen nga shumëkush. Një nga arsytet se përse këto mrekulli hidhen poshtë është se ato nuk përputhen me botëkuptimin e shumë njerëzve. Këta njerëz nuk kanë parë kurrë një mrekulli prandaj kanë ardhur në përfundimin se ato s'mund të ndodhin, ose se nuk mund të ndodhin.

Duke u nisur nga mendimi se mrekullia është krejtësisht e pamundur, ata përjashtojnë çdo përpjekje për të shqyrtuar provat për të mbinatyreshmen. Kjo nuk është e drejtë, sepse vetëm ai që ka njohuri të plotë mbi të gjitha ngjarjet e së shkuarës, të së tashmes e të së ardhmes, do të ishte në gjendje të përjashtonte mundësinë e mrekullisë. Ka një shembull i njohur historik të marrëzisë që të bën të mos pranosh diçka sepse ajo nuk përputhet me botëkuptimin tënd.

Kur eksploratorët e parë shkuan në Australi, u ndeshën me një kafshë, që sfidonte të gjitha ligjet e njohura të taksonomisë¹. Ata zbuluan një kafshë sisore gjysmëvjore vezëpjellëse, me një bisht të gjërë e të sheshtë, këmbëlopatë dhe me një turi të ngjashëm me atë të një sqepi rose.

Ata e quajtën këtë kafshë platipus.² Me t'u kthyer në atdhe, ata u treguan njerëzve zbulimin e tyre. Njerëzit e quajtën tregimin e tyre një trillim, meqenëse një kafshë me të tilla karakteristika, nuk mund të ekzistonte. Edhe pse kishte dëshmi okulare të njerëzve të ndershëm, ajo u hodh poshtë për shkak të botëkuptimit të tyre.

Eksploratorët shkuan përsëri në Australi dhe u kthyen me lëkurën e një platipusi të mbytur. Këtë herë njerëzit i akuzuan se eksploratorët po u bënin përsëri një lojë të re. Duket se ata e merrnin seriozisht thënien e Benjamin Disraelit³: "Unë e kam si rregull që të besoj vetëm atë që kuptoj." (*The Infernal Marriage*, 1Pjetrit 4). Megjithatë, siç thotë Charles Caleb Colton, "Ai që do të besojë vetëm çfarë mund të kuptojë plotësisht, duhet të ketë një kohë shumë të gjatë ose një besim shumë të shkurtër." (Frank Mead, *Encyclopedia of Religious Quotations*, p.17)

Shumë njerëz, fatkeqësisht, mbajnë një qëndrim të tillë dhe japin një gjykim para se të shqyrtojnë dëshmitë. Një qëndrim i tillë është jo vetëm antishkencor, por edhe i rrezikshëm për vete personin që e ka atë pikëpamje. Nëse ka një Zot dhe nëse Ai na e ka shfaqur veten nëpërmjet mrekullive, atëherë çdo njeri pret rastin për ta gjetur dhe njohur.

1. Taksonomi-a: shkenca e klasifikimit të kafshëve dhe bimëve në grupet natyrore përkatëse, bazuar mbi disa veçori të njëjta.(shën.i përkth.)

2. plabtius: këmbëshesh.(shën.i përkth.)

3. Disraeli, Benjamin, 1804-1881, burrë shteti anglez, shkrimtar dhe kryeministër në v.1874-1880 (shën.i përkth.)

Një njeri që hedh poshtë mundësinë e ndërhyrjes së Zotit në mënyrë të mbinatyrshme në rrjedhën e historisë, largon të vetmen shpresë për të kuptuar se çfarë është jeta në tërësi. Rrjedhimisht, gjëja më e rëndësishme që duhet të bëjmë është që, të paktën, të studiojmë mundësinë e realizimit të mrekullive për shkak të interesave që konsiderohen të përjetshme. Ka, me të vërtetë, “më shumë gjëra në qiell e në tokë, Horac, sesa ëndërrohen në filozofinë tuaj.”

Çfarë mendoni për alternativat e ndryshme të krishterimit si, agnosticizmi, ateizmi dhe humanizmi?

Shumë njerëz që kanë hedhur poshtë mendimin e krishterë, kanë përqaftuar pikëpamje të tjera. Pjesa më e madhe e tyre deklarojnë se Zoti nuk ekziston; edhe po të ekzistonte, ishte dhe është krejt e pamundur të njihet. Pretendimet e këtyre alternativave nuk i qëndrojnë provave.

Një agnostik zakonisht është një njeri që nuk di nëse Zoti ekziston. Agnostiku nuk ka vendosur përfundimisht se ç'mendon për Zotin. Disa agnostikë janë më agresivë se të tjerët në kërkim të Perëndisë dhe këtë ne e përshendesim.

Bibla na mëson se, nëse dikush dëshiron ta njohë të vërtetën rreth Perëndisë, ai me siguri do ta njohë. “Në qoftë se dikush do të bëjë vullnetin e tij, do ta njohë nëse kjo doktrinë vjen nga Perëndia apo nëse unë flas nga vetja ime.” (Gjoni 7:17)

Fatkeqësisht shumica e agnostikëve nuk bëjnë përpjekje serioze për të parë nëse Zoti ekziston. Këtë çështje ata nuk e konsiderojnë të rëndësishme dhe vendimtare por megjithatë është vendimtare! Pikërisht fakti që një agnostik nuk mund të jetë i sigurt nëse ka një Zot apo jo, e bën logjike edhe përpjekjen e tij për të shqyrtuar pretendimet e krishterimit. Që këtej rezulton se agnosticizmi nuk është arsye për të mospranuar krishterimin; më mirë të themi se ai është arsye për ta marrë në shqyrtim atë.

Ateistët pohojnë se nuk ka fare Zot. Megjithatë duhet thënë se ata nuk e mbajnë dot këtë pozicion në mënyrë dogmatike. Që të mund të bënin një deklaratë të tillë me bindje, do të duhej të njihnin gjithësinë në tërë tërësinë e saj dhe të zotëronim gjithë diturinë e kësaj bote. Nëse dikush do t'i kishte këto kredenciale, atëherë ai do të quhej Perëndi.

Pra, meqë ateisti qenka i gjithëanshëm, nuk ka pse të bëjë deklaratë dogmatike për Perëndinë.

Prandaj ateisti mund të pohojë vetëm pasigurinë nëse ekziston apo jo Perëndia, dhe kjo pikëpamje është agnosticizëm. Ne tashmë e kemi parë këtë teori dhe e kemi konsideruar të paplotë. Pretendimi i ateistit se Zoti nuk ekziston, thërrmohet menjëherë nën forcën logjike të hetimit.

Nga ana e tij humanisti beson se njeriu është në gjëndje t'i zgjidhë vetë të gjitha problemet që e shqetësojnë. Parimi i tyre “njeriu është masa e gjithçkaje” nuk ofron asnjë zgjidhje konkrete për ata që kërkojnë një rrugëdalje. Sot humanizmi është bërë shumë popullor.

Humanizmi dështon në dy drejtime. Së pari, njeriu, duke vepruar sipas idesë së tij, nuk është në gjëndje të përcaktojë kriteret e vërteta të drejtësisë

pa Perëndinë. Nëse dikush e vlerëson pikëpamjen e tij si të saktë dhe një tjetër, atëherë, kush do të vendosë midis tyre?

Kush do të vendoste midis nazistëve dhe çifutëve në Luftën e Dytë Botërore? Secila palë kishte një mori arsyes, por cili thoshte të vërtetën? Shumica? Më sqimatarët? Më të egrit?

Pa ligjet e një autoriteti më të lartë, siç është Perëndia, gjithë jeta do të bazohej mbi kriteret e shumicës apo dhe të një diktatori në fuqi. Ata nuk kanë asnjë të vërtetë të sigurt ku të referohen, gjithçka do të ishte thjesht çështje opinioni.

Së dyti, humanizmi beson se njeriu “po bëhet gjithnjë e më i mirë çdo ditë dhe në çdo drejtim.” Megjithatë, luftërat botërore brenda këtij shekulli dhe me botën e sotme në prag të shfarosjes masive bërthamore, është përfundim i njohur i humanizmit optimist. Në këtë mënyrë humanizmi nuk ofron shpresë por dëshpërim. Humanizmi nuk zgjidh probleme, por krijon probleme. Po ta analizojmë objektivisht, humanizmi e drejton njeriun të vështrojë përtej qënies njerëzore për të gjetur përgjigjet e pyetjeve të shtruara. Të gjitha këto alternativa, kur analizohen në tërësi, nuk konsiderohen të rrezikshme për të shkatërruar krishterimin, përkundrazi, ato e forcojnë të. Kjo ndodh sepse sistemet filozofike dhe besimet e tjera fetare në kërkimin e së vërtetës dhe kuptimin e jetës, nuk gjejnë dot zgjidhje. Pa Biblën si bazë e qëndrueshme, nuk gjendet asnjë rrugë tjetër për të përcaktuar të vërtetën. Vetëm Bibla i ofron njeriut të vërtetën dhe shpresën.

A nuk na mësojnë në themel të njëjtën gjë të gjitha besimet fetare?

Shumë njerëz çuditen përse ne bëjmë kaq zhurmë për Jezun Krishtin dhe Krishterimin, derisa besojmë se të gjitha fetë kanë të njëjtën bazë. Ato besojnë se të gjitha fetë flasin për të njëjtin subjekt, veçse e paraqesin atë në mënyra të ndryshme.

Dikush dha këtë shembull për këtë çështje: “Merrni dhjetë burra, u lidhni sytë, i çoni te një elefant dhe i bini të prekin secili një pjesë nga trupi i tij, - bishtin, hundën etj. - por pa u treguar se çfarë po prekin. Pastaj i çoni brenda, ua zgjidhni sytë dhe i pyesni për atë që prekën. Mendoni se përshkrimet që ata bëjnë përputhen?” Përgjigja është negative. Pra, burra, edhe pse prekën të njëjtën kafshë, nuk dhanë të njëjtin përshkrim, meqë kishin prekur pjesë të ndryshme, ose sepse, e kishin përjetuar në mënyra të ndryshme. Në fund të shembullit thuhet “A nuk është e njëjta gjë edhe në fushën e besimit?”

Rrjedhimisht: të gjitha grupet e ndryshme fetare si të krishterët, myslimanët, mormonët, budistët etj. njohin të njëjtin Zot edhe pse e shpjegojnë në mënyra të ndryshme. A nuk mund të konsiderohen ato fe

të vërteta edhe pse secila ka theks të ndryshëm?

Problemi që lind në rastin e shembullit qëndron në faktin se elefanti identifikohet me Zotin. Sipas tij pranohet si e vërtetë se të gjithë burrat njohën të njëjtin Zot, edhe pse kjo në fakt nuk është e vërtetë. Krishterimi dhe islamizmi nuk mund të jenë njëherësh të dy të vërtetë. As mormonizmi dhe budizmi nuk mund të jenë njëkohësisht të vërtetë; po kështu as Shkenca e krishterë me hinduizmin.

Të gjitha besimet nuk mund të jenë të vërteta në të njëjtën kohë, derisa na mësojnë gjëra që janë në kundërshtim me njëra tjetrën. Ka mundësi që ato të jenë që të gjitha të gabuara, por të gjitha nuk kanë të drejtë, sepse pretendimet e njëres fe do të përjashtonin pretendimet e një feje tjetër.

Sa i përket çështjes së shpëtimit dhe të Jezu Krishtit, vetëm krishterimi e njeh atë Zot të përjetshëm të bërë njeri që vdiq për mëkatet e kësaj bote dhe u ngrit sërish ditën e tretë. Shpëtimi fitohet vetëm duke patur besim të ky Jezus.

Jezusi në islamizëm nuk është Biri i Perëndisë që vdiq për mëkatet e kësaj bote, sikurse nuk është Jezusi i Biblës po ai që jepet në mormonizëm apo në Shkencën e krishterë.

Në fetë e mësipërme shpëtimi nuk vjen nëpërmjet hirit dhe besimit, përkundrazi, shpëtimi është çështje veprash e fjalësh. Pra, mund të vihet re që ne ndeshemi me pikëpamje të ndryshme fetare që nuk përputhen me njëra-tjetrën.

Edhe pse shumë besime fetare duken të njëjta në sipërfaqe, sa më shumë që u afroresh ideve themelore, aq më të qarta bëhen ndryshimet. Është plotësisht e gabuar të thuash se të gjitha besimet fetare janë të njëjta. Zoti i të krishterëve nuk është i njëjtë te mormonët, myslimanët apo te shkencëtarët e krishterë. Nëse Zoti i Biblës është i vetmi Zot i vërtetë, atëherë të gjithë zotat e tjerë nuk janë të vërtetë dhe nuk duhet adhuruar.

Cilat janë disa nga ndryshimet midis krishterimit dhe feve të tjera lindore?

Ne jetojmë në kohën e zhvillimit të teknologjisë dhe të komunikacionit dhe, me anë të mediave kaq të zhvilluara si televizioni, mund të dëshmojmë për ngjarje të ndryshme që ndodhin rreth e qark globit. Kjo ka çuar në njohjen më nga afër të ideve dhe pikëpamjeve fetare të popujve të ndryshëm.

Lindja ka ndeshur te Perëndimi dhe ne shohim se ka ndryshime të mëdha midis krishterimit dhe besimeve të Lindjes. Zoti, në konceptin Lindor, është impersonal, ndërsa Zoti i Biblës personal. Në disa fe Lindore Zoti është gjithçka dhe gjithçka është Zot, kurse Bibla na mëson se Zoti është i pavarur nga krijesa e Tij.

Një nga konceptet themelore të pikëpamjes Lindore është koncepti i iluzionit material ("maja" në hinduisht); bota materiale është iluzion, dhe mëkati nuk është tjetër veç mosnjohje rreth tij.

Shkrimet na mësojnë se bota është realitet objektiv dhe se mëkati është larg paditurisë së thjeshtë rreth iluzionit të botës; ai është rebelim i vullnetshëm kundër Zotit të vërtetë e të pakufi.

Ligji i karmës është një besim i koklavitur në shumë fe Lindore. Karma e mirë, d.m.th. punët e mira, formojnë rrugën nëpër të cilën do të kalojë njeriu për t'u çliruar nga rrethi i rilindjes, kurse karma e keqe e bën një njeri të rilinde në një formë më të ulët se jeta e mëparshme. Shpëtimi bazohet mbi punët.

Shkrimet na mësojnë se veprat njerëzore nuk merren në konsideratë në çështjen e shpëtimit të përjetshëm. "Ai na shpëtoi jo me anë të veprave të drejta që ne bëmë, por sipas mëshirës së tij." (Titit 3:5) Punët zënë natyrisht, një vend shumë të rëndësishëm, por ato na shfaqen brenda jetës e cila tashmë e ka marrë shpëtimin që jep Zoti dhe duhet të jenë shprehje e hirshme dhe e bukur që tregon se shpëtimi për atë njeri është i vërtetë. (Efesianëve 2:10)

Sa i përket pikëpamjes së shtegtimit të shpirtave, të rilindjeve të përsëritura derisa dikush të arrijë Nirvanën apo lumturisë së përjetshme, Bibla nuk na mëson një lajm të rastit të dytë. Mësimi i Shkrimeve thekson se çdo njeri është unik, jo pjesë e çdo gjëje dhe se, pasi ai person unik vdes, do të gjykohet nga Zoti. (Hebrenjve 9:27)

Botëkuptimi i krishterë është krejt i ndryshëm nga ajo e besimeve Lindore. Historia nuk ka asnjë synim a kuptim për mendimin Lindor; ajo është përpjekje dhe luftë e përjetshme. Bibla na përshkruan një Zot mbinatyral, i cili punon për të arritur qëllimin përfundimtar të themelimit të mbretërisë së Tij të përjetshme.

Një rrugë tjetër e cila ka shërbyer që Perëndimi të njohë mendimin Lindor është kultura e drogës. Bashkë me theksimin e narkotikëve në komplekset universitare, në vitet gjashtëdhjetë erdhi edhe një theksim i besimit fetar Lindor, gjë që u shkoi shumë për shtat atyre që kërkonin një rrugëdalje. Ky interesim i rritur brenda bashkësive akademike solli një letërsi plot e përplot me format e mendimit Lindor që më pas do të shpërthente edhe në mes të kulturës Perëndimore. Autorë të tillë si Hesse, Casteneda dhe Pesig u bënë popullorë. Madje edhe grupe të tilla si Meditimi Transhendent (TM) fituan respekt dhe lulëzuan kudo.

Vërtet që ka shumë ndryshime të tjera ndërmjet mendimit fetar Lindor dhe krishterimit; ka shumë pak ngjasime, qoftë dhe sipërfaqësore. Ndryshimet e mësipërme janë të mjaftueshme për të treguar mungesën e përputhjes midis krishterimit dhe feve Lindore në çdo aspekt përfundimtar të besimit.

Cilat janë burimet e islamizmit?

Thuajse 500 milionë njerëz, rreth një e shtata e popullsisë së botës, janë myslimanë. Themeluesi i fesë së tyre është Muhamedi, i cili, sipas myslimanëve, qe më i madhi i profetëve.

Muhamedi lindi në vitin 570 (era jonë) në Mekë. Vitet e para të jetës së tij ishin pa ndodhi; merrej me drejtimin e karvaneve me deve dhe me administrimin e pasurisë të së shoqes. Por ja, një mbrëmje, në një shpellë të malit Hira ku shkonte shpesh për t'u lutur, dëgjoi një zë të lartë që i tha "Lexo!"

Ndërsa kundërshtonte, duke thënë se nuk dinte të lexonte, ai dëgjoi zërin ta urdhëronte sërish. Pastaj iu shfaq një pergamenë mbi të cilën fjalët ishin zbukuruar me zjarr. Sidoqë nuk kishte qenë kurrë ndonjëherë në gjendje të lexonte qoftë dhe një fjalë, mrekullisht Muhamedi e lexoi pergamenën.

Ai u largua nga shpella plot frikë se mos qe çmendur, por dëgjoi sërish zërin. Duke hedhur vështrimin lart në qiell, Muhamedi pa engjëllin Gabrielnë formë njerëzore që i tha: "Oh, Muhamed, Ti je lajmëtari i Allahut dhe unë jam Gabrieli."

Megjithatë, sikurse na thotë tregimi, kjo nuk e bindi Muhamedin. Më pas ai dëgjoi edhe një thirrje tjetër, së cilës iu bind. Misioni i tij si apostull i Perëndisë ishte që t'i shpallte popullit të tij idhujtar një monoteizëm të pastër.

Fillimisht mesazhi i tij ndeshi në kundërshtim të madh, shoqëruar me përndjekje dhe dëbim nga populli i tij. Ai pretendoi se merrte mesazhe e zbulesa të tjera nga vetë Allahu që e shpallte atë pasues të profetëve pararendës si: Noeut, Abrahamit, Moisiut dhe Jezusit.

Përfundimisht Muhamedi e vlerësoi veten e tij si lajmëtari i fundit që Allahu do të dërgonte në këtë botë, duke e bërë atë profet të veçantë. Në vitin 622 (era jonë) një grup prej njëqind e pesëdhjetë myslimanësh la Mekën fshehurazi për në qytetin Jatrib. Drejt atij qyteti Muhamedi udhëtoi më vonë, më 20 shtator, datë në të cilën nis edhe kalendari mysliman. Qyteti më vonë mori emrin Medina, për nder të banimit tetëvjeçar të Muhamedit në të.

Në moshën gjashtëdhjetë vjeçare Muhamedi bashkë me ushtrinë e tij ndërmori marshimin mbi Mekë¹, në përpjekje për ta shpallur atë Qytetin e Shenjtë të Islamit: e pushtoi përkundër gjasave të panumërta. Dy vjet më vonë profeti i Allahut vdiq.

Shembulli dhe modeli për pasuesit e Muhamedit ishte dhënë. Armiqtë e Allahut duhet të shpartalloheshin. Islamizmi u përhap me shpejtësi përtej kufijve të Arabisë, duke pushtuar edhe Jeruzalemin në vitin 636 (era jonë).

Rreth vitit 715 perandoria u shtri nga kufiri kinez në lindje deri në

brigjet e Oqeanit Atlantik në Perëndim. Kështu, Islami nisi kërkesën e tij për zbatimin e parimeve të Allahut, duke u bërë më pas një nga besimet fetare më të mëdha në botë.

Cilat janë besimet e islamit?

Ashtu sikurse çifutët besojnë në Dhiatën e Vjetër dhe të krishterët e vënë besimin e tyre në Dhiatën e Vjetër e të Re, myslimanët besojnë se Kurani është fjala hyjnore e Zotit. Ky libër, i cili përmban zbulesat e supozuara dhënë Muhamedit nga Perëndia, ndahet në 114 kapituj, apo sure. Pasuesit e Muhamedit e shkruan Kuranin menjëherë pas vdekjes së tij.

Për myslimanët Kurani është fjala e fundit e Zotit për botën. Kurani thotë se edhe Dhiata e Vjetër dhe e Re janë të frymëzuara hyjnisht, por më vonë pësuan ndryshime nga të krishterët dhe çifutët. Në çdo vend ku ata gjejnë kundërshtim, Bibla gabon dhe Kurani është autoriteti vendimtar. (Sureja 33:40)

Mësimi themelor i Kuranit, i quajtur edhe kredoja islamike, përbëhet nga pesë parime themelore që e përshkojnë gjithë Kuranin. Pohimi i preferuar në Islam është “Nuk ka Zot tjetër veç Allahut.”, pohim i cili shqiptohet çdo ditë prej myslimanëve. Mëvetësia e Perëndisë është një parim themelor i fesë myslimane.

Një tjetër ide e gjallë e myslimanëve është besimi te engjëjt si lajmëtarë të Allahut. Ky koncept në Islamizëm pak ndryshon nga pikëpamja biblike.

Myslimanët besojnë se Allahu e ka shfaqur veten nëpërmjet Shkrimit të Shenjtë, përfshirë këtu Testamentin e Vjetër, ungjijtë, (edhe pse nuk i besojnë të jenë të saktë), Kuranin si dhe në gojëdhënat që nuk përfshihen në Kuran dhe që quhen hadithe. Nga të gjitha burimet e mësipërme për myslimanët vetëm Kurani është plotësisht i besueshëm.

Islami ka gjithashtu besim të fuqishëm te profetët, ndër të cilët Muhamedi mbetet më i madhi, meqë iu dërgua mbarë botës; Jezusi vlerësohet si profet i dërguar vetëm për çifutët.

Theks i fortë i vihet në Islam asaj që lidhet me Ditën e Gjyqit. Gjithë njerëzit do të gjykohen sipas veprave të tyre. Myslimanët do të hyjnë në Parajsë (dhe pse disave do t’u duhet të pastrohen nga mëkatet), kurse ata që nuk janë myslimanë do të dënohen përgjithmonë në një gropë të thellë me zjarr.

Përveç pesë besimeve bazë, myslimanët kanë edhe pesë shtyllat apo ritualet që janë si pjesë e fesë së tyre; ato janë:

1. Kredoja ose pohimi i besimit se “nuk ka asnjë Zot veç Allahut dhe Muhamedi është profeti i Allahut.”

2. Lutjet rituale të kryhen pesë herë në ditë me fytyrë nga Meka.
3. Dhënie lëmoshash, duke ofruar 1/40 te të ardhurave për nevojtarët.
4. Respektimi i Ramazanit, periudhë në të cilën myslimanët agjërojnë gjatë gjithë ditës.
5. Haxhillëk për në Mekë, i cili u kërkohet tërë myslimanëve para se të vdesin.

Është edhe një shtyllë e gjashtë jozyrtare, e njohur si luftë e shenjtë, që përdoret për të përhapur islamin. Në fund, myslimanët e vlerësojnë Zotin si hyjni absolute, vullneti i të cilit është ligj. Zoti nuk mund të njihet në kuptimin personal, prandaj qëllimi i islamit është t'i bindesh Allahut dhe jo ta njohësh atë.

A është islamizmi në pajtim me krishterimin?

Ashtu si me të gjitha besimet fetare të njerëzimit, edhe midis krishterimit dhe islamit ka dallime shumë të mëdha. Një shqyrtim i afërt i të dy besimeve çon në përfundimin se pohimet e tyre janë të papajtueshme.

Muhamedi pretendonte se zbulesat e dhëna nga Perëndia ishin të pagabueshme, dhe kjo e bën kështu Kuranin kriter për vlerësimin e Shkrimeve të tjera. Mirëpo pretendimi për zbulesa është pa kuptim, derisa nuk mbështetet në dëshmi të mjaftueshme.

Dëshmia për frymëzimin dhe besueshmërinë historike të Biblës është e pafund, kurse ajo për pagabueshmërinë e Kuranit është e paplotësuar.

Muhamedi pohonte se portreti ungjillor i Jezusit është i pasaktë, kurse përshkrimi që Zoti i dha atij vetë është i saktë. Rrjedhimisht myslimani beson atë çka thotë Kurani për jetën e Jezusit më tepër sesa dëshminë e Dhiatës së Re. Jezusi i Kuranit nuk është i njëjtë me atë të portretizuar në Dhiatën e Re. Të dyja dëshmitë nuk ka se si të jenë njëkohësisht të vërteta.

Është e qartë se mësimet e krishterimit e të islamit nuk mund të jenë të pajtueshme. Kurani është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Shkrimet sa i përket Jezu Krishtit. "Jezu Krishti, biri i Maries, nuk ishte më shumë se apostull i Zotit." (Sureja 19:92)

Përveç kësaj Kurani shpall se Jezusi është profet vetëm i kombit të Izraelit, kurse Muhamedi vlerësohet si profeti i fundit dhe më i madhi i gjithë botës.

Ballafaqojeni këtë me imazhin biblik për Jezu Krishtin: "Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë; dhe Fjala ishte Perëndi" (Gjoni 1:1), "Kush më ka parë mua, ka parë Atin." (Gjoni 14:9), "Ti je Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë." (Mateu 16:16), "Dhe Ai, duke qenë shkëlqimi i lavdisë së Tij dhe vula e qënies së Tij, duke i mbajtur të gjitha me fjalën e fuqisë

së Tij, pasi e bëri vetë pastrimin nga mëkatet tona, u ul në të djathtën e Madhërisë në vendet e larta.” (Hebrenjve 1:3)

Kurani, duke folur për vdekjen e Krishtit, thotë: “Ata as e vranë as e kryqëzuan atë, ajo ishte vetëm dukja.”

Dhiata e Re e bën të qartë mënyrën e vdekjes së Krishtit. “Dhe kur arritën te vendi që quhet “Kafka”, ata e kryqëzuan atë.” (Luka 23:33), “Dhe Jezusi bërtiti me zë të lartë e tha: “O Atë, në duart e tua po e dorëzoj frymën time”. Dhe, si tha këto fjalë, dha frymën.” (Luka 23:46)

Bibla na mëson se Jezusi lindi nga Maria e virgjër, Perëndia në trup njerëzor. “Dhe engjëlli i tha: “Mos ki frikë, Mari, sepse ke gjetur hir para Perëndisë. Dhe ja, ti do të mbetesh shtatzënë dhe do të lindësh djalë dhe do t’ia vesh emrin Jezus.” (Luka 1:30,31), “Dhe engjëlli, duke iu përgjigjur i tha: “Fryma e shenjtë do të vijë mbi ty dhe pushteti i shumë të lartit; prandaj i shenjtë që do të lindë do të quhet Biri i Perëndisë.” (Luka 1:35)

Islami na mëson se Jezusi lindi mrekullisht nga Maria por myslimanët nuk besojnë në lindjen biblike nga virgjëria. Ata besojnë se, ashtu sikur Adami u krijua nga dheu dhe Jezusi u krijua nga Zoti në mitrën e Marisë. Ata thonë se Ai nuk është Zot apo Biri i Zotit. Edhe pse kjo do të ishte një mbarsje e mbinatyrshme, përsëri nuk është e njëjtë me lindjen biblike nga virgjëria.

Islami na mëson se shpëtimi vjen nga veprat. “Ata, balancat e të cilëve do të jenë të rënda, do të bekohen. Kurse ata, balancat e të cilëve do të jenë të lehta, do të humbasin shpirtin e tyre, duke ndenjur përherë në ferr.” (Sure 13:102–140). Pra, nëse peshorja anon nga punët e mira, myslimani do t’i afrohet parajsës, por, në të kundërt, ai do të dëbohet në ferr.

Bibla na mëson shpëtim mëshirë nëpërmjet besimit dhe jo me anë të veprave. “Ju në fakt jeni të shpëtuar me hiri nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, por është dhurata e Perëndisë, jo nga vepra , që të mos mburret askush.” (Efesianëve 2:8,9)

“Ai na shpëtoi jo me anë të veprave të drejta që ne bëmë, por sipas mëshirës së tij.” (Titit 3:5)

Një problem i rëndësishëm që duhet patur parasysh për të pranuar versionin e Muhamedit është se dëshmia e tij na vjen 600 vjet pas ngjarjeve të ndodhura, kurse Dhiata e Re përmban dëshmi okulare dhe të drejtpërdrejta nga jeta e Jezu Krishtit. Jezusi e bëri të qartë dallimin: “Kjo është vepra e Perëndisë; të besoni në atë që e ka dërguar.” (Gjoni 6:29)

■ KRISHTERIMI

Çfarë e bën të vlefshme rilindjene krishterë? Nuk mundet ajo të shpjegohet psikologjikisht?

Sa herë që një besimtar a besimtare jep dëshminë e vet, duket sikur gjithmonë dikush do të kundërshtojë që kjo të merret si dëshmi për të vërtetën kristiane. Pretendohet që secili ka përjetuar një lloj përvojë dhe rilindje fetare.

Mormonët bisedojnë për diçka të zjarrtë në zemrën e tyre, ata të besimeve Lindore flasin për paqen dhe qetësinë që përftojnë, kurse disa të tjerë pranojnë se ndjejnë gëzim e lumturi krejt të re.

Përse themi që rilindja e krishterë është e saktë dhe e të tjerëve jo? Mundet kjo të shpjegohet me përgjigje të kushtëzuara apo me një tip vetë-hipnoze?

Është e vërtetë se sot janë të shumtë ata që dëshmojnë përvojat e tyre fetare, duke pretenduar se në to kanë gjetur edhe të vërtetën përfundimtare. Në vështrim të parë edhe i krishteri ngjason me secilin syresh, meqënëse edhe ai ngul këmbë se ka përjetuar të vërtetën. Jobsimtari apo dhe vëzhguesi i rastësishëm ka nevojë për më shumë sesa një dëshmi të thjeshtë të përvojës subjektive, si kriter që të mund të gjykojë se kush ka të drejtë. Ndryshimi midis tyre në këtë rast është se të krishterët, e kanë atë kriter.

Rilindja e krishterë lidhet me Jezu Krishtin. Ajo është e rrënjësuar në realitet dhe nuk mbetet mendim abstrakt. Jezusi kishte kredencialet për të qenë Biri i vetëm i Zotit. Ai u bënte thirrje burrave e grave të mbështetnin besimin e tyre te Ai që të mund të njihnin Perëndinë dhe kuptimin e jetës në tërësinë e saj.

Jezusi tha: “Unë kam ardhur që të keni jetë dhe ta keni me bollëk.” (Gjoni 10:10) Kur dikush mbështet besimin e tij te Jezu Krishti, futet në një marrëdhënie personale me Zotin e Gjithëfuqishëm, veprim ky që vihet re në ndryshimet që ndodhin në jetën e tij.

Rilindja e krishterë nuk është as vetëpërsosje, as gjëndje e kushtëzuar nga kultura. Janë shumë njerëz që e vënë besimin e tyre te Jezu Krishti dhe që e bëjnë këtë përkundër ndikimeve të miqve e të familjes. Përvoja e krishterë mbështetet në mënyrë vendimtare te Zoti dhe vepra e Tij në jetën e njeriut. Kjo duhet të ndodhë patjetër. Përvoja mbështetet mbi këtë fakt dhe jo te vetë personi.

Rilindja e krishterë jo vetëm që mbështetet mbi diçka objektive, d.m.th. ringjalljen e Krishtit, por edhe vetë përvoja universale e krishterë duhet marrë patjetër në konsideratë. Që nga koha e Jezusit e deri më sot, njerëzit

e çfarëdo mjedisi, kulture, tradite apo qëndrimi intelektual, janë kthyer te Jezu Krishti.

Disa nga njerëzit më të këqinj që jetuan mbi këtë tokë u bënë shenjtët më të çuditshëm pasi i besuan Jezu Krishtit. Kjo duhet patur para sysh. Për shkak të shumëllojshmërisë së njerëzve, rilindja nuk mund të shpjegohet thjesht mbi bazën e një gjëndjeje a një situatë në të cilin ata ndodhen.

Le të themi, për shembull, se dikush ju afrohet e ju thotë se ka zbuluar kuptimin e jetës, të vërtetën themelore. Ju rrëfen se jeta e tij ka pësuar një ndryshim të madh e të vullshëm. Ju, me këtë rast, e pyetni se ç'gjë e rëndësishme shkaktoi këtë ndryshim të madh. Ai përgjigjet: "Që kur nisa të mbaj mbi kokë lëkurën e një bostani, jeta ime ndryshoi."

Pastaj ju pyesni shokët e tij; edhe ata pohojnë se jeta e shokut të tyre ndryshoi që në çastin kur ai vuri mbi krye lëkurën e bostanit.

Tani ju doni të dini nëse kjo përvojë është e veçantë apo është dukuri masive. Kështu ju filloni të vëzhgoni e të kërkoni në ka edhe njerëz të tjerë me lëkurë bostani mbi kokë.

Kërkoni sa kërkoni më në fund vini në përfundimin se vëzhgimi juaj është i kotë. Kështu dilni në konkluzionin se personi me lëkurën e bostanit po krijon vetë përvojën e tij, e cila nuk përputhet me realitetin përfundimtar.

Përvoja e krishterë është botërore dhe, sidoqë në vetvete nuk është thjesht ky fakt që e bën atë të vërtetë, ia vlen të merret shumë në konsideratë. Argumenti që e bën të vërtetë këtë pohim është se përvoja kristiane bazohet mbi dëshmitë mbizotëruese për hyjninë e Jezu Krishtit.

Çfarë shprese i ofron krishterimi njerëzimit?

Ne jetojmë në një kohë kur njerëzit ndjehen pesimistë për të ardhmen e tyre. Ka patur gjithmonë pesimistë, por tani ekziston një ndjenjë e përgjithshme e mungesës së shpresës për të ardhmen. Ekzistenca e armëve bërthamore ka mbjellë një frikë të tillë që ka gllabëruar tërë planetin.

Shembuj të këtij qëndrimi shihen në deklaratat e mëposhtme.

"Po bëhet gjithnjë e më e qartë se nuk është zija e bukës, mikrobet, kanceri, por vetë njeriu apo armiku më i madh i njerëzimit." (Carl Jung, "Epilogue" *Modern Man in Search of a Soul*, New York, Rutledge Books, 1933)

"Problemi i vërtetë qëndron në mendjet e zemrat e njerëzve; ai nuk është problem i trupit, por i etikës. Është më lehtë të denatyrosh platoniumin sesa të denatyrosh shpirtin e lig të njeriut." (Albert Ajnstajn, cituar nga Mead, fq.192)

"Sot, vetë mbijetesa e njerëzimit është shpresë utopike." (Norman O'Brown, *Life Against Death*. London, Sphere Books, Ltd.1968,p.267)

“Bota tani është bërë shumë e rrezikshme, për gjithçka më pak se utopinë.” (John Rader Platt. *The Step to Man*, New York, John Wiley and Sons, Ltd. 1966,p.196)

Problemi i mungesës së shpresës dhe i kuptimit të jetës nuk është vetëm për kohën tonë. Ai ishte shprehur edhe në të kaluarën, njerëzit kishin ndjer të njëjtën zbrazëti që ndien tani bota moderne. Për një pjesë të madhe të njerëzimit, pa asnjë shpresë përtej varrit kjo jetë është gjithçka. Por një ide e tillë nuk është aspak e re.

Vini re dhe krahasoni se çfarë kanë thënë disa nga shkrimtarët e së shkuarës përse i përket vdekjes. “Sapo njeriu vdes, për të nuk ka më ringjallje.” (Eskili) “Shpresa ekziston vetëm për ata që janë gjallë, jo për të vdekurit.” (Teokriti), “Menjëherë sapo drita jonë e shkurtër shuhet, vjen një natë e përjetshme në të cilën duhet të flemë.” (Katuli)

Kundër këtij sfondi plot pesimizëm Jezu Krishti ofron shpresën e vërtetë. Ai i jep mundësinë njerëzimit të jetë në rregull me Zotin dhe të afermin e tij. Kështu krishterimi u ofron jetë të plotë gjithë atyre që pranojnë Jezusin. “Unë kam ardhur që të kenë jetë, e ta kenë me bollëk.” (Gjoni 10:10)

Megjithatë, jeta e plotë nuk shterë kurrë. Për jetën pambarim ka shpresë që bazohet mbi premtimet e Zotit në Jezu Krishtin.

Jezusi tha: “Unë jam ringjallja dhe jeta; ai që beson në mua, edhe sikur ti duhet të vdesë, do të jetojë. Dhe ai që jeton e beson në mua, nuk do të vdesë kurrë përjetë.” (Gjoni 11:25-26)

Në botën e ndryshueshme ka një Zot të pandryshueshëm, fjalët e të cilit zgjasin përjetë. “Bari thahet, lulja fishket, por fjala e Perëndisë sonë mbetet përjetë.” (Isaia 40:8) dhe Ai vetë nuk ndryshon kurrë: “Jezu Krishti është i njëjtë dje, sot e përjetë.” (Hebrenjve 13:8)

Ralph Barton, një nga karikaturistët më në zë të botës, la këtë shënim kapur me gjilpërë mbi jastëk, para se të vriste veten “Kam patur pak vështirësi, shumë miq e suksese të mëdha, kam kaluar nga një grua në një tjetër, nga një shtëpi në një tjetër; kam vizituar vende të rëndësishme të kësaj bote, por jam ngopur me sajimin e të sa e sa mënyrave për të mbushur njëzet e katër orët.” (Bill Brajt, *Jesus and the Intellectual*, p.14)

Shakespeare e komentoi jetën në këtë mënyrë: “nuk është veçse përrallë, prej budallai, plot bujë e plot tërbim, e pa asnjë kuptim.” (Makbethi.167 v)

Çfarë kontrasti me fjalët e apostullit Pal të shkruara pikërisht para vdekjes kërcënuese: “Sa për mua, po derdhem si ofertë pije dhe koha e nisjes sime arriti. Luftën e mirë e luftova, e përfundova vrapimin, e ruajta besimin. Pas kësaj më pret gati kurora e drejtësisë që Perëndia, gjykatësi i drejtë, do të ma japë atë ditë dhe jo vetëm mua, por dhe gjithë atyre që presin me dashuri shfaqjen e tij.” (2 Timoteut 4:6-8)

Krishterimi i ofron njerëzimit shpresën e vërtetë.

A është krishterimi një patericë?

Çdo koleg duket sikur ka qoftë dhe një ateist në kompleksin e tij që thotë: "Krishterimi është për ngordhalaqët; ai nuk është veçse patericë."

Thënia e famshme e Karl Marksit "Feja është opium për popullin" mbetet ende pikëpamje e pranueshme për shumë njerëz. Ata që e quajnë veten e tyre të krishterë, shihen si njerëz të cilët kanë nevojë për diçka që t'i ndihmojë për të përballuar problemet e kësaj jete. Ka nga ata që përdorin alkoolin, disa të tjerë drogat, kurse disa të tjerë krishterimin për të kapërcyer këtë botë të vështirë.

Në fakt të gjithë ne kemi nevojë për një mbështetje për të ecur në këtë botë. Në njëfarë mënyrë, ne të gjithë jemi ulokë dhe në thelb gjallon dëshira për diçka që të na mbajë. Thelbi i problemit qëndron këtu: "Është, e vërtetë kjo patericë, që ne e quajmë krishterim, apo është i së njëjtës kategori si drogat, alkoli, të krijuara vetëm për të arritur një nevojë të çastit."

Ekzistojnë nevoja psikologjike si: frika e rrezikut, sëmundja dhe vdekja, të cilat mund të na shtynin të sajnim Zotin, me qëllim që të ndjeheshim të sigurtë. Por, nga ana tjetër, ka edhe nevoja të tilla psikologjike që do të na udhëhiqnin drejt mohimit të qënies së Zotit. Agnostiku apo ateisti do të mundnin fare mirë të përdornin agnosticizmin dhe ateizmin si mbështetje patericë për të shmangur përgjegjësinë ndaj kërkesave të Zotit.

Zoti i Biblës është frymëzues i frikës e i respektit kanosës për njerëzimin. Një Zot që është i gjithëfuqishëm, i drejtë, i shenjtë dhe i pastër dhe që synon të gjykojë botën për mëkatin e saj, është një figurë jashtëzakonisht hijerëndë. Kështu që është mirë të theksohet se disa e duan mbështetjen prej paterice të mohimit të Zotit me qëllim që të mund të jetojnë jetën e tyre ashtu sikurse u pëlqen, pa frikën e gjyqit.

Aldous Huxley¹ në "Synimet dhe mjetet" e shpjegon këtë kështu: "Për mua filozofia e pakuptueshmërisë në thelbin e vet ishte instrument i liberalizmit seksual e politik." (*Ends and Means*, p.270)

E vërteta e besimit kristian nuk bazohet mbi kërkesat psikologjike pro a kundër Zotit. Sigurisht se është e mundur që krishterimi të jetë shfaqur nga që njerzit kërkonin diçka ku të mbështeteshin, veçse në këtë arsyetim çështja nuk shtrohet si mund të lindte krishterimi, por si e në ç'mënyrë lindi në fakt ai.

Tani na duhet të kthehemi përsëri te çështja vendimtare e cila është Jezu Krishti. Ka nevojë njerëzimi të mbështetet te Ai, apo mund të mbështetet te dikush tjetër?

Jezusi na e bëri fare të qartë problemin: "Prandaj, ai që i dëgjon keto fjalë të mia dhe i vë në praktikë, mund të krahasohet prej meje me një njeri të zgjuar, që e ka mbështetur shtëpinë e tij mbi shkëmb. Ra shiu,

erdhi përmbytja, frynë erërat dhe u përplasën mbi shtëpi, por ajo nuk u shemb, sepse është themeluar mbi shkemb.

“Përkundrazi, ai që dëgjon këto fjalë dhe nuk i vë në praktikë, do të krahasohet me një njeri budalla, që e ka ndërtuar shtëpinë e tij mbi rërë. Më pas ra shiu, erdhi përmbytja, frynë erërat dhe u përplasën mbi atë shtëpi, ajo u shemb dhe rrënimi i saj ishte i madh.” (Mateu 7:24-27)

Problemi mund të paraqitet kështu: paterica nënkupton dy gjëra:(1) se ekziston një sëmundje a lëngim dhe (2) se të sëmurit i duhet dhënë një mjekim (ja përse ai ka nevojë për mbështetje). Ngrihen menjëherë dy çështje të tjera: çfarë është kjo sëmundje, e para dhe e dyta, a është ilaçi që ai merr, i përshtatshëm për sëmundjen?

Në krishterim, Zoti thotë se sëmundja është mëkat dhe se sëmundja është e vërtetë. Ajo nuk është një problem thjesht psikologjik dhe imagjinar që ka nevojë për një drogë fetare, si do ta parashtronte Marksii. Më saktë, ilaçi, në vend të një mbështetje fetare, është marrëdhënia jonë me Jezu Krishtin.

Rrjedhimisht, krishterimi, në një kuptim të veçantë, është patericë. Por është më shumë sesa patericë; është themel i sigurt, e vërteta e jetës.

Nëse Jezu Krishti është Zot që vdiq në kryq për mëkatet tona dhe që na aftësoi të jemi në miqësi me Zotin, Atin, nëpërmjet Tij, atëherë, ta konsiderosh Atë patericë, do të ishte njëlloj si me llampën e ndriçuar në një portollampë elektrike që thotë: “Ti je paterica ime.” Ashtu si një llampë e ndriçuar, edhe ai u krijua për të funksionuar si duhet brenda marrëdhënies personale me Perëndinë nëpërmjet Jezu Krishtit.

Si bëhet njeriu i krishterë?

Ashtu si mbretërit dhe njerëzit e fuqishëm të kohës lindin në të njëjtën mënyrë siç lind njeriu më i thjeshtë, ashtu edhe njeriu intelektual duhet të bëhet i krishterë në të njëjtën mënyrë si njeriu më i thjeshtë.

Kjo është e vërtetë për të gjithë njerëzit, në tërë hapësirën dhe kohën. Nuk ekzistojnë përjashtime. Jezusi e tha fare qartë: “Askush nuk vjen te Ati përveçse nëpërmjet meje.” (Gjoni 14:6) (Francis Schaeffer, *True Spirituality*, p.1)

Jezusi tha se për të hyrë në mbretërinë e qiellit, një njeri duhet të lindë përsëri (Gjoni 3:3). Kjo bëhet me një veprim të zemrës, duke besuar në Jezu Krishtin si Zot e Shpëtimtar. Kur u lindëm trupërisht në këtë botë, u lindëm të vdekur shpirtërisht, çka do të thotë se kemi nevojë për një lindje shpirtërore. Lindja shpirtërore përfshin dy faza.

E para është të kuptojmë se ne nuk mund ta bëjmë vetë këtë. Ne jemi të gjithë mëkatarë dhe kemi nevojë për ndihmë. Çfarë është një mëkatar?

(1)Aldous (Leonard) Huxley, 1894-1963, romancier dhe eseist anglez, (shën.i përkth.)

Mëkatar është ai që është i ndarë nga Zoti, që ka zgjedhur të shkojë rrugës së tij e që nuk mund të kthehet vetë te Zoti për shkak të mëkatit të tij.

Mëkati mund të jetë thjesht krenaria apo egoizmi ynë egocentrik. Ai është dhunimi i kritereve të drejtësisë së Zotit.

Kështu që na duhet të pranojmë se kemi nevojë për një Shpëtimtar, për dikë që do të na përmbushte gjithçka na kërkon Zoti. I vetmi njeri, që mundi ta bënte këtë ishte Jezu Krishti. Ai jetoi të vetmen jetë të pranueshme për Zotin. Ai vdiq në kryq në vendin tonë për mëkatet tona; ne nuk kemi as edhe një mundësi për t'i pëlqyer Zotit me meritat tona. Kështu që hapi i parë është të kuptojmë se të gjithë kemi mëkatuar, se kemi thyer ligjin e Perëndisë dhe se meritojmë gjykim. Bibla thotë: "Sepse paga e mëkatit është vdekja." (Romakëve 6:23)

Menjëherë sapo dikush konstaton gjendjen e vet të pashpresë dhe kupton se Jezu Krishti ofron një zgjidhje, hapi tjetër që ai duhet të bëjë është ta marrë vetë personalisht në dorë këtë zgjidhje, sepse "dhuntia e Perëndisë është jeta e përjetshme në Jezu Krishtin, Zotin tonë." (Romakëve 6:23) Kur dikush pranon Krishtin si Shpëtimtar të vetin, duke pranuar kështu dhuratën e Perëndisë, në atë çast ai lind përsëri.

Është aq e lehtë sa mund të bëhet nga një fëmijë, por është e vështirë për ne, sepse së pari na duhet të kuptojmë se nuk mund ta realizojmë këtë me forcën tonë. Jezusi tha se, për të hyrë në mbretërinë e qiellit, një njeri duhet të jetë i gatshëm të përlulë veten si fëmijë dhe se vetëm atëherë Zoti do ta pranojë atë. (Mateu 18:3)

Ç'thoni ju për veten tuaj? E keni bërë këtë? A keni lindur përsëri? Në doni ta bëni, ne ju ofrojmë këtë lutje, "Zoti Jezus, e di: që jam mëkatar kuptoj se nuk mund t'ia dal vetëm. Të falenderoj që vdiqe për mua. Pikërisht në këtë çast më mirë nga ç'e di ta bëj që të besoj Ty si Shpëtimtarin dhe Zotin tim, në emrin e Jezusit. Amen."

Por, me këtë rast duhet theksuar se nuk është thjeshtë të shqiptuarit e fjalëve të mësipërme që sjell ndryshimin tuaj. Nuk ka asgjë magjike në to, kushdo mund të përsërisë një fjali. Është qëndrimi i zemrës suaj si dhe dëshira juaj e fortë në lutjen dhe besimin te Krishti ajo që t'ju sjellë ndryshimin.

■ BESIM NË PRAKTIKË

Përse duhet të bëhem i krishterë? — Hipokritët më të mëdhenj gjenden në kishë.

Një nga shfajësimet që përdorin njerzit në mospranimin e tyre për të përqaftuar krishterimin është ai që ka të bëjë me hipokritët në kishë, si dikur dhe në kohën tonë. Njerëzve u pëlqen të theksojnë krimet e kryera në emër të Krishtit si inkuizicioni spanjoll: djegia e të ashtuquajturave shtriga në mesjetë dhe të tjera fakte të tmerrshme. Pastaj vijojnë shembujt e predikuesve, dhjakëve apo udhëheqësve të kishës së kohës sonë që janë kapur në alkolizëm, tradhti bashkëshortore ose ndonjë marrëdhënie tjetër ndaj asaj që predikonin dhe që pretendonin se besonin. Kjo lloj sjelljeje ka bërë që shumë njerëz të thonë: “Nëse kjo është ajo që thotë në tërësinë e vet krishterimi, atëherë unë nuk dua të kem të bëj fare me të.” Duhet pranuar se ka patur vërtetë hipokrizi në kishë. Edhe sot ne nuk jemi të çliruar nga njerëzit hipokritë në të. Hipokriti është një aktor; dikush që vë një fytyrë të gënjeshtërt, që thotë një gjë dhe bën tjetër. Megjithatë, pse kisha ka hipokritë, nuk do të thotë se të gjithë të krishterët janë hipokritë. Kundër çdo shembulli hipokrizie në kishë, mund të tregohet edhe një shembull tjetër me njerëz që jetojnë në përputhje me mësimin e Jezu Krishtit. Është me rëndësi të mos e ngatërrojmë hipokrizinë me mëkatin. Të gjithë të krishterët janë mëkatarë, por jo të gjithë të krishterët janë hipokritë. Është koncept i gabuar ai që thotë se një i krishterë është ai njeri që pretendon se nuk mëkaton. E vërteta është se që ta pretendosh krishterë, duhet të pranosh se je mëkatar. (1 Gjonit 1:5; 2:2)

Të gjithë besimtarët, duke përfshirë këtu edhe klerikët, janë krijesa njerëzore të gabueshme që priren ndaj mëkateve të ndryshme. Pse një njeri nuk është i përsosur, kjo nuk do të thotë se ai është model. Dallimi midis tyre është i rëndësishëm. Mospërsosmëria e besimtarëve nuk e zhvlerëson të vërtetën.

Jezu Krishti tha shumë fjalë të ashpra për njerëzit që bënin mëkatin e hipokrizisë, veçanërisht për udhëheqësit fetarë të kohës së tij. Ai i qortoi ata me fjalë krejt të qarta: “Mjerë ju, o skribë dhe farisenj hipokritë. Sepse përshkoni detin dhe tokën për të bërë prozelitë dhe, kur ndokush bëhet i tillë, e bëni atë bir të ferrit dhe dy herë më të keq se ju.” (Mateu 23:15). Njerëzit fare lehtë mund të bëhen pastorë ose priftërinj për arsye të gabuara ose mund të kompromentojnë parimet e leximit. Kur veprojnë në këtë mënyrë, ata sigurisht gabojnë dhe Bibla i dënon veprimet e këtij lloji.

Krishterimi nuk rrëzohet e as nuk qëndron i kushtëzuar nga mënyra se si kanë vepruar të krishterët gjatë tërë historisë apo dhe vazhdojnë të

veprojnë edhe në ditët tona. Krishterimi qëndron apo rrëzohet tek Jezusi. Jezusi nuk ishte hipokrit. Ai jetoi pandërprerë me atë që i mësonte të tjerëve dhe, aty nga fundi i jetës, sfidoi ata të cilët kishin jetuar ditë e natë me të për më shumë se tre vjet që t'i gjenin edhe shenjën më të vogël të hipokrizisë. Dishepujt e tij heshtën, sepse nuk gjetën asgjë. Derisa krishterimi mbështetet mbi Jezusin, nuk është aspak e dobishme ta zhvlerësosh besimin e krishterë, duke theksuar gjërat e tmerrshme që u bënë në emër të krishterimit.

Ateisti nuk mund të shkarkohet nga përgjegjësia për të besuar vetëm sepse për të është e mundur të tregojë ata që pretendojnë të jenë çfarë në të vërtetë nuk janë. Të krishterët hipokritë nuk mund të shfaqësohen duke arsyetuar mosqënien të përsosur, për shkak të pasojave të tmerrshme që mbart hipokrizia.

Le të marrim një shembull për këtë çështje. Të themi se presidenti i një ndërmarrjeje të madhe veturash u reklamon e u tregon gjithnjë miqve të tij se kushdo duhet ta kuptojë se vetura e ndërmarrjes së tij është më e mira në tërë vendin dhe e vetmja të cilën do ta donim ta drejtonim. Disa revista ilustruese të veturave dhe të grupe blerësish i mbështesin disa nga pretendimet e këtij presidenti. Por, një ditë këtë njeri e shihni duke ngarë një nga veturat më të shquara të modeleve rivale. (Ndoshta i pëlqen më shumë ngjyra) !

Krejt i habitur ju mendoni “Eh, çfarë hipokriti. Po të ishte e vërtetë se besonte në të gjitha ato që na thoshte për veturën e tij, të cilën nuk ka asnjë dyshim se e njihte më e mirë, përse atëherë nuk nget pikërisht atë?” Kjo sigurisht që është e vërtetë megjithatë, të qenit hipokrit nuk mund të zhvlerësojë pretendimin se vetura që ai reklamon të jetë vetura më e mirë në tërë vendin. Kështu ngjet edhe me krishterimin. Njerzit mund të pretendojnë se ai është i vërtetë e, megjithatë, jetojnë në kundërshtim me pretendimin e tyre. Një gjë e tillë nuk do të thotë aspak se krishterimi nuk është i vërtetë.

Çfarë mund të thuhet për ata që nuk e dëgjuan kurrë ungjillin?

Mund të mos ketë shumë rëndësi se ku shkojmë e për çfarë flasim, por rëndësi ka pyetja e mësipërme do të na shoqërojë kudo dhe kurdoherë. Në shumë raste një pyetje e tillë bëhet për të çliruar atë që pyet nga përgjegjësia personale para Zotit.

Në këtë rast duhet theksuar se përgjigjja që mund t'i jepet kësaj pyetjeje nuk përcakton nëse krishterimi është apo jo i vërtetë. Kjo çështje është zgjidhur tashmë me Jezu Krishtin, me ringjalljen e tij nga vdekja. Çështja e autoritetit është zgjidhur njëherë e përgjithmonë dhe problemi i atyre që nuk kanë dëgjuar, ka mbetur thjeshtë çështje interpretimi. Mënyra më

e mirë për t'u marrë me këtë çështje është të shpallësh disa të vërteta që Shkrimet e shenjta tregojnë në mënyrë të thjeshtë. Bibla është shumë e kuptueshme kur thotë se askush nuk mund të arrijë te Zoti veçse nëpërmjet Jezu Krishtit. Jezu Krishti tha: "Askush nuk vjen te Ati veçse nëpërmjet meje." (Gjoni 14:6) E vetmja bazë për faljen e mëkatit dhe jeta e amshueshme është rruga e bërë nga Jezusi. Shumë njerëz mendojnë se kjo nënkupton se ata që nuk kishin dëgjuar kurrë për Jezusin, do të dënohen menjëherë. Por ne nuk mendojmë kështu.

Edhe pse Shkrimet nuk na thonë hapur se dikush që nuk ka dëgjuar ndonjëherë për Jezusin mund të shpëtohet, ne besojmë se ky konkluzion mund të nxirret prej tyre. Ne besojmë se çdo njeri do të ketë një mundësi për t'u penduar dhe se Zoti nuk do ta përjashtojë askënd nga që ka lindur në një vend a kohë të keqe.

Jezusi tha: "Në qoftë se dikush do të bëjë vullnetin e tij, do ta njohë nëse kjo doktrinë vjen nga Perëndia apo që unë flas nga vetja ime." (Gjoni 7:17) Bibla, gjithashtu, thotë se askush nuk ka shfajësim: "Meqënëse ajo që mund të njihet nga Perëndia është bërë e dukshme në ta, sepse Perëndia ua ka shfaqur atyre. Në fakt cilësitë e tij të padukshme, fuqia e tij e përjetshme dhe hyjnia e tij, duke qenë të dukshme nëpërmjet veprave të tij që nga krijimi i botës, shihen qartë, me qëllim që ata të jenë pa shfajësim." (Romakëve 1:19–20)

Është e vërtetë se gjithë njerëzimi mund të thotë se një krijues ekziston, sepse këtë e provon vetë krijesa e tij. Kjo dëshmi është botërore. E megjithatë, edhe pse njerëzit kanë mjaft informacion për ekzistencën e Zotit, ata, në mënyrë krejt të vullnetshme, tregohen të paditur sepse zemrat e tyre janë plot ligësi.

Bibla na mëson se një njeri që nuk beson është "duke mbytur të vërtetën në padrejtësi." (Romakëve 1:18) Për më tepër, Shkrimet na rrëfejnë se njeriu nuk po rend pas Zotit, por në të vërtetë është duke iu larguar atij. "Nuk ka asnjë që kërkon Zotin, as edhe një." (Romakëve 3:11). Pra, rrjedh se nuk është Zoti Ai që nuk do t'ia japë Fjalën e Tij atij që e kërkon të vërtetën me dëshpërim.

Gjithashtu, ne dime se është vullneti i Zotit që "ndonjë edhe të humbasë, por që të gjithë të vijnë në pendim." (2 Pjetër 3:9). Kjo tregon se Zoti kujdeset për ata që nuk kanë dëgjuar Ungjillin. Ai e ka treguar këtë me dërgimin e Birit të tij që të vdesë në vend të tyre. "Kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne." (Romakëve 5:8)

Bibla na mëson se Zoti ka si qëllim ta gjykojë botën ndershmërisht dhe në mënyrë të drejtë. "Sepse Ai ka caktuar një ditë në të cilën do të gjykojë me drejtësi botën." (Veprat 17:31). Kjo do të thotë, kur të gjitha faktet të mbledhen, gjykimi i Zotit do të provohet dhe se askush nuk do të mundë ta fajësojë Atë për padrejtësi. Madje, edhe pse nuk dimë se si ai do të

merret në mënyrë të veçantë me këta njerëz, e dime se gjykimi i tij do të jetë i drejtë. Pikërisht një fakt i tillë do të kënaqte këdo që pyet se si do të veprojë Zoti me ata që nuk kanë dëgjuar kurrë për Jezu Krishtin.

Vetë Bibla i dëshmon faktit se nga çdo popull mbi tokë do të gjenden njerëz të cilët do të dëgjojnë dhe do t'i përgjigjen Atij "Sepse Ti u there dhe me gjakun tënd na bleve te Perëndia nga çdo fis, gjuhë, popull dhe komb." (Zbulesa 5:9)

Bibla na jep shembullin e një njeriu i cili fare mirë mund të shëmbëllejë me shumë njerëz sot. Ai quhej Kornel dhe ishte fetar e i lutej Perëndisë pa pushim. Ai nuk kishte dëgjuar ndonjëherë për Jezu Krishtin, por Zotit i kërkonte vazhdimisht t'ia zbulonte veten. Zoti iu përgjigj lutjes së Kornelit duke i dërguar apostullin Pjetër për t'i dhënë tërë historinë e Jezusit. Kur Pjetri i predikoi, Korneli i besoi Krishtit, duke e pranuar si Shpëtimtar. Ky shembull vërteton se kushdo që dëshiron të njohë Zotin sinqerisht, do të dëgjojë për Jezu Krishtin.

Sot ka njerëz, si Korneli, që bëjnë të njëjtën lutje për ta njohur Zotin e vërtetë të gjallë dhe, nuk ka asnjë dyshim se do ta njohin, kudo që të jenë, Simon Pjetri tha: "Në të vërtetë unë po e kuptoj se Perëndia është i paanshëm, por në çdo komb, ai që ka frikë prej Tij dhe që vepron drejtësisht, është i pranuar nga Ai." (Veprat 10:34-35)

Shkrimet na japin shembuj të njerëzve të tjerë që u pranuan nga Perëndia, edhe pse njohuria e tyre për Të ishte e kufizuar. Prostituta, Rahaba, e njihje shumë pak Zotin, por Bibla na e rrëfen atë si grua besimtare dhe punët e saj më pas u lavdëruan. (Jozueu 2:9, Hebrenjve 11:31).

Naamani, gjeneral sirian, bëri paqe me Zotin sepse ushtroi besim, edhe pse jetoi në mes të një kulture pagane. (2 Mbretërve 5:15, 19). Profeti Jona, u dërgua në Ninave, një shoqëri pagane, anëtarët e së cilës u penduan të gjithë nën ndikimin e predikimit të tij. (Jona 3:5)

Askush nuk do të dënohet pse nuk ka dëgjuar për Jezu Krishtin. Do të dënohet ai që shkel normën morale të tij. "Në fakt ata që kanë mëkatuar pa Ligjin, do të humbasin, gjithashtu, pa Ligj; të gjithë ata që kanë mëkatuar nën Ligjin, do të humbasin, gjithashtu, pa Ligj dhe të gjithë ata që kanë mëkatuar nën Ligjin, do të gjykojnë sipas Ligjit, sepse jo ata që e dëgjojnë Ligjin janë të drejtë para Perëndisë, por ata që e zbatojnë Ligjin do të shfajësohen. Sepse johebrenjtë, që nuk e kanë Ligjin, nga natyra bëjnë punët e Ligjit, ata, megjithëse s'kanë Ligjin, janë ligj për vetveten; këta tregojnë veprën e Ligjit të shkruar në zemrat e tyre për dëshminë që jep ndërgjegjja e tyre; sepse mendimet e tyre shfajësojnë ose edhe akuzojnë njëri-tjetrin ditën kur Perëndia do të gjykojë të fshehtat e njerëzve me anë të Jezu Krishtit, sipas ungjillit tim." (Romakëve 2:12-16)

Bazuar mbi shembujt e mësipërm të Shkrimit kuptohet se Zoti do ta

gjykojë drejtësisht tërë njerëzimin dhe askush nuk mund të ankohet se pati një gjykim të padrejtë. Kështu që njerëzit, që bëjnë këtë pyetje, duhet të jenë të kujdesshëm që të mos e marrin këtë çështje si një shfaqësim për të mos shkuar te Krishti.

Ajo që ju mendoni se mund ose nuk mund të ndodhë me dikë tjetër Ditën e Gjyqit, nuk ndihmon për t'u çliruar nga përgjegjësia. Edhe pse ne nuk mund t'i përgjigjeshim pyetjes në mënyrë të tillë që të mund të kënaqim këdo, ka disa gjëra të cilat Bibla na i ka bërë më se të qarta.

Dikush tha kështu dikur: "Shumë gjëra në Bibël nuk mund t'i kuptoj; shumë gjëra në Bibël unë mendoj se i kuptoj; por ka shumë gjëra në Bibël që nuk mund t'i keqkuptoj." (Anonim)

Do t'i pranojë Zoti njerëzit shumë fetarë dhe të çiltër edhe nëse nuk janë të krishterë?

Dikush mund të jetë i sinqertë, por mund të jetë në mënyrë të gabuar. Bibla thotë se ka një rrugë që njeriut i duket e drejtë, por që në fund të nxjerr në udhët e vdekjes. (Fjalët e urta 16:25)

Çdo vit ka shumë raste kur dikush, duke bërë shaka, i drejton dikujt revolverin, duke besuar sinqerisht se është bosh. Revolveri shpërthen dhe tjetri vdes ndërkohë që ai që tërhoqi këmbëzën thotë: "Nuk e dija se ishte plot." Nuk ka asnjë dyshim që ai njeri ka qenë qind për qind i sinqertë kur pohoi se nuk donte aspak ta dëmtonte tjetrin por ai sinqerisht thotë diçka që nuk ishte e vërtetë.

Sinqeriteti nuk është i mjaftueshëm nëse objekti i besimit nuk është i vërtetë. Gjithë sinqeriteti i kësaj bote nuk do të mjaftonte për ta kthyer përsëri në jetë atë që shkoi për shkak të atij revolveri.

Apostulli Pal na mëson se vetëm praktikimi i fesë nuk shfaqëson askënd, përkundrazi komplikon fajin e njeriut. Duke analizuar besimin e paganit, Pali thekson se ai është shpërfytyrim i së vërtetës. Ai thotë: "Ata e ndërruan Perëndinë e vërtetë me idhuj." (Romakëve 1:25)

Lavdia e Zotit është hequr mënjanë dhe është zëvendësuar me lavdinë e krijesës. Feja e tyre është idhujtari, dhe adhurimi i idhujve është dhunim i dinjitetit të Zotit. Për këtë veprim Zoti gjithmonë ka ndërjerë neveri.

"Nuk do të kesh perëndi tjetër para meje. Nuk do të bësh skulpturë ose shëmbëlltyrë të asgjëje që ndodhet aty në qiejt, këtu poshtë në tokë, ose në ujërat nën tokë. Nuk do të përulesh para tyre dhe as do t'u shërbesh, sepse unë, Zoti, Perëndia yt, jam një Perëndi xheloz që dënon." (Eksodi 20:3-5). Kështu, pra, një njeri fetar, nuk përfiton nëse adhuron një perëndi të gënjeshtërt, pavarësisht sa i sinqertë është. Nëse dikush dëshiron të shkojë në kinema dhe shikon se bileta bën katërmbëdhjetë lekë, nuk ka fare rëndësi se në xhep ka 3. 90 lekë ose njëzet qindarka, xhëndësi ka që nuk i mjafton. Njëlloj ndodh edhe me atë që beson në gënjeshtërën, s'ka

rëndësi se sa i sinqertë është, sepse ai mbetet ende borxhli kundrejt asaj që Zoti u kërkon njerëzve me qëllim që të mund të arrijnë deri tek Ai.

Zoti vë kushtin dhe pranon vetëm ata që vijnë tek Ai nëpërmjet Jezu Krishtit. “Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtojmë.” (Veprat 4:12)

Në qoftë se krishterimi qenka kaq i rëndësishëm e i shquar, përse ka kaq pak të krishterë?

Të krishterët janë dhe kanë qenë gjithmonë në minoritet. Shumica e njerëzve sot nuk e besojnë Krishtin si Shpëtimtarin e tyre. Kjo, sidoqoftë, është shtu siç e kishte parashikuar vetë Jezusi, kur tha: “Përkundrazi, sa më e ngushtë është dera dhe sa më e vështirë është udha që të çon në jetë! Dhe sa pak janë ata që e bëjnë!” (Mateu 7:14). Kjo ka qenë gjithmonë e vërtetë në rrjedhën e historisë. Ka disa arsye që një pjesë e madhe e njerëzve e hedhin poshtë Jezusin si Shpëtimtarin e vet.

Një arsye që njerëzit nuk bëhen të krishterë është padituria. Kjo padituri lidhet me faktin se ka një Zot apo dhe një Jezu Krisht, por më shumë me faktet që argumentojnë besimin e krishterë. Shpeshherë kjo padituri është e vetëimponuar. Disa njerëz as marrin në shqyrtim ato që na thotë Krishti, ndërkohë që të tjerë nuk pranojnë ta besojnë fare.

Disa të tjerë pretendojnë se kanë probleme intelektuale me besimin e krishterë, por në të vërtetë ato nuk janë veçse shfajësime intelektuale dhe emocionale. Ne jemi të vetëdijshëm se shumë njerëz të cilët, pasi janë ballafaquar me të vërtetat e krishterimit, kanë pranuar menjëherë se e dinë mirë që krishterimi ekziston, megjithatë, refuzojnë të bëhen të krishterë.

Pra, ky nuk është problem i të menduarit, por i vullnetit; jo se ata nuk mund të bëhen të krishterë, por se nuk duan të bëhen të krishterë. Bibla na mëson se njerëzimi përpiqet ta shtypë të vërtetën. (Romakëve 1:18). Njerëzit janë të paditur për aftësitë e Jezusit, sepse u pëlqen të jenë kështu.

Një arsye tjetër është thjeshtësia e Ungjillit. Është kaq e thjeshtë të bëhesh i krishterë, sa që edhe një fëmijë ia arrin. Që të futesh në mbretërinë e Qiellit, na mëson Jezusi, duhet të bëhesh si fëmijët. (Mateu 18:3). Në besim të thjeshtë duhet ta vëmë besën tonë në Krishtin, qofshin profesorë universiteti, apo njerëz që nuk kanë kryer shkollën e mesme.

Apostulli Pal, për thjeshtësinë e Ungjillit, tha: “Shikoni në fakt thirrjen tuaj, vëllezër, sepse ndër ju ka jo shumë të ditur sipas mishit, jo shumë të fuqishëm, jo shumë fisnikë, por Perëndia ka zgjedhur gjërat e marra të botës për të turpëruar të urtët, por Perëndia ka zgjedhur gjërat e dobta të botës për të turpëruar të fortët... që asnjë mish të mos mburret para tij.” (1 Korintasve 1:26:29)

Pali thoshte, sikurse edhe Jezusi, se të krishterët kurrë nuk do të jenë shumicë dhe se pak njerëz të shquar do ta besojnë Jezusin. Megjithatë kanë qenë disa të tillë.

Por njerëzit nuk bëhen të krishterë për shkak të idesë së gabuar që ata kanë për krishterimin. Shumë besojnë se krishterimi është një kompleks urdhrash që thotë: “Mos bëj këtë e mos bëj atë.” Kështu krijohet mendimi se, kur të besoni në Jezusin, do t’i nënshtroheni jetës së mërzitshme, kufizimeve dhe lodhjes.

Derisa askush nuk do të jetojë në këtë mënyrë, ata e hedhin poshtë krishterimin, si diçka ku nuk duan ta besojnë jetën e tyre. Është fakt i hidhur që disa të krishterë i japin botës përshtypjen se feja e tyre mbështetet vetëm në një grup urdhrash mohuese. Asgjë, me këtë rast, nuk mund të jetë më larg së vërtetës.

Kur dikush i beson Jezusit si Shpëtimtar, ai bëhet vërtet i lirë. Jezusi tha: “Pra, nëse Biri do t’ju bëjë të lirë, do të jeni me të vërtetë të lirë.” (Gjoni 8:36). Jezusi punoi për t’çliruar burrat dhe gratë nga skllavëria, me qëllim që ata të bëhen pikërisht njerëzit që Ai do të donte kaq shumë të ishin.

Si besimtarë ne jemi të lirë të bëjmë çfarë të duam dhe çfarë nuk duam. Jeta e krishterë nuk ka asgjë të mërzitshme, sepse në të gjendet gëzimi dhe ngrohtësia nëpërmjet njohjes së Zotit të gjallë dhe në përjetimin e shumë gjërave të mira që vetë Perëndia ka rezervuar për ne. “Gjeje kënaqësinë tënde në Zotin dhe Ai do të plotësojë dëshirat e zemrës sate.” (Psalmi 37:4)

Disa njerëz nuk bëhen të krishterë për shkak të ndjenjës së fajit. Ata kanë bërë një jetë plot veprime të dënueshme dhe krime, duke mos besuar se mund të falen nga Zoti e se do të mund të nisin një jetë të re. Por Bibla na mëson qartë se, kushdo që kërkon Zotin dhe kërkon t’i falen mëkatet, do të falet.

Nuk ka mëkat më të madh përveç mëkatit të mosbesimit që të ndalojë dikë të shkojë në Qiell. Nëse një njeri nuk pranon parakushtin që vë Zoti për faljen e mëkatit, besimin te Jezu Krishti, atëherë për të nuk ka as edhe një shpresë më; Jezusi tha: “...dhe atë që vjen tek unë, unë nuk do ta nxjerr jashtë kurrë.” (Gjoni 6:37)

Bibla thotë: “Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e Tij të vetëm që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.” (Gjoni 3:16). Ne jemi të përfshirë në këtë “kushdo”. Nëse shkoni te Jezusi, ai ju premtton t’ju falë mëkatet dhe t’ju lërë të nisni sërish jetën me një biografi të pastër, pavarësisht sesa mëkatar keni qenë.

Një arsye tjetër përse disa nuk e pranojnë Jezusin është ndonjë mëkat i veçantë në jetën e tyre. Ata mendojnë se, po të bëhen besimtarë, do t’u duhet të ndërpresin mëkatin, të cilin nuk dëshirojnë ta largojnë, Jezusi

tha: “Tani gjykimi është ky: Drita erdhi në këtë botë, por njerëzit donin errësirën më tepër se dritën, sepse veprat e tyre ishin të mbrapshta.” (Gjoni 3:19)

Shumë njerëz e pëlqejnë mëkatin deri në atë pikë sa humbasin edhe rastin për të arritur në Qiell. Për t’u bërë i krishterë, duhet të pendohesh (të ndërrosh zemrën dhe mendjen) për mëkatet që ke bërë. Mirëpo shumë njerëz nuk janë të gatshëm ta bëjnë atë, edhe pse Krishti thotë; “Por nëse ju nuk pendoheni, do të vdisni të gjithë në të njëjtën mënyrë.” (Luka 13:3)

Përveç kësaj, njerëzit nuk e pranojnë Jezusin për shkak të egoizmit. Dikush ka thënë, dhe ne besojmë se e ka thënë mirë, se krishterimi është feja më e lehtë për t’u besuar në këtë botë, por, në të njëjtën kohë, është më e vështira.

Krishterimi është më i lehti, sepse Perëndia ka bërë për ne çdo gjë që duhet bërë saqë është e pamundur të shtosh diçka në veprën e Krishtit. Por është edhe më i vështiri sepse do të na duhet t’i rrëfejme vetes dhe Perëndisë, se nuk mund të bëjmë asgjë vetë për të shpëtuar.

Krenaria nuk na lejon të bëjmë një pohim të tillë, sepse duam që shpëtimin ta fitojmë sipas mënyrës sonë. Natyra njerëzore dëshiron që t’i diktojnë vetë kushtet, por Zoti do të na pranojë vetëm sipas kushteve të Tij. Ky fakt bëhet shkak që njerëzit të rrinë larg mbretërisë së Qiellit.

Ka shumë arsye që i bëjnë njerëzit të mos e pranojnë Krishtin, por asnjëra nuk është e vërtetë.

Është e arsyeshme ta besosh krishterimin apo është thjesht çështje dëshire?

James Harvey Johnson i Klubit të dijetarëve e shpjegon kështu këtë çështje:

“Pikëpamjet fetare janë kundër gjykimit të shëndoshë. Nuk ekzistojnë fare as engjëj, djaj, qiej, ferr, shpirtra, shtriga e as mrekulli. Këto ide besëtytni janë kultivuar me qëllim që njerëzit, që gënjehen lehtë, të besojnë që, duke i paguar para priftërinjve, të jenë të privilegjuar ndonjëri zotave. Nuk ka asgjë të mbinatyrshme, asgjë në kundërshtim me ligjin natyror.” (*Religion Is a Gigantic Fraud*)

Shpesh besimtari akuzohet për “vrasjen e truve të tij” sepse beson në frymëzimin e Biblës, mrekullitë dhe ringjalljen e Jezu Krishtit. Kështu që njerëzit besojnë se krishterimi bazohet në paditurinë dhe se besimi është diçka e verbër dhe aspak e mençur.

Në të vërtetë është e kundërta. Besimi i krishterë është besim i mençur, që nuk ka të bëjë aspak me veprimin e nxituar, i cili nuk lidhet me realitetin. Bibla i inkurajon të dy, besimtarin dhe ateistin, që të mendojnë mirë, kur marrin në analizë krishterimin.

Jezusi tha: “Duaje Zotin, Perëndinë tënde me gjithë zemrën tënde, me

gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde." (Mateu 22:37) Apostulli Pal i tha Timoteut: "E di se kujt i kam besuar." (2 Timoteut 1:12), kurse një grupi besimtarësh në Selanik i tha: "Provoni të gjitha, mbani të mirën." (1 Selanikasve 5:21)

Ungjilltari Gjon, paralajmëroi njerëzit duke thënë: "Vini në provë shpirtat për të provuar në janë nga Perëndia" (1Gjoni 4:1) Kjo përfshin futjen e mendjes në punë gjërësisht.

Thëniet e mëposhtme tregojnë nevojën e përdorimit të mendjes suaj në lidhje me besimin e krishterë.

"Dhe Jezusi, duke parë se ai ishte përgjigjur me mend, i tha: 'Ti nuk je larg nga mbretëria e Perëndisë.' " (Marku 12:34)

"Jezusi bëri edhe shumë shenja të tjera në praninë e dishepujve të tij, të cilat nuk janë shkruar në këtë libër. Por këto gjëra janë shkruar që ju të besoni se Jezusi është Mesia, Biri i Perëndisë dhe që, duke besuar, ta keni jetën në emër të tij." (Gjoni 20:30–31)

"Atyre, pasi kishte vuajtur, iu paraqiti i gjallë me shumë prova bindëse, duke u parë nga ata për dyzet ditë dhe duke folur për gjërat e mbretërisë së Perëndisë." (Veprat 1:3)

"Dhe për këtë lutem që dashuria të teprojë gjithnjë e më shumë në njohuri e në çdo dallim, që të dalloni gjërat më të mira dhe të mund të jeni të pastër dhe të panjollë për ditën e Krishtit." (Filipianëve 1:9, 10).

"Që Perëndia i Zotit tonë Jezu Krisht, Ati i lavdisë, t'ju japë juve Frymën e diturisë e të zbulesës në njohurinë e ti, dhe t'u ndriçojë sytë e mendjes suaj, që të dini cila është shpresa e thirrjes së tij dhe cilat janë pasuritë e lavdisë së trashëgimisë së tij në shenjtoret." (Efesianëve 1:17, 18)

"Po ju flas si të mençur, gjykojeni ju atë që them." (1 Korintasve 10:15)

Nuk ka as edhe një rresht të Shkrimit që të thotë se besimi është i barabartë me marrëzinë, përkundrazi. Në të Dhjetë Urdhërimet nuk do të gjejmë kurrë fjalët "Ti nuk duhet të mendosh!".

Në Dhiatën e Vjetër Zoti tregoi nderim për pasionin intelektual të njeriut. Ai kreu një mrekulli nëpërmjet Moisiut dhe Aaronit për t'i vërtetuar faraonit misionin e tyre hyjnor. (Eksodi 7:9). Zoti u tha izraelitëve të mos përfillnin asnjë profet që do t'u jepte parashikime të gënjeshtërtë. (Ligji i Përtërirë 18:20)

Ai i nxiti idhujt të provonin se ishin zota. "Paraqitini çështjet tuaja, thotë Zoti, parashtroni arsyetimet tuaja... Na njoftoni ç'ka për të ndodhur në të ardhmen, dhe kështu do të mësojmë se jeni perëndi; po na bëni të mirë apo të keqë në mënyrë që të mbetemi të habitur duke i parë bashkë." (Isaia 41:21 | 23).

Dhe, megjë idhujt nuk ia dolën, Zoti u tha: "Ja, ju jeni një hiç dhe vepra juaj nuk vlen asgjë; ai që ju zgjedh, bën një gjë të neveritshme." (Isaia 41:24)

Shumë të krishterë nuk dinë se përse besojnë në Jezusin edhe pse Shkrimet e bëjnë të qartë këtë. “Jini gjithmonë gati për t’iu përgjigjur në ndrojtjen tuaj kujtdo që ju kërkon shpjegime për shpresën që është tek ju” (1 Pjetrit 3:15)

Ky fakt nuk e zhverëson besimin e krishterë; ai vetëm sa tregon se ka të krishterë të paditur. Sidoqë disa të krishterë nuk janë thelluar në çështjen se përse besojnë, kjo dukuri nuk përbën problem për të vërtetën e krishterimit. Çështja kryesore mbetet Jezu Krishti dhe jo padituria e ndokujt, që e paraqet veten si besimtar.

Ne kemi parë se Bibla na këshillon të përdorim mendjen për të marrë vendim për Jezu Krishtin. Krishterimi është i arsyeshëm; ai është i logjikshëm por, nuk mund të vish te Jezusi vetëm me mendje të kthjellët. Duhet të ushtrosh besim, por besimi që bazohet mbi fakte e argumente dhe jo mbi shpresën e gënjeshtërt.

Sot njerzit e pikturojnë besimin e krishterë si një kërcim në errësirë, kurse në të vërtetë është hap drejt dritës. Apostulli Pal, ndërkohë që mbronte besimin e krishterë para një mbreti ateist, tha: “Sepse, mbreti të cilit unë po i flas lirisht, është i mirëinformuar për këto gjëra, sepse unë jam i bindur se asnjë nga këto gjëra nuk është e panjohur për të, sepse e gjithë kjo nuk është bërë në fshehtësi.” (Veprat 26:26)

Faktet për Jezusin njiheshin mirë nga mbreti si prej njerëzisë e tjerë të asaj kohe; ato fakte mund të peshoheshin e të vlerësoheshin nga kushdo ë do të dëshironte t’i merrte në analizë vlerën dhe vërtetësinë e tyre. Mrekullitë e Jezusit janë para syve të njerëzve dhe, nisur pikërisht nga ky fakt, të krishterët e parë nxitën njerëzimin për të parë vetë “në ishte vërtet ashtu”.

Ata nuk i dekurajuan njerëzit që u treguan dyshues në fjalët “Besoni!”, përkundrazi, ata ushqyen kureshtjen e njerëzve për të vërtetuar bazat e besimit të krishterë. (Veprat 17:11)

Besimi i krishterë nuk është vetëm i hapur për verifikim, por edhe subjekt për falsifikim. Jo i krishteri nxitet të përdorë çdo gjë për të verifikuar pretendimet e Krishtit. Në qoftë se ndonjë dëshmi do të nxirrej në shesh, p. sh. përgënjeshtrimi i ringjalljes së Jezusit, atëherë besimi i krishterë do të shëmbej.

Janë të shumtë ata që janë përpjekur ta bëjnë një gjë të tillë, si juristi Frank Morrison dhe gjenerali Lew Wallace¹, autori i filmit “Ben Hur”, të cilët në fund, u kthyen në krishterim. Përpjekja për të hedhur poshtë besimin e krishterë ka qenë shpesh çështje e ditës, por kurrë nuk ia ka përfunduar me sukses. Po të ishte thjesht “fe e verbër” ajo që një i krishterë beson, përse atëherë kaq shumë burra e gra bëhen besimtarë pasi kanë ushtruar aftësitë e tyre mendore? Besimi i krishterë është ende duke i qëndruar provës, sepse bazohet në të vërtetën. Jezusi tha: “Unë jam e

vërteta. " (Gjoni 14:6)

Vendimi dhe zgjedhja për t'u bërë i krishterë duhet të vijnë pasi të e vërteta. Vlerësimi i krishterimit duhet bërë para se të merret vendimi për t'u bërë i krishterë. Pra, njeriu duhet të kuptojë çfarë po bën, para se të vendosë për t'u bërë i krishterë. Ata që inkurajojnë kthimin në krishterim bazuar thjesht mbi thirrjen emocionale dhe si rrjedhim i një procesi manipulues, nuk janë bashkë.

Në fund të fundit ne jemi të sigurt se do të duhet më shumë besim për të dyshuar në qoftë se dikush do t'i ketë kushtuar një vëmendje të plotë fakteve. Dëshmia flet me zë të lartë dhe hapur për këdo që do të jetë i ndershëm intelektualisht ndaj problemit se kush ishte në të vërtetë Jezu Krishti. Nëse dikush do t'i kuptohet ndershmerisht këtij problemi, atëherë do të jetë pikërisht ajo "feja e verbër" që do të hedhe poshtë pretendimet e vërtetuara nga "shumë prova bindëse." (Veprat 1:3)

A merrn parasysh punët e mia të mira? A do të më pranojë Zoti nëse kam bërë një jetë të rregullt?

Në fillim të viteve gjashtëdhjetë u kompozua një këngë nga Frank Wilson dhe grupi "*The Cavaliers*" titulluar "*The last kiss*". Kënga bën fjalë për një çift të fejuarish që pësojnë një aksident automobilistik. Vajza vdes në krahët e djalit, i cili e vajton vdekjen e saj duke kënduar: "Oh, po ku pra, ku do të shkojë tani vogëlushja ime?! / Zoti ma mori dhe ma çoi larg meje, / Në qiell ajo tani prehet, / Po dhe më i mirë do të bëhem / Që vogëlushen time të mund të shoh, / Kur këtë botë do ta lë edhe unë."

Kjo këngë jep me pak fjalë qëllimin e shumë njerëzve në këtë botë. Këta njerëz mendojnë se, nëse bëjnë një jetë të mirë dhe nëse punët e mira që ata bëjnë, peshojnë më shumë sesa të këqijat, atëherë me siguri e kanë fituar rrugën e tyre drejt qiellit.

Fatqeqësisht, Bibla nuk lejon askënd të fitojë rrugën e vet drejt qiellit. Shkrimet na mësojnë se punët e mira nuk kanë të bëjnë fare me gjendjen tonë juridike të drejtë para Zotit. Kjo marrëdhënie nuk mund ta fitojmë sepse Zoti ka bërë çdo gjë për ne.

"Ai na shpëtoi jo me anë të veprave të drejta që ne bëmë, por sipas mëshirës së tij." (Titit 3:6)

"Ju në fakt jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit dhe kjo nuk vjen nga ju, por është dhurata e Perëndisë; jo nga veprat, që të mos mburret askush." (Efesianëve 2:8, 9)

"E pa besim është e pamundur t'i pëlqesh Atij." (Hebrenjve 11:6)

"Kjo është vepra e Perëndisë: të besoni në atë që Ai ka dërguar." (Gjoni 6:29)

Nëse shpëtimi ynë i përjetshëm do të vinte mbi bazën e veprave, pra, ne do ta fitonim atë me sukses, atëherë Perëndia do të ishte borxhliu ynë.

Ai do të na detyrohej në diçka. (Romakëve 4:1 | 3) Bibla na mëson se Zoti nuk i detyrohet askujt për asgjë dhe se veprat tona të mira janë si rroba të ndotura. (Isaia 64:6)

Arsyeja e thjeshtë është se Zoti ka një kriter të përsosur që përcakton se të gjithë kemi mëkatuar duke mos e arritur këtë kriter. (Romakëve 3:23) Ne dëshirojmë ta krahasojmë veten me të tjerët dhe ndjejmë se, në fund të fundit, nuk jemi aq të këqij. Mirëpo Perëndia na ka krahasuar me Jezu Krishtin dhe, krahasuar me të, ne nuk mund veçse të dështojmë të gjithë. Këtë dështim mund ta sqarojmë me shembullin që vijon:

Në Kaliforninë Jugore është një ishull, larg bregut, që quhet Katalina, thuajse dyzet kilometra nga ura e Newport Beach-it. Mbi cepin e urës po rrinin tre burra. Njëri syresh, një alkoolik, tip i ndotur e i sëmurë, e shkonte jetën rrugëve. I dyti, një amerikan i mesëm kurse i treti, njeri i mrekullueshëm, plot shëndet dhe i respektuar nga gjithë shoqëria. Befas, alkooliku kërcen që nga cepi i urës 1, 1/2 metra në det. Dy të tjerët i thërrasin: “Ç’bën ashtu, more!”, kurse ai ua kthen “Ja, po shkoj me një të kërcyer te Katalina”.

I dyti, i thotë: “Pa më shiko mua. Unë mund ta bëj atë rrugë më mirë nga ti.” dhe hidhet, duke kërcyer tre metra tutje, dy herë më larg sesa alkooliku.

Burri i tretë, njeri shumë i moralshëm, i ndershëm e i shëndetshëm, qesh me përçmim me ta. Ai merr vrull nja pesëdhjetë metra, vrapon dhe kërcen nja gjashtë metra tutje, duke mbuluar kështu një largësi dy herë më të madhe se ajo etë dytit dhe katër herë më të largët se ajo e të parit.

Më në fund erdhi roja bregdetare, i nxori nga uji dhe i pyeti se ç’po bënin. “Ja, po shkonim deri te Katalina” — shpjeguan ata si pa të keq. Ndërkohë i dyti mburrej për disfatën që i kishte shkaktuar të parit, kurse i treti nga ana e tij krekojej me suksesin që kishte korrur ndaj dy të tjerëve.

Pasi dëgjoi shpjegimet e tyre, rojes bregdetare nuk i mbeti veçse të tundë kryet e t’i qortojë: “Eh, të çmendur, po ju ndodheni ende dyzet kilometra larg ishullit.”

Sidoqë njeriu modern e konsideron veten më të mirë, ose të paktën po aq të mirë sesa të tjerët, ai mbetet ende larg qëllimit që Zoti ka vënë për të. Është e pamundur për këdo që, duke u hedhur nga ajo, të arrijë në Katalinë, është po aq e pamundur për një njeri të arrijë parajsën nëpërmjet veprave të veta, krejt i ndarë nga Jezu Krishti. Jezusi e tha qartë: “Askush nuk vjen te Ati, përveçse nëpërmjet meje.” (Gjoni 14:6)

Mund të provohet krishterimi?

Shumë herë gjatë bashkëbisedimeve lidhur me të vërtetën, veçanërisht për të vërtetën fetare, ndonjë shtron pyetjen: “Mund të provohet krishterimi për vërtetësinë e tij?” Shumë shpesh pyetja parafrazohet: “A

(1) Lew Wallace, — 1827–1905 gjeneral dhe romancier amerikan. (shën. i përkth.)

mund të themi me siguri se krishterimi është i vërtetë?”

Përgjigjja për pyetjen e parë është: “Po, mund të provohet se krishterimi është i vërtetë.” Kjo natyrisht nuk do të thotë se kushdo mund ta pranojë provën, sado e mirë që të jetë ajo. Por përgjigjja e pyetjes së dytë është: “Jo, nuk ka shumë siguri.”

Disa mendojnë se kjo “jo”, i lë jashtë grackës. Çështja është moskuptimi i karakterit të provës. Sekret i qëndron jo në sigurinë absolute, sikundër besojnë disa, por në një normë e provë që arrin në një siguri morale që e vë problemin pas një dyshimi logjik.

Ky është edhe standardi i përdorur historikisht nëpër gjykatat tona. Kur një gjykatës udhëzon jurinë, ai u sugjeron anëtarëve të saj ta bazojnë vendimin e tyre mbi mundësinë dhe jo mbi sigurinë; ta bazojnë vendimin mbi dëshminë e paraqitur dhe mbi sigurinë e shikimit të krimit. Nëse vendimet e jurisë do të vonoheshin deri në sigurinë e plotë, atëherë nuk do të jepej asnjë gjykim.

Secili i merr vendimet e kësaj jete bazuar mbi mundësinë dhe jo mbi sigurinë. Vendimet bazohen mbi kombinimin e besimit me faktin. Për shembull një njeri bëhet gati të kalojë përmes një rruge, kur ja, ai ndalet, qëndron mënjanë, dhe vështron në të dyja anët (ne shpresojmë se ai vërtetë vështron) — për të gjetur provën e nevojshme që të vlerësojë mundësinë e kapërcimit të asaj rruge shëndoshë e mirë.

Ai nuk mund të jetë njëqind për qind i sigurt se do ta bëjë atë kalim ashtu siç e mendon, mund të pësojë një goditje zemre në gjysmë të rrugës, mund të përpohet edhe nga një tërmet. Mungesa e sigurisë në masën njëqind për qind nuk e mbërthen atë në anë të rrugës, kështu ai lëviz drejt trotuarit përkundruall me ndoshta nëntëdhjetë për qind siguri, dhe dhjetë për qind besim, sepse e di mirë që do t’i duhet të shkojë në anën tjetër njëqind për qind.

Shumë njerëz duket sikur kërkojnë një siguri absolute në çështjet fetare, ndërkohë që nuk zbatojnë standardin e së vërtetës absolute ndaj diçkaje tjetër të një rëndësie të madhe. Madje edhe vetë ateisti nuk mund të jetë njëqind për qind i sigurt për pikëpamjet e veta kur thotë: “Nuk ka Zot.”

Të mohosh ekzistencën e Zotit, duhet të pranosh mundësinë e ekzistencës së Tij. Njerëzit nuk mund të rrinë pa marrë vendime, sepse nuk mund të arrijnë sigurinë absolute. Sigurisht nevojitet një standard i lartë i provës, veç jo një standard i paarsyeshëm, sikurse fjala vjen kërkesa për njëqind për qind siguri. Ashtu si njeriu që, duke kapërcyer rrugën, mund të mos kishte nevojë për njëqind për qind siguri për të bërë hapat drejt anës tjetër të rrugës, po kështu edhe dikush tjetër mund të mos ketë nevojë për njëqind për qind siguri për të marrë vendimin për të besuar në krishterim e në Jezu Krisht. Krishterimi pretendon siguri morale për këdo që dëshiron të marrë dëshminë për ta vlerësuar e për ta peshuar

E vërteta është e pavarur nga bindja. Nuk ka rëndësi sa fortbesoj; besimi te diçka nuk e bën atë të jetë patjetër e vërtetë. Për shembull unë mund të besoj me gjithë shpirt se nesër do të bjerë dëborë, por ky besim nuk siguron të rënit e dëborës, ashtu sikurse mund të besoj se makina ime tashmë e vjetër është një Rolls Royce i ri, por megjithatë besimi im nuk mund të ndryshojë faktin.

Besimi është po aq i mirë sa edhe objekti mbi të cilin ne mbështetim besimin tonë. Dikush mund të vijë të më thotë: “Ejani të fluturojmë me avionin tim të ri”. Në qoftë se unë shikoj se avioni i tij nuk është i ri dhe se ai vetë nuk ka as patentën e pilotit, atëherë besimi im nuk ka mbështetje, pavarësisht se sa i madh është. Besimi im nuk e bën dot shokun tim pilot të mirë sapo të gjendemi në ajër! Mirëpo, nëse një shok tjetër vjen e më bëri të njejtën ofertë, duke qenë pilot i certifikuar dhe me avion të ri, atëherë besimi im ka një bazë shumë më të qëndrueshme. Pra, rëndësi ka se ç’besoj, sepse besimi im nuk e bën të vërtetë atë që besoj.

Bibla thekson faktin se është jetësoreajo që beson. “Po të mos besoni se unë jam, ju do të vdisni në mëkatet tuaja.” (Gjoni 8:24) Gjithashtu, na është thënë: “Kush beson në Birin, ka jetë të përjetshme, kurse kush nuk i bindet Birit nuk do të shohë jetë, por zemërimi i Perëndisë qëndron mbi të.” (Gjoni 3:36)

Pra, theksi në Shkrimet nuk bie aq shumë mbi aktin e besimit sesa mbi objektin e besimit. Ajo që theksohet nuk është aq besimtari, por më tepër i besuari, Jezusi, që tha: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje.” (Gjoni 14:6)

Njerëzit sot besojnë çfarë dëshirojnë të besojnë, por kjo do t’i çojë ata drejt shkatërrimit të plotë. Tregimi i një ore mësimi me filozofin Georg Hegel pasqyron llojin e besimit jobiblik. Hegeli, siç del nga ngjarja, po parashtronte filozofinë e tij mbi historinë, duke iu referuar një vargu të gjatë ngjarjesh, kur një nga studentët kundërshtoi pikëpamjen e Hegelit me fjalët “Por, Herr Profesor, faktet janë ndryshe.”

“Shumë më keq për faktet!” — ishte përgjigjja e Hegelit.

Një nga periudhat më të errëta të historisë së Izraelit është ajo e mbretërve. Pikërisht gjatë kësaj periudhe ndodhi një përplasje midis Perëndisë dhe Baalit, një perëndie të rremë shumë të respektuar.

Mbi një altar i drunjtë hidheshin copat e një kau të therur, për flijim. Perëndia që do t’u shfaqej njerëzve në formën e zjarrit dhe do ta përpinte flijimin, do të pranohej si perëndia e vërtetë në Izrael. Baali filloi. Ai, nga të gjitha perënditë e tjera, ishte në gjendje të ndizte zjarr nga qielli, sepse vlente si zoti i Madh i natyrës që kontrollonte motin, shiun, stuhitë, vetëtimen. Priftërinjtë e Baalit parakalonin para altarit gjithë mëngjesin

1. “Ne të dy” — është fjala për të dy bashkëautorët, Josh McDowell dhe Don Stewart. (Shën. i përkth.)

deri pasdite vonë, duke iu lutur me ngulm Baalit që t'u përgjigjej. Këta priftërinj të gënjeshtërt hidheshin tërë ditën mbi altar, pritnin njëri-tjetrin me thika, vallëzonin deri në tërbim, flisnin përçart fjalë adhurimi dhe luteshin gjithë ditën e ditës. E megjithatë, asgjë nuk ndodhte. Por askush nuk mund të thotë se ata nuk ishin të sinqertë e se nuk besonin.

Kur mbaronin, ringrihej altari dhe Zoti Perëndi përgjigjej nga qielli dhe gëlltiste menjëherë altarin bashkë me flinë. Më pas profetët e gënjeshtërt të Baalit u therën.

Nëse sinqeriteti dhe besimi do të mjaftonin për të shpëtuar, atëherë edhe ata profetë do të ishin kursyer. Por ja që ndodhi e kundërta. Ata profetë e kishin mbështetur besimin e tyre mbi diçka krejt të gabuar dhe kurrë nuk kishin zgjedhur rrugën e hetimit të së vërtetës. Zoti kërkon që njeriu ta vërë besimin e tij mbi Jezu Krishtin; asgjë tjetër nuk do të kënaqte, si ata ashtu edhe Atë.

Përse një Zot i mirë e lejon të keqen të jetojë?

Një nga pyetjet e dendura që ndeshim ka të bëjë me problemin e së keqes. Nëse ka një Zot, përse atëherë të ketë edhe të keqe? Përse Zoti vetë nuk po bën asgjë për këtë problem? Shumë pranojnë se ekzistenca e së keqes përgënjeshtrohet ekzistencën e Zotit.

Shpeshherë problemi i së keqes ishfaqet të krishterit në formën e një pyetje komplekse: "Në qoftë se Zoti është i mirë, atëherë ndoshta Ai është aq i fuqishëm sa të merret me gjithë këtë të keqe e padrejtësi që ndodh në këtë botë. Meqë ekziston edhe sot e kësaj dite, e cila është aq i fuqishëm ta ndalojë të keqen, ai ndoshta është një Zot i keq, sepse Ai nuk po bën asgjë për këtë çështje edhe pse e ka mundësinë. Po çfarë është pra ky Zot? A është një Zot i keq, apo një Zot jo-i Gjithëfuqishëm?" Madje edhe shkrimtarët biblikë ankoheshin për dhimbjen dhe të keqen e kësaj bote. "Sepse të këqija të panumërta më rrethojnë." (Psalmi 40:12), "Pse dhimbja ime është e pafund dhe plaga ime e pashërueshme nuk pranon të shërohet?" (Psalmi 15:18), "Sepse e dimë se deri tani mbarë bota e krijuar rënkton." (Romakëve 8:22). Kështu ne pranojmë pa vështirësi se e keqja mbetet problem dhe se nëse Zoti e krijoi botën ashtu sikundër ajo paraqitet sot, Ai nuk mund të jetë Zoti i dashurisë, por Zoti i së keqes.

Mirëpo Bibla na mëson se Zoti nuk e krijoi botën sikurse ajo paraqitet sot dhe se e keqja erdhi si pasojë e egoizmit të njeriut. Bibla thotë se Zoti është Zoti i dashurisë dhe se kërkoi të krijonte një njeri e një gjini njerëzore që ta donte Atë. Mirëpo dashuria e vërtetë nuk mund të ekzistojë, po të mos jepen lirisht nëpërmjet zgjedhjes dhe vullnetit të lirë. Prandaj njeriu iu dhe alternativa: ose të pranojë dashurinë e Zotit, ose ta flakë tutje atë. Një zgjedhje e tillë bëri që mundësia e ardhjes të së keqes të bëhet gjithnjë e më reale. Kur Adami dhe Eva nuk iu bindën Zotit, ata nuk zgjodhen

diçka të krijuar nga Zoti, por sollën të keqen mbi Tokë. Zoti nuk është as i keq dhe as krijues i së keqes. Njeriu e solli vetë të keqen, duke zgjedhur në mënyrë krejt egoiste rrugën e tij larg dhe veçan rrugës së Perëndisë.

Për shkak të Rënies bota tani paraqitet krejt anormale. Gjërat nuk janë ashtu siç duhej të ishin. Njeriu, si rrjedhim i Rënies, u nda nga Zoti. Po edhe natyra nuk është gjithmonë shpirtmirë me njeriun dhe për pasojë bota e kafshëve mbetet armike e tij. Ka edhe grindje midis njeriut dhe të afermit të tij. Asnjëra nga këto gjendje nuk ekzistonte para Rënies. Cilado qoftë zgjidhja që do t'u jepte udhë të drejtë këtyre problemeve, duhet marrë parasysh faktin se bota në gjendjen e sotme nuk është aspak normale.

Por duhet thënë se, edhe pse e keqja gjendet midis nesh dhe është reale, ajo është e përkohshme. E keqja, në fund të fundit, do të shkatërrohet. Kjo është edhe shpresa që ka besimtari. Një botë e re do të rilindë dhe në të nuk do të ketë më lot e dhembje, sepse gjithçka do të bëhet e re. (Zbulesa 21:51) Parajsa e humbur do të bëhet parajsë e rifituar. Zoti do të rregullojë çdo gabim dhe do ta flakë tutje të keqen njëherë e përgjithmonë, në kohën e Tij.

Të krishterët kanë arsye të luftojnë kundër së keqes, imoralitetit dhe korrupsionit. Bota nuk ishte projektuar bashkë me të keqen, prandaj besimtari ka një bazë reale për të luftuar të këqijat shoqërore. Ai nuk ndjek pikëpamjen se çdo gjë që ndodh është e drejtë. I krishteri nuk miraton gabimin me arsyetimin se ai është pjesë e botës që krijoi Zoti, ashtu sikurse nuk pranon të thotë se çdo gjë që ndodh është e miratuar nga vetë Zoti. Zoti nuk e dëshiron të keqen dhe nuk e lë të kalojë pa u vënë re. Zoti e urren të keqen prandaj, i krishteri, jo vetëm që duhet ta urrejë, por edhe të bëjë diçka. Vërtet mëkati është real, por nuk është diçka të cilën besimtari e pranon si normale. Duke u bashkuar me Jezusin, besimtari ka detyrë t'i quajë të gabuara gjërat që janë të gabuara dhe të çojë zërin, kur e keqja e mbyl të mirën. I krishteri, kur lufton kundër të këqijave sociale, nuk lufton kundër Zotit. Fatkeqësitë natyrore, krimi dhe prapambetja mendore nuk duhet të pranohen si normale, sepse ato kurrë nuk ishin projektuar, dhe nuk do të ekzistojnë në mbretërinë e ardhshme të Perëndisë.

Megjithatë, disa njerëz shqetësohen se përse Zoti lejon, në rradhë të parë, të ndodhë e keqja. Ata vënë kështu në dyshim mençurinë e Tij duke i dhënë njeriut një zgjedhje në këtë çështje. Dorothy Sayers e shpjegon drejt këtë, kur thotë: "Cilado qoftë arsyeja pse Zoti vendosi ta bëjë njeriun ashtu sikurse është, të kufizuar, të vuajtur, subjekt hidhërimit e vdekjeje, Ai pati ndershmërinë dhe guximin të pinte ilaçin e tij. Çfarëdo loje që Ai luan me krijesën e Tij, luan duke ndjekur rregullat e një loje të ndershme. Zoti nuk kërkon nga njeriu atë që nuk e ka kërkuar më parë te vetja. Zoti është futur në tërë përvojën njerëzore që nga acarimet e parëndësishme

të jetës familiare, kufizimet e punës raskapitëse dhe mungesa e parave, deri te tmerret më drithmuese të dhembjes e të poshtërimit, mundjes, dëshpërimit dhe vdekjes. Kur ishte njeri, Ai u tregua burrë. Ai lindi në varfëri dhe vdiq në poshtërim dhe gjithë këtë e vlerësoi të dobishme. ” (Dorothy Sayers, *Creed or Chaos?* p. 4)

Bibla na thotë se nganjëherë synimet e Zotit janë përtej aftësive tona mendore.

“Duke qenë se mendimet e mia nuk janë mendimet tuaja dhe se rrugët tuaja nuk janë rrugët e mia. ” — thotë Zoti — “Ashtu si qiejt janë më të lartë se toka, ashtu edhe rrugët e mia janë më të larta se rrugët tuaja dhe mendimet e mia janë më të larta se mendimet tuaja. ” (Isaia 55:8, 9) Pali, nga ana e tij, i shkroi kështu kishës së Romës: “Oh, thellësi pasurie, vërtetësie e diturie e Perëndisë! Sa të pahulumtueshme janë gjykimet e Tij dhe sa të pashtershme janë udhët e Tij. ” (Romakëve 11:33)

Megjithëse Bibla na mëson se si dhe pse u shfaq e keqja, ajo nuk na tregon se për çfarë arsye Zoti e lejoi atë të vijë. Sidoqoftë ne dimë se Zoti është i Gjithëmençur, i Gjithëdijshtëm dhe se Ai ka arsye që lejon të tilla gjëra që qëndrojnë përtej aftësive tona mendore.

PËRMBAJTJA

■ PARATHËNIE	3
■ HYRJE	4
■ BIBLA	
Hyrje	5
Çfarë e bën Biblën kaq të veçantë?	5
A nuk ka ndryshuar Dhiata e re përderisa është kopjuar e rikopjuar nëpër histori?	7
Si mundet dikush ta besojë Dhiatën e re si një tregim për jetën e Jezusit duke parë se ajo është shkruar pas vdekjes së tij?	9
Ka kaq shumë interpretime të ndryshme të Biblës? Përse duhet t'i besoj tuajit?	10
Si mund të besoni një Bibël që ka plot mospërputhje?	11
E vërteton dëshmia arkeologjike Biblën? Si lidhen zbulimet arkeologjike me ngjarjet të Shkrimit të shenjtë?	14
Çfarë janë pergamenat e detit të vdekur?	15
Përse ekzistenca e popullit izraelit është dëshmi objektive se Bibla është e vërtetë?	17
Përse të krishterët i drejtohen përmbushjes së profecisë për të provuar që Bibla është Fjala e Zotit?	19
Çfarë është apokrifa? Përse këto libra nuk gjenden në Biblat protestante?	20
Çfarë kuptimi ka të themi që Bibla është e frymëzuar?	22
Deri në ç'masë është e frymëzuar Bibla?	23
Po si arritën njerëzit e gabueshëm të krijojnë një libër të pagabueshëm?	26
Si e dini ju që shkrimet e Apostullit Pal ishin frymëzuar?	27
Derisa Jezusi ishte njerëzor, a nuk ishte dhe Ai i gabueshëm?	28
Si e vlerësonte Jezusi Dhiatën e Vjetër?	30
A i përshtati Jezusi mësimet e tij me pikëpamjet e kohës ku jetoi?	32
Shumë e interpretojnë Biblën në mënyrë alegorike. Përse ju e interpretoni fjalë për fjalë?	33
A duhet pranuar fjalë për fjalë gjithçka që gjendet në Bibël?	35
■ ZOTI	
Si e dini se Zoti ekziston?	37
Nga na erdhi Zoti? Çfarë bënte ai para se të krijonte gjithësinë?	38

Çfarë është Trinia? A adhurojnë të krishterët tre Zota?	39
Përse është Jezusi e vetmja rrugë për të arritur te Zoti?	40
A nuk është Zoti i Dhiatës së Vjetër një Zot i urrejtjes kurse Zoti i Dhiatës së Re një Zot i dashurisë?	42

■ JEZU KRISHTI

Si e dini se Jezusi ka ekzistuar?	44
Pretendonte Jezusi të ishte zot? Nëse ishte, përse duhet ta besoj?	45
A lindi Jezusi nga një virgjëreshë?	47
A nuk ka argumente të arsyeshme që e bëjnë sot të pabesueshme lindjen e virgjër?	48
Si e dimë se Jezusi u ringjall nga vdekja?	50
Si mund t'i shpjegoni mospërputhjet në historinë e ringjalljes?	52

■ MREKULLITË ATËHERË DHE TANI

Si mund të ndodhin mrekullitë?	55
A ishin mrekullitë biblike dredhi magjike që budallallepsen njerëzit e thjeshtë dhe primitivë?	56
Çfarë i bejnë mrekullitë biblike madhështore ndaj atyre që pretendojnë fetë e tjera?	57

■ BESIMET FETARE BOTËRORE

Çfarë mendoni për alternativat e ndryshme të krishterimit si agnosticizmi, ateizmi dhe humanizmi?	61
A nuk na mësojnë në thelb të njëjtën gjë të gjitha besimet fetare?	62
Cilat janë disa nga ndryshimet midis krishterimit dhe feve të tjera lindore?	63
Cilat janë burimet e islamizmit?	65
Cilat janë besimet e islamit?	66
A është islamizmi në pajtim me krishterimin?	67

■ KRISHTERIMI

Çfarë e bën të vlefshme rilindjen e krishterë? A mund të shpjegohet ajo psikologjikisht?	69
Çfarë shprese i ofron krishterimi njerëzimit?	70
A është krishterimi një patericë?	72
Si bëhet njeriu i krishterë?	73

■ BESIM NË PRAKTIKË

Përse duhet të bëhem i krishterë? — Hipokritët më të mëdhenj gjenden në kishë.	75
--	----

Çfarë mund të thuhet për ata që nuk e dëgjuan kurrë ungjillin?	76
Do t'i pranojë zoti njerëzit shumë fetarë dhe të çiltër edhe nëse nuk janë të krishterë?	79
Në qoftë se krishterimi qenka kaq i rëndësishëm e i shquar, përse ka kaq pak të krishterë?	80
Është e arsyeshme ta besoshkrishterimin apo kjo është thjesht çështje dëshire?	82
A merrn parasysh punët e mia të mira? A do të më pranojë Zoti nëse kam bërë një jetë të rregullt?	85
Mund të provohet krishterimi?	87
Ka vërtet rëndësi se çfarë besoj?	89
Përse një Zot i mirë e lejon të keqen të jetojë?	90